

BDI e kënaqur me VMRO-në



FAQE 2

Në pikëpyetje krentimi i për-bashkët i Alfabetit



FAQE 3

Panjojuri për planin e SHBA-ve rreth emrit



FAQE 2

Koha

E përditshme informative

Viti II • Numri 531 • E premte 29 gusht 2008

Zëvendëskryeministri Ademi pretendon për shkelje, ish ministri Rushiti demanton

"Pjetër Bogdani" shkelje, apo paaftësi për ta mbrojtur



Zëvendëskryeministri Ademi bën të ditur se Instituti po hetohet për shkelje në procedurat e themelimit. Ish ministri Rushiti kundërpërgjigjet, "Pjetër Bogadani" i pastër si kristali. Ai thotë se BDI është e paaftë të mbrojë institucionet shqiptare

FAQE 3

Kapen valltare në Tetovë



Tetovë, 28 gusht - Sektori kundër tregtisë me njerëz pranë Ministrisë së Brendshme në bashkëpunim me policinë e Tetovës kanë zbuluar rast të tregtisë me person të mitur, si dhe kontrabandë të emigrantëve. Sipas policisë për këto vepra penale dyshohen B.D. (32) pronar i objektit hotelierik "Premier - B" në hyrje të Tetovës dhe kushëriri e tij B.D. (33) që të dy nga Tetova. Më 17 gusht të këtij viti, Policia rrugore ka ndaluar një veturë taksì në të cilën janë transportu-

ar shtetaset serbe R.L. (19) dhe S.R. (20) dhe pasi e para nuk ka poseduar me vete dokument udhëtimi janë dërguar në policinë e Gostivarit. Në bisedë e sipër me vajzën R.L. është mësuar se ajo për herë të parë në Maqedoni kishte ardhur në periudhën 2006/2007 duke punuar rreth 10 muaj në objektin hotelierik "Zlatni 9" në fshatin Çegran, ku pas një aksioni policor është arrestuar dhe dëbuar me ndalesë për hyrje në një kohëzgjatje prej një viti...

FAQE 5

Kosajov: Moska mund ta njohë edhe Kosovën

FAQE 2

Arrestohet Gjyleri



FAQE 5

Çifti kërcënon vajzën me incizimet

Me qëllim që për vete të krijojnë pronë jasthtëligjore gjatë muajit gusht të këtij viti, K.I. i është kërcënuar një vajze 24-vjeçare nga Shkupit, se do t'ia zbulojë në opinion incizimet me video materiale kompromituese

FAQE 5

USHT dhe UT me marrëveshje bashkëpunimi

Në praninë e udhëheqësve e dekanëve të dy universiteteve, rektorët e Universitetit Shtetëror të Tetovës dhe Universitetit të Tiranës nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit

FAQE 4

Publikohen emrat e 10 ambasadorëve të Kosovës

Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, në mbledhjen enjte të kabinetit qeveritar, ka publikuar emrat e 10 të ngarkuarve të parë në ambasadat e Republikës së Kosovës në botë

FAQE 8

Limani kundër grekut Zambiti



FAQE 19

Mosmarrëveshjet mund të çojnë në krizë institucionale

Moskohabitimi pengon implementimin e MO-së

Përveç tjerash, mosmarrëveshjet mes Presidentit dhe Qeverisë, ndikojnë negativisht edhe në zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit, thonë analistët politik. Presidenti i është kundërpërgjigjur kryeministrit duke thënë se zgjidhjen për emrin duhet kërkuar të mediatori Nimic

Koha Bekim Murati

Shkup, 28 gusht - Përkundër vërejtjeve të faktorit ndërkombëtarë se kohabitimi mes presidencës dhe ekzekutivit është më se i nevojshëm, presidenti Branko Červenkovski dhe kryeministri Nikolla Gruevski, ditëve të fundit sipas analistëve vetëm se i kanë keqësuar edhe më tepër relacionet. Presidenti të enjten i është kundërpërgjigjur kryeministrit rreth kërkesës së këtij të fundit për të gjetur një zgjidhje, duke thënë se "nuk jam unë ai që jep propozime për zgjidhjen e çështjes së emrit por ndërmjetesi Nimic".

Përderisa njëri mundohet të tregohet si patriot i cili me çdo kusht mundohet ta ruaj emrin e



Maqedonisë, e tjetri ihtar i integritimit sa më të shpejtë, unifikimi i qëndrimeve mbetet peng i mosmarrëveshjeve. Profesi i Universitetit të Evropës Juglindore, Jeton Shasivari, thotë se këto regata të keqësuar mund të jenë të kobshme për Maqedoninë. "Epilogu i të gjithë mosmarrëveshjeve mund të përfundojë me krizë politike, institucionale e cila do të çonte në bllokimin total të aparatit

shtetëror. Pasoja më të mëdha padyshim se do të kenë qytetarët të cilët janë sakrificë e këtyre mosmarrëveshjeve", thotë ai. Sipas Shasivarit, mosmarrëveshjet mes Presidentit dhe Qeverisë, ndikojnë negativisht edhe në zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit. "Edhe Presidenti edhe Kryeministri kanë qasje të ndryshme rreth implementimit të Marrëveshjes së Ohrit. Çdonjëra nga palët interpreton në for-

më të ndryshme këtë marrëveshje, por qëllimi është i njëjtë, dëmtimi i implementimit të saj në praktikë", potencion Shasivari. Sipas tij, ky tentimi është shumë i dëmshëm për të ardhmen e Maqedonisë, sepse Marrëveshja e Ohrit nuk është marrëveshje mes maqedonasve dhe Shqiptarëve, por ajo është garanci ndërkombëtare.

Ndërkaq, analisti politik nga Instituti për Demokraci, Vladimir Misev, thotë se mosmarrëveshjet mes Červenkovskit dhe Gruevskit janë për arsye të suave personale, të shndërruara në problem ndërinstitucional. "Definitivisht kjo situatë do të ndikojë negativisht në imazhin e Maqedonisë përpara faktorit ndërkombëtar. Situata bëhet më e komplikuar me deklaratën e përshpejtuar të Presidentit të shtetit, i cili paralajmëroi kthimin e tij si lider i një partie politike. Presidenti dhe Qeveria suat patjetër ti lënë pas tyre, ndërsa veprimi i tyre të bazohet në bazë të kushtetutës dhe ligjeve të Maqedonisë", thekson analisti Misev. Ndryshe, konfrontimi mes Presidentit të shtetit nga njëra anë dhe Qeverisë nga ana tjetër, daton që nga ardhja në pushtet e VMRO-DPMNE-së, e cila e konteston legjitimitetin e tij.

Muaji i Ramazanit fillon të hënën

Shkup, 28 gusht - Rijaseti i Bashkësisë Fetare Islame informon besimtarët dhe opinionin e gjerë se sipas Kalendarit Islam, muaji i bekuar Ramazanit fillon më 1 shtator, ditën e hënë. Po ashtu, informohen besimtarët se regjistrimi për Haxhin e sivjetshëm fillon qysh në muajin Ramazanit. Çmimi për një aranzhman me aeroplan është 2590 euro, ndërsa regjistrimi bëhet nëpër Muftinitë e BFI-së. Çmimi për aranzhmanin me autobus është 1.700 euro, ndërsa regjistrimi bëhet të bashkëpunëtorët teknik të autorizuar nga Rijaseti i BFI-së.

Moska mund ta njohë edhe Kosovën



Moskë, 28 gusht - Kryetari i Komitetit për politikën e jashtme në Dumën Ruse, Konstantin Kosaçov, ka thënë për BBC-në se pas njohjes së Osetisë së Jugut dhe Abkhazisë, Moska mund të bëjë të njëjtën gjë edhe me Kosovën.

"Ndoshta do ta njohim, nuk mund ta përjashtoj këtë mundësi", është shprehur çuditërisht Kosaçov. Ndërkohë, ai theksoi se Rusia po sillt njëllësi si ndërkombëtarët për sa i përket respektimit të së drejtës ndërkombëtare.

Pas përpjekjeve të fundit të mediatorit Nimic

Panjohuri për planin e SHBA-ve rreth emrit

Kryeministri i Maqedonisë, Nikolla Gruevski ka përsëritur qëndrimin e tij se çdo propozim për emrin e Maqedonisë, do të kalonte përmes referendumit. Deklarata e Gruevskit ka ardhur si kundërpërgjigje ndaj deklaratës së ambasadores amerikane Xhilian Millovanoviç, sipas së cilës Maqedonia nuk ka ardhmëri të mirë pa NATO-n. Ndërsa Ambasada e SHBA-ve në Shkup ka demantuar se ekziston plan i tyre për zgjidhjen e çështjes së emrit



Shkup, 28 gusht - Kryeministri i Maqedonisë Nikolla Gruevski, deklaroi se nuk është i njoftuar për ekzistimin e gjoja planit amerikan për zgjidhjen e problemit me emrin, i cili sipas informatave në disa media, sekretarja e shtetit Kondoliza Rajs është dashur t'ua prezantojë shefave të diplomacive të Maqedonisë dhe Greqisë më 23

shtator në Nju-Jork, një ditë para mbledhjes së Asamblesë së përgjithshme të KB-së. Ndryshe, deklarata e Gruevskit ka ardhur si kundërpërgjigje ndaj deklaratës së ambasadores amerikane Xhilian Millovanoviç, sipas së cilës Maqedonia nuk ka ardhmëri të mirë pa NATO-n. Kurse, sipas një analize të botuar në "Los Angeles Chronicle"

Sekretarja amerikane e shtetit Kondoliza Rajs më 23 shtator në Nju Jork do të paraqes planin për zgjidhjen e çështjes së emrit para shefave të diplomacisë maqedonase dhe greke.

Ndërkaq, analisti Sam Vaknini, ish-këshilltarë i kryeministrit Gruevski, në shkrimin e tij duke u

thirur në burime diplomatike thekson se, një ditë më pas më 24 shtator, plani në fjalë do t'i prezantohet edhe Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Sipas Vakninit, bëhet fjalë për plan greko-amerikanë, kurse Qeveria maqedonase ndoshta edhe nuk e dinë ekzistimin e

këtij dokumenti. Plani i cili përmban pesë elemente është rezultat i një serie takimesh të fshehta mes përfaqësuesve amerikanë dhe grek, kurse është finalizuar në qershor në një konferencë në të cilën kanë marrë pjesë Dora Bakojeva dhe Rajs. Vaknini ka theksuar se plani parashihet ndryshimin e emrit kushtetues të Maqedonisë, një periudhë tranzitore prej dhjetë viteve për të ndodhur kjo dhe për t'u ndryshuar emri i regjistruar në institucionet e ndryshme ndërkombëtare dhe multilaterale. Pas kësaj marrëveshje, Vaknini thotë se Maqedonia do të marrë ftesën për hyrje në NATO por jo edhe datën për fillimin e negociatave me BE-në. (B.M)

Boton: "Media-Koha" Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullvoji

Drejtor: Arben Ratkoceri

Kryeredaktor: Besim Iljazi • Zëvendëskryeredaktor: Vedat Memedaliu

Redaktorë: Venera Latifi-Azizi, Avdyll Salihu, Evis Halili, Ilir Ivanovski • Redaktor teknik: Halil Berisha

E-mail: koha@koha.com.mk • Tel: 02 3179 - 904; Fax: 02 3118 - 060; Adresa: Bul. Goce Dellçev Nr.11/2 (Q.T. Mavrova) - Shkup

MARKETING: marketing@koha.com.mk - Tel: 02 3179-904; 02 3299-871

NPK "Media-Koha" Num. i xhirrolgarisë: 210-0615408501-15; Tutunska Banka -Shkup; Num. i Tat. 4030006609121

Koha

E përditshme informative
www.koha.com.mk

Shtyp: "Misirkov" - Shkup

Zëvendëskryeministri Ademi pretendon për shkelje, ish ministri Rushiti demanton

"Pjetër Bogdani" shkelje, apo paaftësi për ta mbrojtur

Koha Evis HALILI

Shkup, 28 gusht - Pas bllokimit të fondeve, Instituti i Trashëgimisë Kulturore dhe Shpirtërore "Pjetër Bogdani" vendoset përballë një tjetër surprize. Shkelje të procedurave të themelimit. Lajmi për abuzime gjatë themelimit të institucionit është artikulluar nga zëvendëskryeministri Abdylaqim Ademi, i cili pasi ka pranuar se nuk është në diskutuar çështja e bllokadës financiare nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, ka pohuar se për momentin është duke u trajtuar një tjetër problematikë lidhur me "Pjetër Bogdanin", shkelje në procedurat e themelimit. Pa dhënë hollësi se për çfarë lloj shkeljesh bëhet fjalë, apo kur janë vërejtur, Ademi është kufizuar me sqarimin se "në asnjë moment ekzistenca e Institutit nuk mund të vihet në pikëpyetje, do të vazhdojë të funksionojë ashtu si edhe më parë,



por pasi të rregullohen shkeljet e vërejtura pas disa analizave të bëra". Megjithatë procedurat e themelimit është



Zëvendëskryeministri Ademi bën të ditur se Instituti po hetohet për shkelje në procedurat e themelimit. Ish ministri Rushiti kundërpërgjigjet, "Pjetër Bogdani" i pastër si kristali. Ai thotë se BDI është e paaftë të mbrojë institucionet shqiptare

tejet korrekte dhe Instituti është i pastër si kristal, pohn ish ministri i MASH, Sulejman Rushiti, ndërsa pre-

tendimi për abuzime komentohet si një pamundësi e BDI-së për të mbrojtur institucionet shqiptare.

"Procedurat janë aq konform ligjit dhe aq të rregullta, aq sa mund të ketë çfarëdolloj hetimi nga brenda apo nga

jashtë, pasi po të mos ishin të tilla fondi prej 2 milionë denarësh as që do të ish miratuar. Këtu kemi të bëjmë me paaftësi, apo indiferencës të BDI-së për të mbrojtur vlerat kulturore të shqiptarëve", thotë Rushiti.

Ish ministri shton se fatkeqësisht historia e "Pjetër Bogdani" po përsëritet edhe me përvjetorin e Kongresit të Manastirit, ligjin për përdorimin zyrtar të gjuhës shqip, si një praktikë e njohur për të justifikuar mungesën e mjeteve kur vijnë në pyetje manifestime të ndryshme për shqiptarët, të cilat katan-disen nga eventime mbarëshqiptare në dasma rurale.

Akuzat për parregullsi në themelimin e institutit janë lakuar prej kohësh në opinion. Disa prej tyre madje ngrinin dyshimet mbi statusin e Institutit. Ndaj tyre deri tani janë arkivuar disa padi penale nga ana e "Pjetër Bogdani".

Kremtimi i 100 vjetorit të ABC-së shqipe

Në pikëpyetje kremtimi i përbashkët

Mbetet e paqartë nëse kremtimi i përvjetorit të shkronjave shqipe do të festohet së bashku me Shqipërinë dhe Kosovën. Zëdhënësi i Qeverisë, Shefik Duraku, ka bërë të ditur se janë duke u bërë përpjekje që një qind vjetori i Kongresit të Alfabetit me manifestime të përbashkëta të festohet në të gjithë trojet shqiptare



Koha Bekim Murati

Shkup, 28 gusht - Njëqind vjetori i i mbajtjes së Kongresit të Alfabetit në Manastir do të organizohet nën patronazhin e Qeverisë. Ndërsa, mbetet e paqartë nëse kremtimi i përvjetorit të shkronjave shqipe do të festohet së bashku me Shqipërinë dhe Kosovën. Zëdhënësi i Qeverisë, Shefik Duraku, ka bërë të ditur se janë duke u bërë përpjekje që një qind vjetori i Kongresit të Alfabetit me manifestime të përbashkëta të festohet në të gjithë trojet shqiptare, Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë. "Zëvendëskryeministri është në kontakt me Ministrin e Kulturës të Shqipërisë dhe Kosovës, që

kjo datë e rëndësishme për popullin shqiptarë të festohet bashkërisht", ka thënë Duraku. Zëdhënësi qeveritarë, Shefik Duraku, në një takim me gazetarët, ka thënë se më 26 gusht Qeveria ka miratuar vendimin për formimin e një Këshilli organizativ i cili do të përkujdeset për organizimin e njëqind vjetorit të Kongresit të Manastirit. "Këshilli organizativ për shënimin e 22 nëntorit është obliguar nga ana e Qeverisë që në afat prej 15 ditëve të përgatis program për shënimin e kësaj date të rëndësishme për popullin shqiptarë. Me rëndësi të veçantë është se këtë vit është ngritur niveli i organizimit dhe se këshilli organizativ do të përbëhet nga ministra, akademikë dhe

personalitetet të shquara nga sfera e kulturës dhe shkencës", ka thënë Duraku, sipas të cilit shteti ka marrë përsipër edhe sigurimin e mjeteve financiare.

Këshilli organizativ do të udhëhiqet nga zëvendëskryeministri Abdylaqim Ademi, ndërsa anëtarë do të jenë ministrja e Kulturës, Elizabeta Kançeva, ministri i Arsimit, Pero Stojanovski, ministri Pushtetit lokal Musa Xhaferi, pastaj akademikët Luan Starova, Ali Aliu, Alajdin Abazi, Mateja Matovski, dhe Gane Todorovski. Ndryshe, 22 nëntori, Dita e Alfabetit, respektivisht Kongresit të Manastirit në bazë të ligjit për festa të Maqedonisë është ditë jo pune për qytetarët shqiptarë.

Ahmeti komenton bashkëpunimin me Gruevskin

BDI e kënaqur me VMRO-në

Dibër, 28 gusht - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integritet (BDI), Ali Ahmeti, deklaroi se është i kënaqur me bashkëpunimin e deritanishëm me partnerin e koalicionit VMRO-DPMNE.

"Kemi një fillim të mirë dhe besoj se gjatë këtij mandati Qeveria e Maqedonisë do të shënojë rezultate shumë të mira", deklaroi Ahmeti të mërkurën gjatë vizitës së tij në Dibër. Ahmeti sërish deklaroi se Maqedonia shumë shpejtë do ta njohë pavarësinë e Kosovës. Ndërkaq, lidhur me demarkacionin kufitar mes Kosovës dhe Maqedonisë, ai tha se është një çështje



shumë e rëndësishme teknike dhe nuk ka karakter politik siç pretendojnë ta paraqesin disa. (ina)

Këshilltari në MPJ-në e Kosovës

Njohja e pavarësisë është edhe në interes të Maqedonisë

Prishtinë, 28 gusht - Këshilltari i parë politik në Ministrinë e Jashtme të Kosovës, Bekim Sejdiu deklaroi se njohja e Kosovës nga Shkupi zyrtar është në interes edhe të Maqedonisë. "Në marrjen e vendimit për njohjen apo mosnjohjen e shtetit të Kosovës, secili shtet nisat nga interesat e veta dhe ndikohet nga faktorë dhe dinamika të brendshme. Duke u nisur nga këto faktorë unë besoj fuqimisht se është në interesin e Maqedonisë dhe të çdo vendi tjetër në rajon që akoma nuk e ka njohur shtetin e Kosovës, që një gjë të tillë ta bëjë", deklaroi zyrtari i lartë i diplomacisë kosovare,

Bekim Sejdiu. Sipas tij, Kosova edhe para shpalljes së pavarësisë, ka shfaqur një përkushtim të qartë për forcim të marrëdhënieve me Maqedoninë, qofshin ato politike, ekonomike apo të tjera. "Ne e konsiderojmë Republikën e Maqedonisë partner strategjik, ekonomik dhe politik. Mendoj se njohja e Kosovës nga Maqedonia do kishte efekt pozitiv në këtë përkushtim të Kosovës dhe anasjelltas", theksoi Sejdiu për agjencinë e lajmeve INA.

Ai nënvizoi se kohët e fundit Maqedonia është deklaruar se i njeh pasaportat e Republikës së Kosovës dhe kjo është diçka pozitive.

LASH kërkon të mbikëqyren paralelet maqedonase

Me nxënës shqiptarë ruajnë paralelet

"Përgjegjësit e paraleleve maqedonase, njoftojnë Ministrin e Arsimit se kanë formuar paralele. Nxënësit në shator ndjekin mësim, ndërsa në tetor u mbesin paralelet me 20 nxënës. Qëllimi është ti formojnë paralelet, të ruajnë vendet e punës për profesorët maqedonas. Më pas deklarojnë se nxënësit me vetë dëshirë kanë tërhequr dokumentet", akuzon kryetari i LASH-it, Nuhu Dardhishta



Koha | Hajrie AZEMI

Shkup, 28 gusht - Lidhja e Arsimitarëve Shqiptarë (LASH) kërkon nga Ministria e Arsimit dhe Inspektorati Shtetëror i Arsimit (ISHA) që në shtator të dalin të dhëna konkrete se sa nxënës shqiptarë kanë vazhduar arsimin e mesëm obligues

në paralele maqedonase. Kryetari Nuhu Dardhishta informon se nxënësit shqiptarë me sukses të dobët janë regjistruar në paralele maqedonase. Ai thotë se Ministria e Arsimit dhe Inspektorati Shtetëror për Arsim duhet të përpilojnë lista me nxënësit e dobët që janë regjistruar në drejtime ku janë kërkuar më shumë pikë, ndërsa

të njëjtit filloristë më pas të transferohen në shkollat e mesme ku plotësojnë kushtet. Sipas tij, në gjimnaz në paralele maqedonase duhet të largohen të gjithë nxënësit që janë regjistruar me më pak se 60 pikë. Konkursi për regjistrim, thekson Dardhishta, parashikon vende të lira për të gjithë filloristët të vazhdojnë arsimin e

mesëm në gjuhën shqipe. "Përgjegjësit e paraleleve maqedonase, njoftojnë Ministrin e Arsimit se kanë formuar paralele. Nxënësit në shator ndjekin mësim, ndërsa në tetor u mbesin paralelet me 20 nxënës. Qëllimi është ti formojnë paralelet, të ruajnë vendet e punës për profesorët maqedonas. Më pas deklarojnë se nxënësit me

vetë dëshirë kanë tërhequr dokumentet", thekson Dardhishta, duke apeluar se me Ligjin për arsim të mesëm obligues mbulohej të gjitha shpenzimet nga shteti.

Ndërkohë, drejtorët e shkollave fillore fajin e hedhin tek përgjegjësit shqiptarë nëpër shkollat e mesme.

Përgjegjësit shqiptarë, theksojnë udhëheqësit, duhet të marrin masa urgjente për të parandaluar mbushjen e paraleleve maqedonase me nxënës shqiptarë ruajnë vendet e tyre të punës", thotë Emimi Edhe Halit Sejdiu drejtor në shkollën fillore "26 korriku", në Shkup

thekson se paralelet maqedonase mbushen me nxënës shqiptarë, ngase pranohen me sukses të dobët dhe më pak pikë. Ai thotë se nxënësit shqiptarë shpëtojnë profesorët maqedonas nëpër shkollat e mesme, ndërkohë i rrezikojnë paralelet shqipe. "Duhet të merren masa urgjente për parandalimin e kësaj dukurie, që ngulfat paralelet shqipe", thekson Palloshi. Drejtori në shkollën

fillore "25 maji", Hajrulla Emimi apelon të vendosen kushte edhe në paralele maqedonase, ndërsa nxënësit të pranohen sipas kritereve që parashikohen me Konkursin për regjistrim.

"Nuk është e logjishme, kërkohen paralele shqipe, por nxënësit vazhdojnë arsimin në paralele maqedonase. Profesorëve maqedonas u konvenon një gjë e tillë, ngase duke mbushur paralelet me nxënës shqiptarë ruajnë vendet e tyre të punës", thotë Emimi Edhe Halit Sejdiu drejtor në shkollën fillore "26 korriku", në Shkup thekson se prindërit dhe përgjegjësit shqiptarë duhet të jenë më të kujdesshëm se ku vazhdojnë filloristët arsimin e mesëm. Sipas tij, në shkollën e mesme "Cvetan Dimov", 90 për qind nxënësit shqiptarë regjistrohen në paralele maqedonase, ndërsa e njëjta ndodh edhe nëpër shkollat profesionale në lagjen Autokomandë.

Thellohen marrëdhëniet mes dy universiteteve USHT dhe UT me marrëveshje bashkëpunimi

Tiranë, 28 gusht 2008 - Në praninë e udhëheqësve e dekanëve të dy universiteteve, rektorët e Universitetit Shtetëror të Tetovës dhe Universitetit të Tiranës nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit. Marrëveshja përfshin bashkëpunimin në organizimin dhe zbatimin e arsimimit deridiplomike dhe pasdiplomike, shkëmbimin e përvojave për programet studimore, shkëmbimin e profesorëve dhe studentëve, mundësimin e transferimit të studentëve, zhvillimin e përbashkët të aktiviteteve arsimore dhe hulumtuese shkencore, bashkëpunimin e bibliotekave, shkëmbimin e literaturës, artikujve dhe broshurave, organizimin e takimeve shkencore e profesionale, konferencave, simpoziumeve dhe formave tjera. Rektorit i USHT-së, Sadi Bexheti vlerëson lartë ripërtëritjen e marrëveshjes së bashkëpunimit me Universitetin e Tiranës. "Universiteti i Tiranës gjithnjë ka qenë në gatishmëri të ofrojë eksperiencën për Universitetin e Tetovës. Edhe kjo marrëveshje përfshin të gjitha fushat e bashkëpunimit në nivel më të lartë mes dy universiteteve. Me hapjen e



studimeve master këtë vit akademik në USHT dhe të atyre të doktoraturës që planifikojmë nga viti i ardhshëm akademik, nevoja për bashkëpunimin e Universiteteve shqipfolëse është e domosdoshme. Këto janë praktika evropiane, ku të shumë universitetet bashkojnë fuqitë dhe krijojnë programe të specializuara. Pikërisht këtu jemi koncentruar", u shpreh rektori Bexheti. Nga ana tjetër, edhe rektori i Tiranës, Dhori Kule u shpreh mjaft optimist për ngritjen e bashkëpunimit mes dy universiteteve në nivel edhe më të lartë. "Këtë vit akademik do të rekrutojmë një numër të konsiderueshëm pedagogësh

të rinj. Aktualisht, asnjë anëtarë i stafit pedagogjik i UT nuk do të angazhohet në mësimdhënie në universitetet tjera jashtë kontekstit institucional, përveç në raste kur ka marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet universiteteve", është i mendimit Kule. Universiteti Shtetëror i Tetovës nga universitetet e Shqipërisë ka të nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi edhe me Universitetet e Vlorës, Shkodrës, Gjirokastrës, Universitetin "Marin Barleti" si dhe marrëveshje e përbashkët me më shumë universitete e që bashkërisht kanë formuar "Rrjetin e Universiteteve Shqipfolëse".

(U.H.)

Fermerët bllokuan rrugën Tetovë-Shkup

Tetovë, 28 gusht - Afër 100 fermerët të Maqedonisë Perëndimore nga ora 7 e mëngjesit të enjten sërish bllokuan magjistralen Tetovë-Shkup, në pikën e pagesës në Zhehinë. Të pakënaqur me çmimin që u paguajnë qumështoret, fermerët sot shprehur revoltën e tyre duke bllokuar rrugën për tre orë. Nëse nuk u plotësohen kërkesat atëherë është e mundshme që të therin bagëtinë. "As shteti as qumështoret nuk ka ofruar ndihmë dhe plotësim të kërkesave. Pakënaqësinë tonë e shprehim përmes protestës dhe bllokimit të rrugëve, për shkak të pagesës së ulët të qumështit dhe mos dhënies në kohë të



pagesës", tha Nadi Elezi nga Federata e Fermerëve të Maqedonisë Perëndimore. Sipas tij pa fond të bagëtisë dhe prodhim të qumështit pushtetarët e Maqedonisë duhet të harrojnë anëtarësimin në BE. Në anën tjetër qumështoret e refuzojnë mënyrën me të cilën fermerët

kërkojnë që të rrisin çmimin e qumështit. Ata kanë paralajmëruar se do të insistojnë që qumështi të prodhohet sipas standardeve të posaçme higjienike më të cilën do të arrihej çmimi i realit. Protestat do të vazhdojnë edhe ditëve të ardhshme. (U.H)

Vazhdojnë mosmarrëveshjet në SH.A "Dekon"

Punonjësit bllokojnë hyrjen e fabrikës

Gostivar, 28 gusht - Edhe përkaj asistencës policore për realizimin e vendimit gjyqësorë të sjellë nga Gjykata Themelore e Gostivarit, që u lejon anëtarëve të këshillit drejtues të Shoqërisë Aksionare "Dekon" në Gostivar, të hyjë brenda në hapësirat e fabrikës, punonjësi e revoltuar kanë penguar realizimin e këtij vendimi. Mosmarrëveshjet mes punonjëse,

sindikatsë së pavarur si dhe bordit drejtues zvarriten tash e dy muaj. Afër 260 nëpunës akuzojnë udhëheqjen e fabrikës se kanë bërë keqpërdorime gjatë menaxhimit me fabrikën, dhe kërkojnë që sa më shpejt të ndërhyjnë institucionet shtetërore "Nga 1 korriku punonjësi e fabrikës janë duke bojkotuar, kërkojnë të drejtat e tyre të cilat edhe nësi sindikatë i mbështes-

im fuqishëm", theksoi Cenovska Silvana, nga Sindikata e pavarur, e cila në emër të sindikatës theksoi se nga ana e tyre, u lejohet anëtarëve të bordit drejtues që të hynë brenda në Fabrikë. Nga ana e sindikatës së pavarur, thonë se kërkesat e tyre janë legjitime. Ato kërkojnë që të paguhen rrogat e mbeturra, shpenzimet e shqimtit dhe rrugës si dhe pagesa e kontributeve. (D.Z)

Bastiset "Monopoli" i Tetovës

Arrestohet Gjyleri

Gjatë një aksioni policor janë arrestuar bashkëshortja e Bacit, Gjylere Hajredini, e bija Arta Abedini, Xhemile Osmani, Besnik Ibishi, Isak Mehmeti dhe pjesëtarë të sigurimit "Linuks", të cilët më vonë janë lëshuar



"Linuks", të cilët më vonë janë lëshuar.

Tetovë, 28 gusht - Në orët e para të së enjtes, me urdhër të Gjykatës së Tetovës, është bastisur ish godina e "Monopolit" ku gjendet shtëpia e Izair Samiut i njohur si Komandant Bacit. Gjatë një aksioni policor janë arrestuar bashkëshortja e Bacit, Gjylere Hajredini, e bija Arta Abedini, Xhemile Osmani, Besnik Ibishi, Isak Mehmeti dhe pjesëtarë të sigurimit

Zdhënësi i Ministrisë së Punëve të Brendshme Ivo Kotevski, ka konfirmuar ak-

sionin, por nuk ka dhënë hollësi të shumta, sikurse edhe për praninë e madhe të forcave policore që të enjten kishin bllokuar aksin rrugor



Tetovë-Shkup.

Brenda objektit forcat policore nuk kanë lejuar hyrjen. Persona të afërt me familjen e Komandant Bacit kanë deklaruar se në aksion kanë marrë pjesë mbi 300 forca policore ndërsa nuk kanë përjashtuar mundësinë që aksioni të ketë patur edhe prapavijë politike. (U.H.)

MPB zbarch rast tregtie me njerëz

Kapen valltare në Tetovë

Më 26 gusht të këtij viti, me urdhër gjyqësor paraprak, është kryer kontroll në lokalin "Premier - B" pronë e të akuzuarit të parë B.D. ku janë gjetur tri shtetase të Maqedonisë, në mesin e të cilave edhe një e mitur 17 vjeçare



Tetovë, 28 gusht - Sektori kundër tregtisë me njerëz pranë Ministrisë së Brendshme në bashkëpunim me policinë e Tetovës kanë zbuluar rast të tregtisë me person të mitur, si dhe kontrabandë të emigrantëve. Sipas policisë për këto vepra penale dyshohet B.D. (32) pronar i objektit hotelierik "Premier - B" në hyrje të Tetovës dhe kushëriri e tij B.D. (33) që të dy nga Tetova. Më 17 gusht të këtij viti, Policia rrugore ka ndaluar një veturë taksi në të cilën janë transportuar shtetaset serbe R.L. (19) dhe S.R. (20) dhe pasi e para nuk ka poseduar me vete dokument udhëtimi janë dërguar në policinë e Gostivarit. Në bisedë e sipër me vajzën R.L. është mësuar se ajo për herë të parë në Maqedoni kishte ardhur në periudhën 2006/2007 duke punuar rreth 10 muaj në objektin hotelierik "Zilati 9" në fshatin Çegran, ku pas një aksioni policor është arrestuar dhe dëbuar me ndalesë për hyrje në një kohëzgjatje prej një viti. Ajo, gjatë muajve qershor-korrik, më tepër herë kishte biseduar me shoqen e saj nga Beogradi



J.N., e cila për momentin kishte vendosur në Tetovë së bashku me një shtetase tjetër serbe V.N. e cila gjithashtu kishte punuar në objektin hotelierik "Premier - B", thuhet në kumtesën e policisë. Më 26 gusht të këtij viti, me urdhër gjyqësor paraprak, është kryer kontroll në lokalin "Premier - B"

e kishte kaluar kufirin dhe ishte vendosur në Tetovë së bashku me një shtetase tjetër serbe V.N. e cila gjithashtu kishte punuar në objektin hotelierik "Premier - B", thuhet në kumtesën e policisë. Më 26 gusht të këtij viti, me urdhër gjyqësor paraprak, është kryer kontroll në lokalin "Premier - B"

pronë e të akuzuarit të parë B.D. dhe në lokal janë gjetur tri shtetase maqedonase, në mesin e të cilave edhe një e mitur 17 vjeçare. Në bisedë e sipër me të miturën A.N. mësohet se ajo ishte e vendosur në Qendrën për pranimi i fëmijëve me probleme psikosociale - "25 Maj" në Shkup deri në vitin 2006, dhe se pas daljes nga entë, dy vjet kishte punuar në objektin hotelierik në Tetovë, prej nga sipas preferencave kishte ardhur të punojë në lokalin "Premier" si kameriere për një mëditje prej 10 euro dhe 100 denarë për konsumim të pijes me ndonjë nga klientët. Gjithashtu, gjatë kontrollit, sipas policisë janë gjetur edhe tri canta femrash në të cilat ka pasur dokumente udhëtimi dhe të tjera të shtetaseve të huaja, të cilat në momentin e kontrollit kanë qenë në objekt, përkatësisht e kanë lëshuar para hyrjes së policisë. (I.I)

Çifti kërcënon vajzën me incizimet

Shkup, 28 gusht - Sektori i Punëve të Brendshme (SPB) në Shkup, ka ngritur kallëzim penal kundër K.I. (28) dhe S.K.I. (22), çift bashkëshortor nga Shkupi, për shkak të dyshimit bazë se të njëjtit kanë kryer veprë penale "kërcënim" dhe "ndihmesë". Me qëllim që për vete të krijojnë pronë jashtëligjore gjatë muajit gusht të këtij viti, K.I. i është kërcënuar një vajze 24-vjeçare nga Shkupi, se do t'ia zbulojë në opinion incizimet me video materiale kompromituese, të cilin paraprakisht e kishte siguruar përmes komunikimit kompjuterik reciprok. Me këtë, ai ka pasur për qëllim që të përfitojë 100 euro. Ndërkaq, e akuzuara e dytë e ka ndihmuar në kryerjen e veprës penale, duke marrë nga e dëmtuara të hollat dhe ia ka dhënë të akuzuarit të parë. Pas masave të ndërmarra taktike operative dhe marrjes së të hollave, të akuzuarit janë arrestuar. Pas kontrollit të kryer, tek i akuzuari janë gjetur dhe konfiskuar me vërtetim 100 euro të cilat paraprakisht kanë qenë të përpunuara me krim-tëknikë, dhe në të njëjtën kohë tek ai është gjetur një celular i llojit "Nokia E 61" në të cilin ai e kishte incizuar materialin komprometues për të dëmtuarën si dhe për vajza tjera të panjohura. Me urdhër të gjykatësitet hetues është kryer kontroll në banesën e të akuzuarit, me ç'rast është gjetur dhe konfiskuar lap-top i llojit "Toshiba", ueb kamerë, tre kyçës USB, kartelë pagesore VISA elektronikën emër të tij. I akuzuari kalon në krim - evidencën për plaçkitje, dhunim dhe burg prej 5 vitesh, konfiskim i veturës, dhunë dhe burg prej 1 viti dhe 9 muaj, vjedhje të rëndë. MPB apelon tek të gjitha vajzat të cilat paraprakisht kanë qenë viktimë eventuale nga ane e të akuzuarit, të vijnë deri tek stacioni më i afërt policor dhe ta paraqesin rastin.

Rrëzohet aeroplan afër Ohrit

Katër vetë vdesin, fëmija shpëton

Ohër, 28 gusht - Katër vetë kanë humbur jetën në një aksident ajror që ndodhi të enjten tek vendi Skrebatno, afër fshatit Leskoc të Ohrit. Bëhet fjalë për aeroplan motorik të tipit "cesna" me shënim Z-3 DCV i cili është përplasur në veturën e parkuar Zastava 750, derisa e ka mbikëqyruar vendin ku mijëra besimtarë ortodoksë dje festuan festën e Shën Mërisë. Të vdekurit ishin pasagjerë të cilët në momentin e fatkeqësisë janë ndodhur në aeroplan. Ndërsa, në veturën në të cilën është përplasur fluturakja ka pasur një fëmijë, i cili nuk është lënduar.

Në bazë të Planit operativ për programe aktive dhe masat për punësim për vitin 2008, të parapara me Programin për punë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë 2006-2010 për masën aktive **PILOT PROJEKT – TRAJNIM PËR PROFESIONE TË CAKTUARA DHE AFTËSI TË CILAT JANË DEFICITARE NË TREGUN E PUNËS**, Agjencia për punësim e Republikës së Maqedonisë

PUBLIKON

SHPLLJE PUBLIKE

Deri te personat e papunë të evidentuar në qendrën për punësim të qytetit të Shkupit të cilët janë të interesuar që të fitojnë njohuri dhe aftësi për kyçje në tregun e punës

1. Ftoh të gjithë personat e papunë të cilët janë të interesuar për aftësi pune përmes fitimit të njohurive dhe aftësive për profesione në të cilat ekziston mungesë e aftësive, që të paraqiten në klubin e punës së Agjencisë së punësimit të Republikës së Maqedonisë – qendra për punësim e qytetit të Shkupit, ku janë të evidentuar si persona të papunë.

2. Në shpalljen publike mund të paraqiten persona të papunë, të cilët e plotësojnë njërin nga kushtet në vijim:

- **Persona të papunë për kohë të gjatë, të cilët janë në evidencë mbi 2 (dy) vjet me profesione të ngjashme apo të afërta me aftësitë me të cilat do të përfshihen me këtë masë;**
- **Persona të papunë të cilëve iu është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe më së shumti 6 (gjashtë) muaj janë të evidentuar si të papunë, me profesione të ngjashme apo të afërta me aftësitë të cilat do të përfshihen me këtë masë.**

3. Për personat e paraqitur ta papunë të cilët i plotësojnë kushtet nga pika 2 e kësaj shpallje publike dhe të cilët përmes plotësimit të fletëparaqitjes dhe deklarates për pajtim për pjesëmarrje në trajnim, Agjencia për punësim e Republikës së Maqedonisë, me përkrahje të Ministrisë për Arsimit dhe Shkencë dhe qendrës për arsimim profesional dhe trajnim, do të zbatojë trajnim sipas programit të për-

gatitur për profesione dhe veprimtari në të cilat ka mungesë të aftësive edhe atë për profesionet në vijim:

- elektro instalues dhe elektro monter
 - objekte ndërtimi (24 persona)
 - objekte industriale (24 persona)
- instalues dhe mirëmbajtës i instalimit gazësijellës dhe të ujit (36 persona)
- serviserë të sistemeve mehatronike (24 persona)

4. Trajnimet do të zbatohen në shkollat në vijim të qytetit të Shkupit sipas programeve arsimore të lejuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në një afat prej 3 (tre) muajsh.

5. Personat e papunë të cilët do ta kryejnë trajnimin dhe me sukses do ta japin provimin, do të marrin certifikata për aftësi pune.

6. Certifikatat do t'i ndajë Ministria e Arsimit dhe Shkencës në pajtim me Ligin për arsimim të të moshuarve.

7. Paraqitjen, personat e papunë të interesuar mund ta bëjnë më së voni deri më **15.09.2008** në **klubin e punës** në Agjencinë e punësimit të Republikës së Maqedonisë – qendra për punësim e qytetit të Shkupit, ku personat janë të evidentuar si të papunë

Informata shtesë mund të merren në Klubin e punës në tel.: 02/3138-434 apo në Shërbimin qendror në tel.: 02/3111-850.

Agjencia për punësim e Republikës së Maqedonisë



SWEDMILK
by majdanoski makronoski mlek

Sponsor gjeneral

Sot në katër sezone me kuzhinierin Dejan Hristovski në ora 17,00 në A1

Oriz i pjekur me perime dhe vezë

PËRBËRËSIT: Për përgatitjen e kësaj recete do t'ju nevojiten: 300 deri 350 gramë oriz, 2 karota, 2 tuba presh, majdanos, 1 kokë hudhër, 3 vezë, kripë, vegetë, biber i zi, vaj për ushqim.

PËRGATITJA: Orizin e lajmë e më pas e vejmë në ujë të kripës për tu zier. Pasi të zihet, ia derdhim ujin. Karotën dhe preshin i pastrojmë dhe i vejmë në ujë të vluar që të ziejnë. Karotën dhe preshin e zier i presim në copë të imëta. Majdanosin dhe hudhërin e presim imët. Në një enë më të thellë e vejmë orizin e zier, karotën, preshin, majdanosin dhe hudhërin. Të gjitha këto i bëjmë me kripë, biber dhe vegetë, dhe i përziejmë. Në fultere për pjekje të lyer me vaj e derdhim përbërjen dhe e rrafshojmë. Në oriz bëjmë thellësi për vezët. Në çdo thellësi e derdhim nga një vezë, duke pasur kujdes që verdhëz të mos shkapërderdhet, çdo vezë e kripësim. Fulteren e vejmë në furrë që të piqet në 180 gradë. Orizi i përgatitur mund të shërbehet edhe si haqe e veçantë apo si shtesë me mish.

MYSAFIRE: Katerina Tanevska - këngëtare








LAJMËRIM

Në lidhje me obligimet për **llogaritje, ndalesë dhe pagesë të tatimit personal të të ardhurave gjatë pagesës së prodhimeve të grumbulluara bujqësore**, Ministria e Financave dhe Drejtoria e të hyrave publike i informon kompanitë të cilat merren me grumbullimin e prodhimeve bujqësore, me sa vijon:

Të ardhurat e **bujkut individual**, puna e të cilit nuk e tejkalon veprimtarinë bujqësore nga vëllimi më i vogël dhe është i regjistruar në Regjistrin e bujqve individualë pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomizimit me Ujë, tatimoren sipas të ardhurave nga kadastra dhe janë të liruar nga tatimi personal i të ardhurave deri më **31.12.2008**.

1. Të ardhurat e bujqve të cilët janë të regjistruar si **tregtar individual**, puna e të cilëve nuk e tejkalon veprimtarinë bujqësore nga vëllimi më i vogël dhe është i regjistruar në Regjistrin tregtar, **tatimoren sipas të ardhurave të realizuara të vërteta**. Kjo kategori e bujqve gjatë porosisë së prodhimeve bujqësore duhet të lëshojnë fatura për çdo qarkullim të realizuar individual. Baza e llogaritjes së tatimit janë **neto të ardhurat e përcaktuara në bilancin tatimor** si dallim ndërmjet të ardhurave të përgjithshme dhe të dalurat e përgjithshme, **ndërsa tatimi dhe obligimi për pagesë përcaktohet me vendim të Drejtorisë për të hyra publike**.

2. Të ardhurat të cilat i realizojnë **personat fizikë të cilët në mënyrë të paparaqitur (të paregjistruar) kryejnë veprimtari bujqësore, i nënshtrohen tatimit me tatim personal të të ardhurave**.

3. Po që se grumbullimi i prodhimeve bujqësore kryhet nga qytetarë (bujq të paregjistruar) të cilët në mënyrë të paparaqitur kryejnë veprimtari gjatë shitjes dhe grumbullimit të prodhimeve bujqësore, siç janë: qumështi, rrushi, drithi e të ngjashme, **pa marrë parasysh nëse dedikimi i fundit është për tregun vendor apo eksport, grumbulluesi (paguesi i të ardhurave) është i obliguar të llogarisë dhe paguajë tatim personal për të ardhura në emër të qytetarit prej të cilit kryhet grumbullimi i prodhimeve bujqësore**.

Në të njëjtën kohë, **grumbulluesi është i obliguar që të gjitha pagesat e prodhimeve të grumbulluara bujqësore nga persona fizikë, t'i kryejë përmes llogarisë transaksionale, përkatësisht, është e ndaluar pagesat të bëhen me para të gatshme**.

**Për të mirën e përbashkët!
MINISTRIA E FINANCAVE**

**Tatimi yt! Ardhmëria jote!
DREJTORIA E TË HYRAVE PUBLIKE**

Pushteti vendor paralajmëron padi për EVN

Koha Shpend VINCA

Strugë, 28 gusht - Për shkak të shkyçjes së energjisë elektrike në stacionin e pompave të ujësjellësit, Struga nga e marta deri të mërkurën ngeli pa ujë të pijshëm. Arsyja ishte mospagesa e borxhit të vjetër të Ndërmarrjes publike "Proaqua" ndaj EVN-së, ndërsa pa ujë për 24 orë rresht mbetën amvisëritë, spitalet, Institutin e hemodializës, kopshtet dhe institucionet tjera. Nga pushteti lokal i Strugë konfirmojnë se i kanë shlyer obligimet rrjedhimore ndaj EVN-së, ndërsa për borxhin e vjetër, që në pjesën më të madhe është kolektorin për mbrojtjen e Liqenit të Ohrit, ishin ofruar disa variante, për c' arsye kryetari i Komunës, Ramiz Merko konsideron se me shkyçjen është bërë një precedent dhe vepër penale për të cilën Komuna kërkon zgjidhje përmes rrugës gjyqësore.

"Ujin në Liqenin e Ohrit e shfrytëzojnë hidrocentralet, nga të cilat shteti merr para. Deri tani asnjë denarë nuk është kthyer për t'u paguar të paktën energjia elektrike për sistemin e kolektorit, që është për

Struga 24 orë pa ujë

Nga e marta deri të mërkurën pa ujë ngeli e tërë Struga, përfshirë amvisëritë, spitalet, Institutin e hemodializës, kopshtet dhe institucionet tjera. Mungesën e ujit e ndjen edhe 30 mijë turistët që po qëndrojnë aty. Pushteti vendor paralajmëroi padi ndaj EVN-së

mbrojtjen e Liqenit të Ohrit", tha Merko. Ai më tej sqaroi se është arritur marrëveshje për servisimin e borxheve të cilat i trashëgojmë nga ish ndërmarrja dhe nga ish Komunat Strugë dhe Ohër të cilat datojnë nga para rreth dhjetë vitesh, Komuna, pohojnë kompetentët është gjetur në një situatë të palakmueshme. "Brenda vitit 2008 EVN i kanë paguar një pjesë të borxhit, një milion euro, ndërkaq kanë mbetur edhe 500



mijë euro për tu paguar. Merko pohon se EVN i është ofruar mundësia e kompensimit të borxheve përmes trafostacioneve dhe objekteve të tjera infrastrukturore që i posedon Komuna e Strugës. "Për dëmin që EVN ua ka krijuar qytetarëve të Strugës duhet të përgjigjet. Kemi ngritur padi kundër udhëheqësve të EVN, ndërkaq nga Gjyq

themelor në Strugë kemi kërkuar të sjellë masën e përkohshme me të cilën do ti ndalohej EVN që të ndërprejë furnizimin me energji elektrike "Proaqua" ashtu që qytetarët, spitalet dhe biznesi mos mbetet pa ujë", thotë Merko. Siç merret vesh Gjykata të mërkurën padite ka marrë vendim të përkohshëm që EVN të sigurojë furniz-

im të pandërprerë me energji elektrike të stacionit të pompave në Shum dhe të përbahet nga shkyçjet e mëtejme.

Merko gjithashtu theksoi se ministri i Financave ka patur takim me udhëheqësit e EVN dhe ku është debatuar për mundësinë dhe gjetjen e mënyrës që një pjesë të borxheve të paguajnë hidrocentralet

"Globoçica" dhe "Shpile" sepse ata e shfrytëzojnë ujin e liqenit. Kryetari i Strugës ka pohuar se është informuar për ndërprerjen e furnizimit me energji për pompat e ujit, por sipas tij masa e ndërprerjes është masa e cila kurrsesi nuk duhet të ndërmerret sepse krahas 100 mijë banorëve pa ujë mbeten edhe mbi 30 mijë turistët që qëndrojnë në Strugë.

Zëdhënësi i EVN-së, Zllatko Popovski lidhur me këtë problematikë ka theksuar se shkak i shkyçjes së "Proaqua" është i qartë. Borxhet e pa paguara as që kanë filluar të paguhen edhe pse ka patur biseda mes përfaqësuesve të EVN dhe ndërmarrjes për këtë çështje dhe ku është premtuar se përfaqësuesit nga Struga do të fillojnë me servisimin e borxhit, por deri më tani nuk është paguar asnjë denarë nga borxhi, ka pohuar zëdhënësi i EVN. Ai ka paralajmëruar se nëse në llogarinë rrjedhëse të EVN nuk derdhen mjete deri në fund të kësaj jave apo fillimit të javës që vjen, do të ketë ndërprerje të tjera të furnizimit me energji të pompave të ujit të "Proaqua"-a.

Publicitet



REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA PËR TRANSPORT DHE LIDHJE

Të nderuar,

Në pajtim me nenin 8-? nga Ligji për transport në komunikacionin rrugor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 68/04 dhe 127/06) dhe nenit 4 nga Rregullorja për mënyrën, procedurën dhe programin për dhënie e provimit për marrje të certifikatës për kompetencë profesionale të udhëheqësit apo, nga ai vetë, person i autorizuar me përgjegjësi për transportin, formën dhe përmbajtjen e certifikatës për dhënie e provimit dhe për certifikatën për kompetencë profesionale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 39/07), Ministria për Transport dhe Lidhje Ju informon se dhënie e provimit për marrje të certifikatës për kompetencë profesionale e udhëheqësit apo personit të autorizuar me përgjegjësi për transport, do të mbahet më datë **30 shtator 2008 në ora 17.00.**

Paraqitja për dhënie e provimit bëhet me parashtrësë të fletëparaqitjes deri te Ministria për Transport dhe Lidhje, më së voni 10 ditë para mbajtjes së provimit. Vendi i mbajtjes së provimit do të publikohet në ueb faqen e internetit të Ministrisë për Transport dhe Lidhje.

Në pajtim me nenin 100-? nga Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për transport në komunikacionin rrugor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 127/06), personat të cilët kanë më së paku pesë vjet përvojë pune në transport si udhëheqës apo person i autorizuar me përgjegjësi për transport dhe arsim të lartë, lirohen nga dhënie e provimit për marrje të certifikatës për kompetencë profesionale dhe të njëjtit duhet të dorëzojnë dokumentacion deri te Ministria për Transport dhe Lidhje me të cilin do të dëshmojnë se janë të liruar nga dhënie e provimit.

Për të gjitha informatat plotësuese, mund të kontaktoni në telefonin 02/3145-457.

Me respekt,

*Komisioni i zbatimit të provimeve
për marrje të certifikatës për kompetencë profesionale
të udhëheqësit apo personit të autorizuar me përgjegjësi për transport*

Përkujtohen demonstratat e Kumanovës

Kumanovë, 28 gusht - Në Kumanovë sot (29 gusht 2008) do të mbahet tubim përkujtimor me rastin e 20 vjetorit të demonstratave gjithë popullore në këtë qytet, të cilat atëbotë u zhvillu-

an në po këtë datë. Tubimi do të mbahet në restorantin Royal palace në afërsi të fshatit Çerkez me fillim në orën 18, ndërsa në të do të evokohen kujtimet e protagonistëve të asaj

demonstrate.

Nga organizatorët njoftojnë se në këtë eviniment pritet të marrin pjesë ish të burgosur politik nga Kosova, Maqedonia dhe më gjerë. (N.K.)

UEJL me diapazon të gjerë për komunikimet

Lider në shkollimin e gazetarëve dhe PR

Tetovë, 28 gusht - Gjithnjë e më shumë janë duke u rritur kërkesat për një kuadër profesional në gazetari, por edhe për persona për marrëdhënie me publikun. Mbase, për këta të fundit, jo vetëm organet e administratës shtetërore, por edhe kompanitë e ndryshme, po i theksojnë, gjithnjë e më shumë nevojat e tyre. Kështu konfirmojnë nga zyra e informimit e Universitetit Evropës-juglindore. Së këndejmi, ata theksojnë se UEJL në Tetovë është e pari universitet, që ofron studime të komunikimit në gjuhën shqipe. Po ashtu, ky universitet është i pari në përgatitjen e kuadrove për gazetari dhe marrëdhënie me publikun, ku si gjuhë studimi është gjuha shqipe. "Nga ky fakultet, deri më tani kanë dalë një numër i madh i të diplomuarve, të cilët tashmë janë punë-

suar në mediet dhe kompanitë më të rëndësishme në Maqedoni, thonë nga zyra e njëjtë. Programi trevjeçar Bachelor of Arts për drejtimin e Shkencave të Komunikimit përfshin studime interdisciplinare dinamike dhe interaktive. Nga këto studime pritet të gjenerojnë rezultate profesionale të adaptuara për nevojat e tregut integral global, në të njëjtën kohë, duke shërbyer si bazë për studimet në nivel pasdiplomik (cikli i dytë i studimeve). Ky program trevjeçar i përgatit studentët për vende pune në industrinë e medimeve, në vendet progresive dhe evolutive të strategjive komunikative dhe teknologjive që shfrytëzohen nga korporatat dhe organizatat tjera, në vende pune në marrëdhënie me publikun dhe politikën kuadrovike të trajnimit dhe zhvillimit.

Plan-programi i shkencave të komunikimit është i dizajnuar të adresojë diapazon të gjerë të profileve të diplomuar. Këto profile i kënaqin nevojat e tashme dhe të ardhshme të tregut të punës në fusha të caktuara të zhvillimit korporativ në fushën e medimeve (të vjetra dhe të reja), komunikimit interaktiv dhe digital, kompani të Internetit, paketim të përmbajtjeve digjitale, zhvillimin e portaleve, gazetarisë, teknologjive dhe projekteve multimediale, komunikimit korporativ dhe organizativ, marrëdhënieve me publikun etj. Përparësia shtesë është se studentët në semestrin e fundit marrin pjesë në praktikat studentore, nëpër të cilat kanë mundësi të fitojnë përvojë në aspektin aplikativ të shkencave të komunikimit. (U.H.)

Disa të plagosur dhe të lënduar

Përleshje mes serbëve dhe shqiptarëve në Mitrovicë

Sipas raportit fillestar të policisë kosovare janë disa të plagosur, me plagë të lehta, ndërsa shtoi se janë dëgjuar edhe të shtëna me armë zjarri

Mitrovicë, 28 gusht - Një incident në pjesën veriore të Mitrovicë ka ndodhur të mërkurën në mbrëmje rreth orës 23 ku ka pasur përleshje mes disa serbëve dhe shqiptarëve. Siç ka konfirmuar për mediat kosovare, zyrtari policor në Drejtorinë e policisë në Mitrovicë, toger Nimon Jonuzi, fillimisht ka pasur një konflikt verbal mes disa të miturve shqiptarë dhe një serbi, tek lagja "Tre rrokaqiejt", ndërsa më pas kanë ardhur edhe



serbë të tjerë dhe ka eskaluar konflikti. Toger Jonuzi tha se sipas raportit fillestar janë disa të plagosur, me plagë të lehta, ndërsa shtoi se janë dëgjuar edhe të

shtëna me armë zjarri. Jozyrtarisht mësohet se në këtë përleshje janë palgosur lehtë katër pjesëtarë të minoritetit serb dhe po aq shqiptarë të përfshirë në

konflikt.

Situata aktuale në Mitrovicë paraqitet e qetë ndërsa policia dhe KFOR-i po vazhdojë hetimet për ta zbardhur rastin.

Publikohen emrat e 10 ambasadorëve të Kosovës

Prishtinë, 28 gusht - Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, në mbledhjen enjte të kabinetit qeveritar, ka publikuar emrat e 10 të ngarkuarve të parë në ambasadat e Republikës së Kosovës në botë. Avni Spahiu, do të jetë ambasador në Uashington, ndërsa në Nju-Jork, Sylejman Gashi. Në Londër-Muhamet Hamiti, Berlin - Vilson Mirdita, Paris - Muhamedin Kullashi, Romë - Albert Prenkaj, Bruksel - Ilir Dugolli, Bern - Naim Mala, Tiranë - Gazmend Pula, Vjenë - Sabri Kijçmari dhe në Ankara - Bekim Sejdiu.

Kryeministri Thaçi, pasi ka vlerësuar si shumë të rëndësishëm takimin e sotëm të Qeverisë së Kosovës, në të cilin u bënë publik 10 emrat e të ngarkuarve me punë në ambasadat e Kosovës, ka theksuar sot po fillon ndërtimi i gjeneratës së diplomatëve tanë të cilët janë njerëz me veti të larta kombëtare, vizione dhe përkushtim. "Sot është një moment shumë i rëndësishëm për vendin tonë, ata do të kenë nderin dhe përgjegjësinë që ta përfaqësojnë vendin tonë", theksoi kryeministri Thaçi. Ai tha se përzgjedhja e këtyre emrave është bërë pas shumë konsultave brenda institucioneve të Kosovës dhe miqve ndërkombëtarë. Ndërsa, ministri i Punëve të Jashtme Skënder Hyseni, tha se sot po rumbullakohet një pjesë shumë e rëndësishme e procesit për shtetin e Kosovës duke bërë publik në vazhdim emrat e të ngarkuarve të parë me punë në ambasadat e Kosovës.

Qeveria e Kosovës do të dorëzojë listën me emrat e propozuar presidentit Sejdiu i cili pritet të dekretojë së shpejti.

Deputeti i vetëm shqiptar në parlamentin serb, Riza Halimi



Beogradi të ndalojë diskriminimin e shqiptarëve të Luginës

"Të drejtat të cilat me Dokumentin e Ahtisarit u sigurohen pakicave, në radhë të parë serbëve në Kosovë, pretendojmë të njëjtat t'i realizojmë edhe në këtu në Luginë të Preshevës, në kuadër të strukturave shtetërore të Serbisë dhe kjo është një kërkesë dhe një angazhim mjaft real, them legjitim", deklaroi Halimi

Preshevë, 28 gusht - Deputeti i vetëm shqiptarë në Parlamentin e Republikës së Serbisë, Riza Halimi në një intervistë për agjencinë e lajmeve INA, thotë se Qeveria e Serbisë po vazhdon avazin e vjetër duke shtypur dhe diskriminuar shqiptarët e Luginës së Preshevës. Ai kërkon që shqiptarët në këtë komunë të paktën të kenë të drejta të barabarta me pakicën serbe e cila jeton në shtetin e Kosovës.

"Të drejtat të cilat me Dokumentin e Ahtisarit u sigurohen pakicave, në radhë të parë serbëve në Kosovë, pretendojmë të njëjtat t'i realizojmë edhe në këtu në Luginë të Preshevës, në kuadër të strukturave shtetërore të Serbisë dhe kjo është një kërkesë dhe një angazhim mjaft real, them legjitim", deklaroi Halimi. Realizimin e këtyre të drejtave, Halimi

e sheh përmes një angazhimi demokratik dhe uniflikimit të faktorit shqiptarë në Luginë të Preshevës, por nuk i mohon edhe format tjera ndoshta edhe protestat. Ai thotë se vendimet e fundit të qeverisë serbe për mospranimin e diplomave të UP-së dhe mbylljen e televizionit të Preshevës janë të planifikuara më herët dhe synojnë të rrisin temperaturën politike në Preshevë.

"Ka gjasë që gjitha këto vendime të jenë në kuadër të planit operativ të Qeverisë serbe që përgatitet para shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Pra jo rastësisht pos problemit të televizionit të "Preshevës" doli problemi edhe më i rëndë i mos pranimit të diplomave të UP, edhe pse ato ishin pranuar në vitin 2001 me kusht që të jenë formuluarë të UNMIK-ut dhe me vulë të UNMIK-ut",

theksoi Halimi. Ai për korrespondentit e agjencisë së lajmeve INA tha se i gjithë spektri politik në Luginë të Preshevës do të kërkojnë përmirësimin e statusit të shqiptarëve në këtë komunë. "Gjitha subjektet politike edhe sektori joqeveritar, gjitha format dhe energjitë që i kanë shqiptarët këtu në Luginë të Preshevës, do të arrijmë një senzibilizim, që normal të kërkojmë zgjidhjen e problemeve në kuadër të qeverisë edhe në kuadër të institucioneve ndërkombëtare. Këto ditë do të kërkojmë ndihmë edhe nga Qeveria në Tiranë dhe nga Qeveria në Kosovë", u shpreh Halimi duke shtuar se mund të ndodhë që aktiviteti i tij si deputet pësoj një ngrirje të përkohshme apo të tërheqje definitive nëse nuk realizohen kërkesat e shqiptarëve. (Ina)

Pas njohjes së rajoneve separatiste nga Rusia

Serbia në pozitë të palakmueshme

Beograd, 28 gusht - Nëqoftëse Serbia do të nisej gjurmëve të Moskës, do të shkelte mbi argumentet e saj për integritetin territorial, sepse do ta prantonte shpalljen e njëanshme të pavarësisë së provincave georgjiane. Nga ana tjetër, nëse Serbia do të mbetej anash, ajo do të mund ta zemëronte Moskën, e cila është partneri më i rëndësishëm i saj në betejën për mbrojtjen e Kosovës. Dusan Lazić, nga Forumi për Marrëdhënie Ndërkombëtare, mendon se Beogradi në asnjë rast nuk guxon ta njohë Osetinë Jugore dhe Abkhazinë, sepse, në të kundërtën Serbia do të dëshmonte se nuk po udhëheqë një politikë principiale kur bëhet fjalë për Kosovën. "Po që se Serbia ndërmerr hapa të mëtutjeshëm, e ic dihet këtë po e bën në OKB, përmes kërkesës për t'u aprovuar Rezoluta me të cilën OKB do t'i drejtohej Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ashtu që kjo e fundit të ofrojë mendimin e saj juridik rreth Kosovës, mendoj se ajo duhet me përkushtim të mbetet në atë vijë dhe të mos ndërmarr ndonjë lëvizje të nxituar dhe ta përcjellë Rusinë në qëndrimin që nuk përputhet me atë të Serbisë lidhur me Kosovën", theksoi Lazić. E përkundër të gjithave, Dusan Lazić megjithatë nuk e përjashton as mundësinë që Moskë zyrtare nga qeveria e Beogradit të kërkojë njohjen e pavarësisë së dy provincave të shkëputura georgjiane. Nëse kjo ndodh, Lazić mendon se qeveria serbe duhet që të mënyrë të argumentuar të përgjigjet s përse nuk është në interesin e saj që ta mbështesë cenimin e integritetit territorial të Gjeorgjisë. "Nuk mundet që në një rast, meqenëse kjo çështje veç lidhet në njëfarë mënyre, të mbrohet integriteti territorial i shtetit, e në rastin tjetër të mbrohet parimi për vetëvendosje dhe për shpalljen e pavarësisë së shteteve. Andaj, braktisja e këtij pozicioni parimor edhe paraqet shembullin më të mirë të standardeve të dyfishta ose të shumëfishta, të cilët përndryshe në kushtet aktuale të marrëdhënieve ndërkombëtare shfrytëzohen nga shtetet e fuqishme të botës", pohon Lazić. Megjithëse, përkundër zhvillimeve të fundit, Lazić nuk pret ndonjë ndryshim të qëndrimit të deritanishëm të Moskës ndaj Kosovës. "Qëndrimi rus ndaj Kosovës nuk paraqet për kraje të qëndrimit tonë. Qëndrimi rus ndaj Kosovës ishte një qëndrim që bazohej në interesat e Rusisë dhe ai para se gjithash ishte një porosi për partnerët kryesorë në Perëndim, por, le të them ashtu, edhe për ata me të cilët Rusia garon në raportet ndërkombëtare. Kështu që, para se Rusia të merrte qëndrim për atë se nuk do të duhej ta prantonte pavarësinë e Kosovës, rusët shumë mirë brenda këtij pozicioni i ndëruan edhe interesat e tyre. Meqë ata interesat nuk ndryshuan deri tani, unë nuk di se përse rusët do ta ndryshonin qëndrimin e tyre as tash e tutje", përfundoi Lazić.

Shqipëria dënon
njohjen ruse të Osetisë
e Abkhasisë



Rusia po shkel rezolutat e OKB, Kosova rast tjetër

Tirana zyrtare kundërshton vendimin e Rosisë për të njohur pavarësinë e dy rajoneve separatiste të Gjeorgjisë. Njëpër një deklarate për shtyp Ministria e Jashtme deklaroi se vendimi i Rosisë është i papranueshëm dhe këmbëgul se nuk ka paralele mes Kosovës dhe Abkhasisë e Osetisë së Jugut

Tiranë, 28 gusht - Shqipëria me anë të Ministrisë së Punëve të Jashtme ka dënuar vendimin e Rosisë për njohjen e Abkhasisë dhe Osetisë së Jugut, duke e konsideruar si hap të pajustificueshëm, të papranueshëm dhe në kundërshtim të plotë me të drejtën ndërkombëtare dhe me rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të votuara edhe nga vetë Rusia.

Në deklaratën e shpërndarë për mediat, Ministria e Punëve të Jashtme hedh poshtë me vendosmëri çdo përpjekje për të vendosur paralele midis Kosovës dhe rajoneve autonome të Gjeorgjisë, Abkhasisë dhe Osetisë së Jugut. "Kosova është rast unik dhe zgjidhja e zbatuar për të është unike. Si i tillë, ai nuk shërben e as nuk mund të shërbejë si model për zgjidhjen e konflikteve të tjera as në rajon, as jashtë tij", thuhet në deklaratë. "Duke mbështetur shkëputjen nga Gjeorgjia të Abkhasisë dhe Osetisë së Jugut, ndërkohë që në rastin e pavarësimit të Kosovës mbrojtja të kundërtën, Moskë po kompromenton përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare për zgjidhjen e drejtë, realiste dhe të qëndrueshme të konflikteve", thuhet ndër të tjerash në deklaratën e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë.

Ministria e Punëve të Jashtme shpreh mbështetjen e plotë për integritetin territorial dhe sovranitetin e Gjeorgjisë dhe i bashkohet thirrjes drejtuar Moskës zyrtare që, në mbështetje të të drejtës ndërkombëtare dhe parimeve themelore të sigurisë europiane, të rishikojë vendimin e saj për njohjen e Abkhasisë dhe Osetisë së Jugut, pasi vetëm kështu i kontribuohet paqes dhe stabilitetit në rajon e më gjerë.

Ish-presidenti amerikan, Bill Clinton i ka dhënë një mbështetje të fortë kandidatit presidencial të Partisë Demokratike, Barack Obama vetëm disa orë pasi ai u shpall zyrtarisht si kandidat

Denver, 28 gusht - Siç njofton një korrespondent i BBC-së në Konventë, zyrtarizimi i kandidatit ishte një moment mjaft simbolik. Një nga një përfaqësuesit e të gjitha shteteve amerikane dhe territoreve të jashtme u ngritën në këmbë për të njoftuar rezultatet e votimit të delegatëve të tyre në zgjedhjen e kandidatëve. Sikurse emri i senatorit Barack Obama edhe ai i senatores Hillary Clinton u vendos në listë në shenjë konsiderate për fushatën e fortë që ajo bëri në votimet paraprake. Kur votimi arriti shtetin e Nju Jorkut, Hillary Clinton mori mikrofonin për të bërë thirrje që Barack Obama të shpallej kandidat për president. Më në fund zyrtarisht u bë histori. Kandidati i parë afrikano-amerikan u shpall nga një grua që ai e mundi me rezultat shumë të ngushtë.

Konventa e Demokratëve amerikanë

Obama zyrtarisht kandidat presidencial



Zyrtarizimi i kandidatit është tjetër në kohën kur udhëheqësit e partisë vazhdojnë të jenë të shqetësuar se ata që votuan për rivalin e zotit Obama në betejën e ashpër për kandidatë të partisë, mund të ndërrojnë krah dhe të votojnë për kandidatin republikan, John McCain në zgjedhjet e nëntorit.

Ish presidenti amerikan Clinton i tha Konventës së

partisë se senatori Obama ishte i kualifikuar në mënyrë unike për presidencën e SHBA-së.

Duke folur para kandidatëve demokratë Clinton tha se ai dhe bashkëshortja e tij do të bënin çdo gjë që kishin mundësi që senatori Obama të zgjidhej. "Është e qartë se detyra e presidentit të ardhshëm do të jetë ndërtimi i ëndrrës amerikane dhe

ringritja e lidhshimit amerikan në botë."

"Çdo gjë që kam mësuar gjatë kohës që isha president dhe puna që kam bërë prej asaj kohe në Amerikë dhe në mbarë globin më ka bindur se Barack Obama është personi për detyrën", tha Clinton.

Edhe senatori Joe Biden është shpallur zyrtarisht si kandidati i partisë për zëvendës-president nga Konventa Demokratike. Ai foli para delegatëve dhe premtoi ndryshime në politikën ekonomike.

Barack Obama vetë bëri një paraqitje të paplanifikuar në skenën e konferencës. "Në fillim të fushatës ne kishim një ide shumë të thjeshtë që është ndryshimi në Amerikë nuk fillon nga kreu në bazë por nga themelet e sipër."

"Ndryshimi vjen ngaqë njerëzit e thjeshtë duan gjëra të jashtëzakonshme. Ne duam të jemi të hapur në këtë konventë për të siguruar se të gjitha ata që duan t'i bashkohen partisë i bashkohen përpjekjeve për të rikthyer Amerikën", tha Obama. Obama bëri e zë mbështetjen e tij për Bidenin dhe falënderoi bashkëshortët Clinton për mbështetjen që ata i dhanë në konventë.

Reagime ndërkombëtare Agresion i pajustificueshëm rus



orgjisë si vend i lirë dhe i pavarur. Cheney do të vizitojë Gjeorgjinë, Ukrainën dhe Azerbajxhanin në javën e ardhshme.

Ndërkaq ministri i Jashtëm francez, Bernard Kouchner, ka deklaruar se pas rajoneve separatiste të Gjeorgjisë Rusia mund të ketë tani në shënjestër vendet tjera fqinje si Ukrainën dhe Moldavinë. Sjellja ruse ka vazhduar të shkaktojë indinjatë edhe në nivelet të tjera botërore. NATO-ja i ka bërë thirrje Rosisë, të tërheqë prapa njohjen e Abkhasisë dhe të Osetisë Jugore si shtete të pavarura. Në një deklaratë të publikuar në Bruksel NATO-ja e dënoi vendimin e udhëheqjes ruse. Ndërkaq ministri i Jashtëm gjerman, Frank-Walter Steinmeier ka thënë se logarit në një shtetësi të afërt të konfliktit midis Gjeorgjisë dhe Rosisë. Sipas fjalëve të tij, tani duhet bërë gjithçka për të qetësuar gjendjen.

Cheney tha se SHBA do të punojë me të gjithë aleatët për të siguruar integritetin territorial të Gje-

Revista "Forbs" radhit të parën
kancelaren gjermane

Merkel përsëri gruaja më me ndikim në botë



Nju-Jork, 28 gusht - Kancelarja gjermane Angela Merkel është gruaja më me ndikim në botë, tre vjet me radhë, sipas klasifikimit të revistës "Forbs" viti 2008. Merkel është në majë të listës së 100 grave më me ndikim të vitit, në bazë të karrierës së tyre, kontributit për ekonominë dhe deklaratat mediale. Në dhjetë vendet e para ndodhen gratë afariste, si dhe sekretarja amerikane e Shtetit, Kondoliza Rajs, e cila është e shtata në listë - për tri vende më poshtë për dallim nga viti i kaluar. Gjithsej 54 gra afariste dhe 23 politikane janë mes 100 grave më me ndikim në botë, së bashku me përfaqësues të mediave dhe të organizatave joqeveritare. "Forbs" thekson se 45 për qind e grave në klasifikimin e revistës nuk janë nga SHBA-ja. Një e treta e emrave janë të rinj, mes të cilave edhe presidentja e Argentinës, Kristina Fernandez.

Senatorja e Nju-Jorkut, Hilari Klinton është në vendin e 28-të në listë, nënkryetarja e Kongresit të SHBA-së, Nensi Pelosi është në vendin e 35-të.

Ministria franceze e Ekonomisë, Financave dhe Punësimit, Kristina Lagard është në vendin e 14-të, Sonja Gandhi - kryetarja e Kongresit nacional indian është në vendin e 21-të, mbretëresha e Jordanisë Rania, në vendin e 96-të, gazetarja televizive e SHBA-së, Oprah Winfri në vendin e 50-të.

Rreziku që vjen nga gazetaria e sahanlëpirësve



Enver ROBELLI

A duhet t'i besohet një gazetari, i cili nëpër rrugët e Tiranës defilon me 'Porsche Cayenne', fundjavën e kalon diku në vilën e tij në bregdetin shqiptar dhe përherë është i gatshëm që me ton dashamirës t'i promovojë politikanët në pushtet, duke zhvilluar me ta intervista pa asnjë pyetje kritike? Fakti që ky lloj gazetari krekoset me 'Porsche Cayenne' në njërin ndër vendet më të varfra të Evropës nuk ka fare të bëjë me zilinë sociale ndaj tij; përkundrazi: vozitja me 'Porsche Cayenne' është shenjë e mjaftueshme dalluese e korruptimit dhe të de-tonon të mendosh se ky pseudogazetar nuk ka mision publicistik, por ka zgjedhur gazetarinë si fushë tregtie për t'u pasuruar me metoda të fëlliqura. Në këtë rrugë ky soj gazetari është i gatshëm që në çdo kohë t'ua lejë mustaqet me mjalte politikaneve, të jetë përherë në pozitën e sahanlëpirësit, t'i shantazhojë qeveritarët në vendimarrje derisa të fitojë ndonjë privilegj dhe, pastaj, t'i lavdërojë deri në qiell. Ky lloj i bastarduar i gazetarit është në anën e pushtetarëve, deri në atë moment kur e vëren se në zgjedhjet e ardhshme do të fitojë opozita. Këtu e tutje ky tip i gazetarit idiot i vardiset opozitarëve si një kurvë, sepse e di se ata nesër do të jenë në pushtet. Shumica e politikanëve shqiptarë janë përherë të gatshëm të lozin këtë lloj me gazetaret e korruptuar, sepse kështu e kanë më lehtë të jenë të pranishëm në ekranet televizive dhe në gazeta. Shqipëria deri më tani ishte ndër vendet e rralla në Evropë, ku një pushtetar i lartë mund t'i telefononte një gazetari të ashtuquajtur prominent dhe t'i thoshte: "Dua të inkuadrohem drejtpërdrejt në emi-

Gazetarë apo tregtarë? Në Kosovë po kopjohet modeli më i fëlliqur i gazetarisë - ai i Tiranës

sionin tënd për të dhënë një mesazh për opinionin".

Për fatkeqësinë e Kosovës modeli i koroditur i gazetarisë së Shqipërisë ka filluar ngaherë të kopjohet edhe nga disa fletushka të Prishtinës. Gazetarë deri dje krejtësisht anonimë, kacajela të përsitër, hiqen si autoritetet të publicistikës, shesin mend në veten e parë dhe - mbi të gjitha - shtyhen me bërryla se cili më së shumti do të dëshmohej në rolin e canaklëpirësit në tezgën e pushtetarëve. Për këtë shërbim me përlulsi të paparë ky soj i gazetareve të Prishtinës shpërblehet prej autoriteteve. Dikur këto shpërblime janë dhënë në formën e qofteve, ndonjë gote me raki ose verë. Tash dhuratat janë shtuar, për shembull me hapësira banimi, troje, shtëpia, vetura, para të gatshme, me trajtim të privilegjuar, me gallata e darka, muhabete për jetën e natës, pushimet në plazhe etj.

Për këtë devijim nuk mund të akuzohen në radhë të parë pushtetarët. Ata vetëm kanë gjetur një kamarillë gazetare, të cilët janë të gatshëm të shkelin mbi etikën mediale, të dëgjin kredibilitetin profesional dhe të korruptohen deri në fytyrë. Në Kosovë me vite ekziston modeli i botuesit-gazetarit, i cili për çdo ditë shtet mend me shkarravina dhe luan rolin e publicistit të pavarur. Në të njëjtën kohë ky kalemxi luan edhe rolin e politikantit, bashkëpunon me partitë e krimin të organizuar dhe grabit pasurinën publike. Tani po krijohet modeli tjetër: ai i gazetarit që si orientim dhe si shembull që duhet imituar e sheh gazetarin e vetëshpallur elitare në Tiranë, i cili në ekran e ekspozon orën e tij 'Rolex' si simbol shkëlqimtar i korruptimit. Duket që për këtë model të keq gazetaria ka filluar të shqetësohet edhe Shkëlzen Maliqi. Në një koment

ai tërthorazi e paralamjëroi kryeministrin se nëse lakmon korruptimin e medie, atëherë kjo do t'i kthehet atij si bumerang. Shqetësimi i Maliqit duket i pavend. Është në natyrën e çdo pushtetari që të ndikojë në media. Do të ishte e udhë që publicistët në Prishtinë të bëhen më shumë merak pse disa gazetarë fletushkash me lehtësi të padurueshme po bëhen shërbëtorë të pushtetarëve. Reagimi publik duhet të drejtohet më shumë në demaskimin e këtyre gazetaruëve, të cilët në skenën mediale janë futur si kuaj Troje.

Për t'i rezistuar kësaj murtaje publike nuk mjaftojnë shoqata qesharake gazetarësh, të cilat reagojnë vetëm kur sulmohet ndonjë gazetari. Ata publicistë e gazetarë që ende nuk e kanë shitur dinjitetin profesional dhe gazetarinë vazhdojnë ta shohin si instrument që i shërben publikut për të kontrolluar punën e pushtetit, duhet ta mbrojnë hapur, pa ngurrim dhe pa frikë ndershmërinë e profesionit. Ndryshe ekziston rreziku që gazetaret sahanlëpirës të marrin në zotërim debatin publik me zhurmën e tyre primitive. Kapitali më i madh që kanë gazetaret është besueshmëria e tyre. Është shumë e qartë se jo pak gazetarë fletushkash në Prishtinë këtë besueshmëri e kanë humbur ngaherë, vullnetarisht - dhe duke notuar nëpër moçalin e korruptonit e kanë diskredituar edhe profesionin e gazetarit. Kështu ky lloj gazetare të pushtetarit ka krijuar përshypjen se, në fund të fundit, krejt punëtorët mediale janë të korruptueshëm - ngjashëm si politikanët. Domethënë se janë një lloj, vetëm në taburë rastësisht të ndryshëm. Kjo përshypje nuk guxon të bëhet realitet i durueshëm në Kosovë. Mjafton shembulli tmerrues i Shqipërisë. (robelli@bluewin.ch)

Victor Yushchenko
The Washington Post

Konflikti në Gjeorgji zbuloi probleme të cilat shtrihen përtej rajonit tonë. Ngjarjet e fundit kanë qartësuar se sa e rrezikshme është për komunitetin ndërkombëtar që të shpërfillojë "konfliktet e ngrira." Çështjet e rajoneve që duan të ndahen e të bëhen shtete të pavarura janë komplekse; shumë shpesh janë trajtuar si pulla për pazarliqe nëpër lojra gjeopolitike. Por "lojra" të tilla rezultojnë në humbjen e jetës së njerëzve, katastrofa humanitare, shkatërrim ekonomik dhe shembje të garancive ndërkombëtare për siguri. Ukraina është bërë peng në luftën e zhvilluar nga Rusia. Kjo ka shtyrë autoritetet ukrainase dhe të gjithë popujt e shtetit tonë, përfshirë ata të cilët

Gjeorgjia dhe rreziku për Ukrainën

Ukraina është bërë peng në luftën e zhvilluar nga Rusia. Kjo ka shtyrë autoritetet ukrainase dhe të gjithë popujt e shtetit tonë, përfshirë ata të cilët jetojnë në Crimea, të peshojnë rreziqet që burojnë nga fakti se flota ruse e Detit të Zi është bazuar në territorin tonë

jetojnë në Crimea, të peshojnë rreziqet që burojnë nga fakti se flota ruse e Detit të Zi është bazuar në territorin tonë. Ngjarjet tragjike në Gjeorgji gjithashtu vunë në shesh mungesën e mekanizmeve efektive parandalues nga ana e OKB-së, Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në

Evropë dhe organizatave tjera ndërkombëtare. Në Ukrainë shpresojmë që Federata Ruse do t'ia veshin opinionin të komunitetit global në mënyrë që çështjet në fjalë mund të zgjidhen me anë të bisedave. Ne duam përfundimin e grabitjes dhe shkatërrimit të infrastrukturës gjeorgjiane. Ne



Hilari Clinton

Për një Amerikë më të mirë

Unë jam këtu si një nënë krenare, një demokrate krenare, një senatore e Nju Jorkut, një amerikane për të mbështetur Barak Obamën. Miqtë e mi, është koha për ta marrë sërish vendin që duam

uar me kohë, pastaj gjithçka do të ketë lidhje me ju, popull amerikan, jeta juaj dhe e fëmijëve tuaj. Për mua ka qenë një privilegj t'ju takoj në shtëpitë tuaja, në vendet e punës, në komunitetet tuaja. Historitë tuaja më kujtuan se çdo ditë madhështia e Amerikës udhëhiqet nga jeta e popullit amerikan, puna juaj e vështirë, devocioni, dashuria për fëmijët tuaj, vendosmëria për të ecur përpara, shpesh duke u përballur me pengesa të panumërta. Ju më keni mësuar kaq shumë, më keni bërë të qesh, më keni bërë të qaj. Më keni lejuar të jem pjesë e jetës suaj dhe ju jeni bërë pjesë e jetës sime. Do ta kujtoj gjithnjë nënën e pamartuar që adoptoi dy fëmijë me sëmundjen e sutizmit. Ajo nuk kishte sigurim shëndetësor dhe kishte zbuluar se ishte me kancer. Por, më përshëndeti ndërsa në kokën pa flokë kishte vizatuar emrin tim dhe më kërkoi të luftoja për sigurim shëndetësor për të dhe fëmijët

e saj. Do ta kujtoj gjithnjë djalosin me bluzë marinsash nga Teksasi që kishte muaj që priste kuresh shëndetësore. Unë do t'ju jem mirënjohëse të gjithë njerëzve nga 50 shtetet, Puerto Rico dhe territoret që u bashkuan fushatës sonë në emër të të gjithë atyre që u harruan dhe u mënjanuan nga administrata Bush. Faleminderit mbështetësve të mi, kampionëve, miqve. Faleminderit, sepse ju kurrë nuk u ndalët dhe kurrë nuk hoqët dorë. Dhe bashkë kemi bërë historinë. Përgjatë rrugës, Amerika humbi dy kampione të mëdhenj demokratë që do të kishin qenë sot me ne, një prej liderëve të rinj më fisnikë demokratit e Arkansasit, Bill Gwatney, që besonte me gjithë zemër se e gjithë Amerika duke të jetë demokrate. Si dhe kongresmenen Stephanie Tubbs Jones, një mike të dashur, një nënë të kujdesshme, një lidere ku-rajoze që kurrë nuk hoqi

duhet të bëjmë çdo gjë që është e mundur që t'i parandalojmë provokimet dhe t'u shmangemi masakrave të mëtejshme. Konflikti i vazhdueshëm në mes Rusisë dhe Gjeorgjisë ndikon në interesat e shtetit tim. Operacionet ushtarake kanë ndodhur afër kufijve tanë dhe flota ruse e Detit të Zi ka qenë e përfshirë drejtpërdrejt. Pyetja e sigurisë kombëtare të Ukrainës u ngrit thekshëm. Duke pasur parasysh aktivitetet e flotës ruse, isha i detyruar të lëshoj një dekret për rregullimin e funksionimit të saj në territorin e Ukrainës. Nën këto rrethana, Ukraina nuk mund të rrinte e heshtur. Ne, së bashku me shtetet tjera, u angazhuam në kërkimin e një zgjidhjeje për konfliktin. Që nga ditët e para të trazirave, Ukraina bëri thirrje për një armëpushim të menjëhershëm nga të gjitha palët dhe shpërndau ndihma humanitare viktimave pavarësisht nga etniciteti i tyre. Ukraina mbajti përkrahjen e saj të ngurtë për sovranitetin dhe integritetin territorial të Gje-

orgjisë. Më 12 gusht, unë së bashku me kolegët e mi nga tri shtetet baltike dhe Polonia vizituaam Tbilisin. Propozimet tona që kërkonin një zgjidhje për konfliktin, ishin në harmoni me planin për marrëveshje të Bashkimit Evropian. Ne lavdërojmë përpjekjet e SHBA-së dhe presidentës së BE-së të udhëhequr nga francezët, që të arrihet një armëpushim, veprat e tyre dëshmuar të jenë të frytshme në ndaljen e luftës dhe derdhjes së gjakut. Ukraina është në favor të një reprezentimi më të gjerë të forcave paqeruajtëse në rajonin konfliktuoz. Një format i ri i shumanshëm me mandat të OKB-së, apo Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim të Evropës, është mënyra e vetme për të garantuar sigurinë në këtë zonë të konfliktit. Shpresoj fuqishëm që ky plan do të zbatohet rreptësisht nga palët që janë në konflikt. Ne jemi gati t'u bashkohemi përpjekjeve ndërkombëtare që të furnizojmë me ndihma dhe t'i ndihmojmë viktimat të vazhdojnë jetët e tyre në

paqe. Ukraina gjithashtu rri e gatshme që të marrë pjesë në misionet e OKB-së apo OSBE-së, duke dërguar paqeruajtës. Është e qartë se pos dimensioneve politike që përfshijnë rajonet që duan të ndahen, ne duhet të përballemi me aspektet sociale dhe ekonomike të këtij fenomeni. Shumica e këtyre provincave janë përtej kontrollit të qeverive përkatëse, apo komunitetit ndërkombëtar. Në shumë raste, mungesa e vrotimit i ka kthyer këto territore në vende të përkryera për kontrabandë dhe trafikime ilegale me armë, njerëz, dhe drogë. Korrupsioni dhe shkeljet e të drejtave të njeriut janë të shfrenuara. Këto rajone njihen për mungesë të procedurave demokratike zgjedhore dhe për mediat e tyre jo të lira apo të njëanshme. Dimensioi etnik i problemit shpesh teprohet, që të ndihmojë në mbulimin e praktikave kriminale. Aq më shumë, një rajon i cili është i mbushur me aktivitetet të tilla, parashtrohet një kërcënim ndaj lulëzimit dhe zhvillimit të kombeve të

afërta. Autoritetet zyrtare detyrohen që t'u kundërvihen sulmeve nga paramilitarët separatistë. Por nuk janë gjithmonë të suksesshëm. Para se të shpërthente konflikti në shkallë të gjerë në Gjeorgji, paqeruajtësit rusë dështuan në parandalimin e shkatërrimit të territorit gjeorgjian nga separatistët osëtianë. Në fakt, ky aktivitet u intensifikua në ditët pak para konfliktit të madh. Këtë fundjavë Ukraina festoi përvjetorin e pavarësisë. Konflikti edhe një herë ka dëshmuar se mënyrat më të mira për garantimin e sigurisë kombëtare në Ukrainë dhe shtete tjera është pjesëmarrja në sistemin kolektiv të sigurisë të kombeve të lira demokratike, shembull i së cilës sot është NATO-ja. Në përputhje me legjislativon kombëtar dhe prioritetet e politikave të jashtme të saj, Ukraina do të vazhdojë të përcjellë rrugën e integritit euroatlantik. Kjo është rruga e demokracisë, lirisë dhe pavarësisë.

(Autori është presidenti i Ukrainës)

dorë nga dëshira për ta parë Amerikën më të drejtë, më të zgjuar, më të fortë dhe më të mirë.

Kemi shumë përpara nesh, duhet të merremi me humbjen e vendeve të punës, strehimin, pagat që ulen, çmimet që rriten, Gjeokaten e Lartë në krizë, qeverinë tonë, deficitin më të madh të historisë së vendit, paratë e marra hua nga kinezët për të blerë naftë të sauditë; Putin dhe Gjeorgjinë; Iranin dhe Irakun. Unë kandidova për postin e presidentes për të rinovuar premtimin për Amerikën, për të rindërtuar klasën e mesme dhe për të mbështetur ëndrrën amerikane, për të siguruar mundësi për të gjithë ata që dëshirojnë të punojnë shumë dhe të shpërblehen shumë, në mënyrë që të kursejnë para për arsimin, një shtëpi, pensionin, të përballojnë faturat e gazit dhe të ushqimimit dhe të lënë mënjane diçka çdo muaj. Ne na duhen liderët edhe një herë në mënyrë që të na rikthehet besimi amerikan dhe optimizmi që i ka bërë më të aftë breza të tërë, para sfidave më të vështira, liderët që të na ndihmojnë duke na treguar ne dhe botës se me inteligjencën, kreativitetin dhe shpirtin inovativ nuk ka asnjë pengesë që nuk mund të kalohet në Amerikë.

Ne kemi nevojë për një president që kupton se gjënia e Amerikës është mbështetur gjithnjë te klasa e mesme, forca dhe vitaliteti i saj. Barack Obama e nisi karrierën e tij duke luftuar për punëtorët

e zhvendosur nga ekonomia globale. Ai e ndërtoi fushatën mbi një besim thelbësor se ndryshimi në këtë vend duhet të nisë nga baza dhe të arrijë deri në majë. Dhe ai e di se qeveria duhet të jetë për popullin dhe jo për ata pak të favorizuar. Dhe kur Barack Obama të jetë në Shtëpinë e Bardhë, ai do të rigjallërojë ekonominë tonë, do të mbrojë të drejtat e punës në Amerikë do të përballë me sfidat globale të kohërave.

Demokratët dinë si ta bëjnë një gjë të tillë. Me sa kujtoj unë, ne e bëmë këtë me presidentin Clinton dhe demokratët. Dhe nëse ne e bëjmë pjesën tonë, do ta bëjmë edhe me Presidentin Obama dhe demokratët. Vetëm mendoni se çfarë Amerike do të jetë ajo kur ne të transformojmë energjinë, të krijojmë miliona vende pune, të ndërtojmë një bazë të shëndoshë për rritje ekonomike dhe prosperitet, t'i japin shtresës së mesme çlirim që ata meritojnë nga taksat. Mezi pres të shoh Barack Obama që firmos ligjin për kujdesin shëndetësor që mbulon çdo amerikan.

Dhe ne e dimë se Presidenti Obama do t'i japë fund luftës në Irak në mënyrë të përgjegjshme, do të kthejë trupat në shtëpi dhe do të nisë rivendosjen e aleancave me botën.

Barack do ta bëjë këtë me një partnere të jashtëzakonshme si Michelle Obama. Të gjithë ata që e ndoqën dje fjalimin e Mishelës e dinë se ajo do të jetë një zonjë e parë e jashtëzakonshme për

Amerikën. Amerikanët janë me fat se Joe Biden do të jetë një lider i fortë, një njeri i zgjuar në krahun e Obamës, një politikan që e kupton stresin ekonomik brenda vendit dhe sfidat strategjike jashtë tij. Ai është pragmatik, i vendosur, i zgjuar. Dhe Xho, natyrisht, do të mbështetet nga gruaja e tij e mrekullueshme, Jill. Ata do të jenë një ekip shumë i mirë për vendin tonë. John McCain është kolegu dhe mik i mi. Ai i ka shërbyer vendit me nder dhe kurajë. Por ne nuk duam të presim katër vjet të tjerë në stancion ekonomik.

Ju e dini, Amerika është ende një vend i fuqishëm edhe pas 232 vitesh, sepse ne kemi përballuar çdo sfidë në çdo kohë të re, duke pasur besim te vlerat tona të barazisë për të gjithë dhe të së mirës së përbashkët. Unë e di se ç'do të thotë kjo për çdo burrë, grua e fëmijë në Amerikë. Unë jam senatore e SHBA-së, sepse në vitin 1848, një grup grash shumë kura-joze dhe një grup burrash të zgjuar u mblodhën në Seneca Falls në Nju Jork për të marrë pjesë në konventën e parë për të drejtat e grave. Ata nisën një betejë për të drejtën e votës që do të zgjaste 72 vjet, duke ia lënë stafetën nga nëna te vajzat, te mbesat, me nipë e stërnipër që i shoqëruan në këtë rrugë.

Këta burra dhe këto gra panë në sytë e vajzave të tyre dhe imagjinuan një botë më të drejtë dhe më të lirë dhe gjetën forcën për të luftuar, për t'u grumbullu-

ar, për të duruar talljen dhe poshtërimet, dhunën dhe burgun. Kështu, pas shumë dekadash, 88 vjet para se të vinte kjo ditë, amendamenti 19, që u garanton grave të drejtën e votës u vendos në kushtetut të tonë. Nëna ime ka lindur para se gratë të mund të votonin. Vajza ime votoi për nënën e saj që kandidonte për presidente. Kjo është historia e amerikanëve, e burrave dhe grave që sfiduan kohën dhe kurrë nuk u tërhoqën. Unë dua që ju të mendoni për fëmijët dhe nipërit tuaj në ditën e zgjedhjeve. Mendoni për zgjedhjet që bënë prindërit dhe gjyshërit tuaj dhe që patën kaq shumë ndikim në jetën tuaj dhe atë të vendit. Ne duhet të sigurohemi që zgjedhja që do të bëjmë atë ditë të përligjë sakrificën e paraardhësve dhe të mbushën jetën e fëmijëve tanë me mundësi dhe shpresë. Kjo është detyra jonë, të ndërtojmë këtë të ardhme të shkëlqyer, t'u mësojmë fëmijëve tanë se në Amerikë nuk ka asnjë barrierë aq të madhe, asnjë greminë aq të thellë asnjë qiell tepër të lartë për të mos u prekur nga ata që punojnë shumë, që kanë besim në Zot, në vendin tonë dhe të njëri-tjetri. Ky është misioni ynë, demokratë. Le të zgjedhim Barack Obamën dhe Joe Biden për këtë të ardhmen me vlerë të vendit tonë të madh.

(Fjalimi i senatores Hillari Clinton në Konventën Demokratike në Denver, SHBA)



TUNA fejoget me vëllain e Bertanit

Këngëtarja nga Maqedonia Tuna lidhjen e cili me Merti Asllanin e ka kurorëzuar me fejesë. Ditë më parë çifti të cilët patën ripërtëritje lidhjen e tyre të shkëputur prej kohësh kanë ndërruar unazat mes vete.

Nuk është folur për një martesë të mundshme megjithëkëtë duket se lidhja mes tyre vetëm sa po shkron duke u forcuar. Merti Asllani është vëllai i këngëtarit tjetër nga Maqedonia, Bertan Asllani.

Merti dhe Bertani janë udhëheqës të audio dhe video produksionit MBA, i cili tashmë ka realizuar videoklipin më të ri të Tunës, "Inati". Me këtë këngë Tuna në versionin e parë të saj në gjuhën maqedonase "Prashuvam bez Glas", ishte konkurrese në festivalin maqedonas i cili përzgjedh këngën përfaqësuese të Maqedonisë për "Eurosong".



Eralda Hitaj në "Vogue"

Modelja dhe "Miss Albania of Universe", Eralda Hitaj, është imazhi i ri, në fushatën publicitare të orës "Rolex".

Reklamat me Eralden gjenden në disa prej revistave më të njohura në botë, përfshirë këtu dhe edicionet e Vogue të Francës dhe Indisë. Sipas "Albaniac.com", revistat mund t'gjiniden nëpër kioskat e Amerikës dhe Evropës, ndërsa fotografia është realizuar nga Fotografi i njohur kosovar, Fadi Berisha.



Agnesa pushon në shoqëri të anglezëve

Bukuroshja kosovare Agnesa Vuthaj ka kaluar pushimet në plazhet e bukura të Egjiptit, ku përpos rrezeve të diellit ajo, ka gjetur argëtim edhe me "foret" angleze.

Nga burime të sigurta mësohet se bukuroshja ka qëndruar në një hotel ku përveç saj, motrës Sokolleshës, dhe një shoqeje, mysafirët e tjerë kanë qenë nga Britania e Madhe.

"Agnesa është kënaqur nga 'vicit' angleze dhe për të ka qenë një ndër pushimet në të mira që bukuroshja ka kaluar", ka thënë burimi i www.telegafi.com.

Pamela përballet me një gazetar "të trent"

Pamela Anderson, e cila bën kampanjën për mbrojtjen e të drejtave të kafshëve, ka mbetur e habitur gjatë një konference të fundit shtypi në Australi, pasi që një reporter ka 'rrezikuar' duke nxjerrë nga pantallonat e shkurtra të tij një këmbë pule.

Bukuroshja e serialit "Baywatch", ishte takuar me të njëjtin gazetar më herët gjatë kësaj jave në Sydney, për të promovuar shoun e saj "Pam: Girl On The Loose",

kur reporteri i inatosur kishte tentuar ta tërheqë vëmendjen duke lëshuar pantallonat e tij të shkurta dhe duke kërkuar nga Pamela të nënshkruajë brekëet e tij të kuqe.

Pasi që kishte nënshkruar emrin e saj në të brendshmet e tij, takimi i dytë me të kishte qenë sërish i pakëndshëm, pasi që Anderson ishte përballur me një këmbë pule të cilën gazetari e kishte nxjerrë nga pantallonat.



Gentës nuk i pëlqen shoppingu

Këngëtaresa kosovare Genta Ismaili nuk i pëlqen shoppingu dhe kjo është arsyeja pse këngëtarja nuk del shumë në qytet për të blerë.

Në një intervistë të bukuroshes për "Top Koha Music", ajo ka thënë se shumicën e gardërobës ia blen nëna, përderisa veshjen e ditës ia zgjedh teja e saj.

Gjatë intervistës, Genta ka lavdëruar bashkëpunimin e saj me Getin e "Tingullit 3NT", dhe ka njoftuar se për momentin nuk ka në plan të bëjë ndonjë bashkëpunim tjetër.

Jonas Brother dhe Kid Rock luftojnë për kreun

Pop grupi Jonas Brothers, ka shënuar edhe javën e dytë në krye të top listën amerikane të albumeve, duke e penguar Kid Rock të ngjitet në majë të listës.

Albumi "A Little Bit Longer" i tre vëllezërve, vazhdon të mbetet në krye të listës, derisa albumi i Kid Rock, "Rock'n'Roll Jesus" ka arritur vetëm në vendin e dytë të top listës. Rokeri "Staind", ka bërë debutimin më të mirë të javës, duke u ngjitur në vendin e tretë me albumin "The Illusion of Progress". Tre albumet e fundit të



benidit kanë debutuar që të gjitha në numër një. Albumi me këngë të filmit "Mamma Mia!" ndodhet numër katër, derisa repert i Ice Cube mbyllt top pesëshin, me albumin e ri "Raw Footage".

Madonna tenton të ndalojë publikimin e letrave

Madonna thuhet se është duke kërkuar kështilla legale në përpjekje për të ndaluar që letrat eksplicite që ajo ia ka dërguar ish-të dashurit të saj, të paraqiten në një ekspozitë kujtimore. Organizatorët e ekspozitës "Simply Madonna", shpresojnë që të publikojnë 17 letrat që Madonna ia kishte shkruar ish-të dashurit dhe truprojtës së saj, James Albright, duke i shfaqur këto shkrime intime në Londër në vitin e ardhshëm. "Kush do të

dëshironte që fjalët private të dedikuara dikujt që e don, t'i zbulohen? Avokatët kanë dërguar disa paralajmërime. Ajo shpreson që kjo të funksionojë", ka thënë burimi. Me shumë se 300 gjëra personale, përfshirë veshje, fotografi, skena filmike, kostume dhe gjëra tjera personale që i kanë takuar yllit të muzikës pop, do të shfaqen në kryeqytetin britanik në ekspozitën e paraparatë. Ajo pritet të zgjatë nga 21 shkurti deri në 22 mars të vitit të ardhshëm.



Diadema përgatitet për album të ri

Rok grupi kosovar "Diadema" është duke u përgatitur për albumin e parë, derisa kanë kaluar disa muaj pas lansimit të videospotit të tyre më të ri, "Jakup Ferri".

Një burim i afërt me bendin ka thënë për telegafi.com se ata janë duke punuar që të hedhin në treg albumin e tyre.

Mësohet se grupi ka punuar

shumë kohë në këtë album, i cili pritet të përmbajë këngë shumë kualitative të zhanrit rok, që pritet ta rikthejnë famën e grupin kosovar, jo vetëm në Kosovë por në të gjithë trojet shqiptare.

Grupi njihet për muzikën "hard rok", në të cilin zhanër ka shumë pak bende aktive në Kosovë, për ndryshim prej zhanrit rok - alternativ, ku ka mjaft bende.



T-Mobile ka shitur mbi 120.000 iPhone 3G

Kompania gjermane T-Mobile ka njoftuar se prej lansimit të iPhone 3G, më 11 korrik të këtij viti, ka shitur mbi 120.000 njësi të kësaj pajisje të çuditshme, përkundër të gjitha problemeve me shpërndarjen të cilat janë paraqitur, ka deklaruar drejtori ekzekutiv i kësaj kompanie.

Hamid Akhavan për revistën javore gjermane Focus ka shkruar se, për shkak të kështojtë së mëdhe, disa nga blerësit është dëshur të presin me javë të tëra që ky aparat i avancuar t'u arrinte në adresë të tyre.

"Parashikimet tona janë tejkaluar", ka thënë Akhavan në intervistë për Reuters dhe ka shtuar se vetëm në Gjermani janë shitur 75.000 telefona të tillë.

Problemet me shpërndarjen janë paraqitur kur kompania Apple ka vendosur që produkti të fillojë me shitjen në 22 shtete njehkohësisht.

Gjenerata e tretë e telefonave mobil ka lidhje dukshëm më të shpejtë të internetit nga seria e parë e cila është paraqitur në treg në mesin e vitit 2007. Megjithatë, përdoruesit nuk janë tërësisht të kënaqur as me këtë produkt. Zakonisht ankojnë për ndërprerje të papritura të bisedave dhe sinjal jostabil të internetit.

Vitamina D dhe fraktura e legenit

Shkencëtarët amerikan kanë pohuar se niveli i ulët i vitaminës D në gjak ri rrezikon për frakturë të legenit të femrat në menopauzë, madje për 70%.

Në studim janë përfshirë femrat të moshave ndërmjet 50 dhe 70 vjeçare, prej të cilave gjysma kanë qenë të shëndosha dhe kanë shërbyer si grup i kontrollit, ndërsa gjysma tjetër e kanë thyer legenin. Rezultatet kanë treguar se gratë me mungesë të vitaminës D kanë qenë ato të cilat kanë pasur legen të thyer lehtë dhe ato të cilat ishin të rrezikuara për thyerjen e legenit.



Mendes krenare për reklamën

Eva Mendes është e kënaqur që reklama e saj promovuese për parfumin e ri të Calvin Klein ka shkaktuar aq shumë tronditje duke thënë se vëmendja të cilën e ka tërhequr ky xhirim e bën atë krenare për trupin e saj.

"Më bën më shumë krenare. Po të kishte qenë për ndonjë firmë të zakonshme nuk do ta kisha bërë pasi që është rrezik për karrierën. Mirëpo të bësh një reklamë të tillë për kompaninë ikonike Calvin Klein, është diçka e veçantë", ka shpjeguar aktorja.

Reklama e cila e paraqet aktoren të zhveshur në pjesën e sipërme, ishte konsideruar si "teper seksi për të dalë në televizion", kështu që shumë rrjetet televizive kishin refuzuar ta tishonin atë.



Electra: Nuk shkoj me take në palestër

Aktorja seksi, Carmen Electra, ka kuptuar se shpenzimet shumë kohë duke u veshur me tesha të cekëta dhe bikini për të bërë fotografi dhe për skena filmike, ndërkohë që njerëzit shumë rrallë e shohin atë të veshur normalisht. "Nëra nga ideet e gabuara për mua është se njerëzit mendojnë se shëtit rrugëve me minifunda dhe take

të larta vazhdimisht, dhe shkoj me take në palestër...".

"Kur njerëzit më shohin të veshur normalisht, ata nuk mund ta besojnë një gjë të tillë. Është diçka vërtetë e çuditshme", thotë aktorja, e cila pranon se nganjëherë as ajo nuk e idetë e gabuara për mua është se njerëzit mendojnë se shëtit rrugëve me minifunda dhe take



Nga Parisi në Shqipëri, për të fotografuar martesën e Mbretit Zog

SYTË E GERALDINËS



Geraldina buzëqesh tek sa një grua mundohet t'i puthë duart. Në flokët e zinj ka një kurorë të artë, ndërsa fustani i gjatë i bardhë i shtrihet deri poshtë këmbëve. Kjo është dita më e bukur e vajzës hungareze që po lidh kurorë me Mbretin e shqiptarëve. Lucien Aigner, fotograf i agjencive kryesore të lajmeve në ato kohë, ka mbërritur në Shqipëri posaçërisht për të fotografuar martesën e Mbretit Zog. Atëherë, rreth të 40-ave, Aigner përpjet që të fokusojë në foto lumturinë që endej në sytë e Geraldinës. Si hungarez, Lucien e dinte se sa shumë e ëndërronin vajzat e vendit të tij ditën e dasmës. Aq më tepër, një vajzë si Geraldina, në gjenet e së cilës rridhte gjak mbretëror. Kjo martesë nuk ishte thjesht kurorëzimi i dashurisë me shqiptarin e gjatë dhe simpatik Zog, por një mënyrë për të forcuar më shumë mbretërinë shqiptare. Aigner fokusoi në aparat gjithçka. Që nga vështrimi që Zogu i hidhte nuses së tij, deri te gëzimi që shihej te të gjithë të ftuarit. Vajzat e veshur me fustane të bardha dhe hareja e motrave të Mbretit Zog. "Unë doja të fokusoja se çfarë mendonte Geraldina. Gjithë vëmendja ime ishte përqendruar në lëvizjet e kësaj gruaje të bukur", rrëfente ai. Nga vallet tradicionale shqiptare e deri te ftuarit e rëndësishëm, Aigner i tregoi botës festën e madhe të mbretërisë shqiptare. Janë të njëjtat foto që shfaqen kaq vite më pas në faqet kryesore të të përditshmeve tona, por edhe ato të huaja sa herë që flitet për martesën e Mbretit Zog.

Edhe atëherë kur ceremonia e dasmës kishte përfunduar, Lucien bëri një udhëtim në tokën ku kishte vendosur të jetonte Geraldina, për të parë jetën e atyre kafereve aq të thjeshtë në qendër të Ballkanit. Aigner, i cili kishte nisur të sillte një erë tjetër në fotografimin e reporterëve të gazetave, në Shqipëri kërkonte të fokusonte sa më shumë në aparat njerëzit. Një foto rrëfen më shumë se fjalët. Fotot e tij do të shfaqeshin gjithnjë në shtyp, jo vetëm atëherë kur Geraldinës iu desh të ndiqte pas të shoqin, duke u arratisur nga Shqipëria, por dhe kur në vend u vendos regjimi komunist. Kanë qenë ditë prilli ato kur Aigner u end kafeneve të Tiranës për të njohur psikologjinë e këtyre ballkanasve të çuditshëm, që tashmë do të kishin një mbretëreshë hungareze. Po kush është Aigner, fotot e të

cilit rrëfejnë Shqipërinë e vitit 1938? Lucien Aigner lindi në Hungari, në vitin 1901. Për herë të parë ai e mori aparatin në dorë në moshën 9-vjeçare, duke fotografuar anëtarët e familjes. Në moshën 25-vjeçari, ai nis punë si fotoreporter në "Az Est", një gazetë e njohur hungareze me seli në Budapest. Këto janë kohët kur fotografia fillon të mos jetë më thjesht një shkrepe, por një mënyrë për të depërtuar më thellë brenda saj. Nga Parisi, Aigner do të punonte si korrespondent për "London General Press".

Në vitin 1940, fotot për Musolinin në një moment relaksi duke shfryrë hundët, bënë xhiron e botës, duke qenë në faqet kryesore të çdo gazete apo agjenci lajmesh. Në vitin 1941, pasi kishte udhëtuar nga Franca drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për t'u arratisur persekutimit nazist, ai kaloi pak kohë në Princeton, ku i realizoi një sërë fotosh Albert Ainshtajnit. Fotot, që përdoren ende sot për Ainshtajnin, qenë më të preferuarat e tij. Parisin dhe SHBA-në e viteve 1930-1940 mund ta shohësh vetëm në fotot e tij. Përtej fotove politike, Aigner kërkonte t'i rrëfente botës jetën e vërtetë, të cilën e shihte kafeneve dhe rrugëve të SHBA-së. "Unë gjithmonë kërkoja të gjeja humanitetin në njerëzit që fotografoja", shprehej ai. Sot, punët e Aigner gjenden në koleksionet e galerive më të njohura të botës. Si një njeri që kërkonte të papriturat dhe e adhuronte të panjohurën, ai u bë një eksplorues i ngjarjeve dhe historive më të njohura në botë. Për ata që duan fotografimin dhe për fotografët e rinj, Aigner do të mbetet pionieri i fotografisë së lirë, si njeriu që e ktheu foton në një rrëfim artistik. Në vitin 1934, fotografitë e baletit në Paris në Grand Opera bënë bujë për mënyrën e realizimit.

Aigner ishte mjaftuar vetëm duke fotografuar këmbët, i bindur se ato e rrëfenin më së miri muzikën. Por përtej fotografive, vetë jeta e Aigner ishte një foto më vete. Duke rremuar në fotot që ka lënë pas, mund të shohësh dhe ditët që ai ka jetuar. Si fotograf, ai ndjente nga larg kur një ngjarje ndodhte dhe, pavarësisht sfidave, gjente mënyrën për të qenë atje. Sot, jeta e Aigner mund të shihet si një shkollë për të mësuar se nga buron arti i vërtetë. Lucien Aigner mbylli sytë në moshën 97-vjeçare, në vitin 1999. (Shqip)



Biden, njeriu që e njuh botën në majë të gishtave

Ndërsa administrata e Bushit ishte duke bërë përpjekjet e fundit për të ndërmarrë sulmin në Irak, senatori Joseph R. Biden po përpiqej që të formulonte një projekt-rezolutë, në të cilin theksohej nevoja për një zgjidhje diplomatike të problemit të Sadam Huseinit dhe armëve të tij të dëmtimit në masë. Por pavarësisht kësaj, ai i dha miratimin e tij përdorimit të forcës në Irak, gjithmonë nëse të gjitha opsionet nuk do të kishin funksionuar. Në kujtimet e tij, Biden shkruan se ky veprim kishte si qëllim kryesor forcimin e pozitës së Sekretarit të Shtetit, Colin Powell, i cili synonte të arrinte një marrëveshje për dërgimin e inspektorëve të armëve të OKB-së në Irak, pa nisur konfliktin. Por këto përpjekje, për një arsye apo një tjetër, u bllokuan dhe Biden u detyrua të votonte ndërmarrjen e masës ekstreme: ndërhyrjen ushtarake. Ajo ndodhi me miratimin e rezolutës për autorizimin e ndërhyrjes ushtarake, e cila u kalua nga Senati në tetor të vitit 2002. Përgjatë tri dhjetëvjeçarëve në Uashington, Biden ka qenë një nga liderët më energjikë të Partisë Demokratike për çështjet e politikës së jashtme. Ai ka marrë pjesë në shumë komisione dëgjimore, në zgjidhjen e shumë çështjeve delikate të sigurisë dhe madje ka këshilluar edhe Presidentin aktual për çështjet e tilla si plani për zgjerimin e NATO-s. Por nëse do të fitojë së bashku me Obamën garën presidenciale të nëntorit, Biden do të ketë një rol shumë më të vështirë: atë të njërit prej vendimmarrësve kryesorë për çështje që kanë të bëjnë me Shtetet e Bashkuara dhe me botën.

Atij do t'i duhet të keshillojë një President që do ta nisë punën me një përvojë modeste në çështjet e politikës së jashtme dhe që kërkon një zëvendës të aftë për t'i bërë opozitë çdo mendimi të tij në mënyrë që më në fund të dalë gjykimi më i mirë i mundshëm. Vetë Obama ka qenë një kundërshtar i luftës në Irak, që nga fillimi i saj, ndërkohë që zëvendësi i tij i mundshëm bëri të kundërtën. Por edhe më pas, gjatë hapave të parë



të fushatës elektorale, qëndrimi i Bidenit në lidhje me Irakun ka qenë i ndryshëm nga ai i Obamës. Ai ka qenë pro një pushteti të decentralizuar mes tri rajoneve autonome: sunitëve, shiitëve dhe kurdëve. Ndërkohë, sikundër Obama, ai për disa vjet rresht ka qenë kundër menaxhimit të luftës në

Irak nga ana e administratës së Bushit. Ai ishte veçanërisht kundra dërgimit në këtë vend të trupave shtesë.

Ndërkohë, aktualisht të dy mbështesin largimin e njësive luftare nga Iraku. Më konkretisht ata janë në një mendje me linjën e përgjithshme të demokratëve në lidhje me politikën e jashtme dhe çështjet e sigurisë kombëtare, që do të përkthehej: punë me aleatët dhe përdorim të forcës vetëm në rastet që nuk kanë asnjë rrugëzgjidhje tjetër. Gjatë karrierës së tij të gjatë në Senat, Biden ka krijuar një përvojë shumë të madhe. Vetëm gjatë vitit 2007 ai ka marrë pjesë në 50 komisione parlamentare për çështje të ndryshme dhe ka mbikëqyruar shumë të tjera si anëtar i panelit të çështjeve evropiane. Obama, që mban postin e vjetër të Bidenit, atë të kryetarit të nënkomitetit për Evropën, ka qenë i pranishëm vetëm në dy komisione, po edhe këto

ishin sesione që kishin të bënin me aprovimin e dy ambasadorëve. Përvajtjen më të madhe për shumë kohë Biden e ka pasur me kontrollin e armëve. Gjatë administratës së Reganit, ai nguli këmbë për t'iu përmbajtur në mënyrë strikte anëtarësimit në marrëveshjen antibalstike të raketave të vitit 1972 me Rusinë. Këtë marrëveshje, shumë nga bashkëpunëtorët e Reganit donin ta anashkalonin për t'i hapur rrugë zhvillimit të një programi mbrojtës hapësirë-tokë. Interesi i Bidenit për ish-Jugosllavinë nisi në vitin 1991, kur një murg katolik kroat erdhi ta takonte për t'i rrëfuar abuzimet e serbëve në Kroaci dhe Bosnjë.

Kur Jugosllavia nisi të ndahej copash, në fillim të viteve 1990, Biden kërkoi ndërhyrjen e amerikanëve në ndalimin e spastrimeve etnike në myslimanëve të Bosnjës. Ai ishte ndër të parët që mbrojtë heqjen e embargos së armëve ndaj mys-

limanëve të Bosnjës dhe nguli këmbë në furnizimin e tyre me armë të NATO-s. Kur ish-presidenti serb, Millosheviç, sulmoi kosovarët, Biden ishte ndër mbështetësit e zjarrtë të fushatës bombarduese të NATO-s, derisa forcat serbe të largoheshin nga Kosova. "Në thelbin e tij, Biden mendon se përfshirja e Amerikës në çështjet e botës mund të sjellë ndryshime për mirë", ka deklaruar James Rubin, një ish-këshilltar i Bidenit dhe Klintonit.

"Por për shkak se ai është një realist, mendon që veprimet e Shteteve të Bashkuara duhet të ndërmerren vetëm në bashkëpunim me miqtë dhe aleatët". Më pas Biden mbështeti edhe pavarësinë e Kosovës, pavarësisht protestave nga ana e Moskës. Së bashku me Obamën dhe senatorin John McCain, kandidati republikan për Shtëpinë e Bardhë, Biden, është një nga mbështetësit e anëtarësimit të shpejtë të Gjeorgjisë në NATO, një veprim ky që i ka vënë Shtetet e Bashkuara në konflikt me Rusinë. Por asnjë çështje nuk e ka përfshirë më shumë Bidenin, se lufta në Irak. Sipas të gjitha gjasave, tani që Obama e zgjodhi zëvendësin e tij presidencial, ai do të vazhdojë përqendrimin në këtë konflikt, për më tepër që vetë Obama ishte kundër ndërhyrjes që nga fillimi i procesit. Sipas disa bashkëpunëtorëve të tij, pas 11 shtatorit Biden u bind nga argumenti se rreziku që i kërcënohej Amerikës ishte shumë i madh dhe nuk mund të zgjidhej vetëm me mbrojtjen e vendit. Ai vetë nuk kishte parë kurrë lidhje mes Sadamit dhe Al Kaedës, megjithatë vetëm masa e sanksioneve ndaj këtij vendi i d'u k e j fare pak. Iraku në vetvete nuk përbente ndonjë kërcënim serioz, por programi i armëve të dëmtimit në masë, nëse do të zhvillohej në këtë vend, do të ishte jashtëzakonisht i dëmshëm për të gjithë.

Për këtë arsye, ai nguli këmbë në përpjekjet e OKB-së për dërgimin e inspektorëve të armëve në Irak. Ndërkohë ai ishte i mendimit se sulmi i armatosur duhet të ishte veprimi i fundit që duhej të ndërmerrej, pra kur çdo mjet tjetër ko-

munikimi kishte dështuar dhe ky sulm duhej të merrej në marrëveshje dhe bashkëpunim me të tjerët dhe nuk duhej të ishte kurrësi i njëanshëm. Mbi të gjitha, qëllimi i çdo ndërhyrjeje duhet të ishte shkatërrimi i programit të armëve dhe jo rrëzimi i Sadamit nga pushteti.

Gjatë fazës së parë të pushtimit amerikan, Biden fillimisht ishte i mendimit se në Irak duheshin më shumë trupa, por me ashpërsimin e konfliktit, me shtimin e numrit të të vrarëve amerikanë dhe rritjen e pakënaqësisë në vend ndaj luftës në përgjithësi, ai u bë mbrojtës i një plani të ri, një plani që kishte të bënte me zbatimin e përvojës së Ballkanit në Irak dhe që do t'i hapte derën mundësisë së një tërheqjeje të shpejtë. Në vitin 2006, në "New York Times", Biden shkroi një artikull në të cilin bëhej partizan i decentralizimit të Irakut nën shembullin e Bosnjës, pra krijimin e tre krahinave autonome sunite, shiite dhe kurde, ndërkohë që qeveria do të kishte një influencë jo shumë të fortë tek ato. Kritikët e hodhën poshtë këtë ide, duke argumentuar se dhuna sektare e fetare në këtë vend ishte aq e madhe, sa një gjë e tillë do të sillte shumë probleme.

Edhe pse plani i tij dështoi, qëllimi i tij ishte krijimi i një Iraku federal. Ky plan do mund të ishte i mirë sikur rritja e dhunës në këtë vend të mos i kishte përkeqësuar gjërat si për Uashingtonin, ashtu edhe për vetë qeverinë irakiane të Malikut. Me kalimin e kohës, pozicioni i Bidenit është afruar shumë atij të Obamës. Ashtu si edhe Obama, ai nënvizon nevojën e tërheqjes së të gjitha brigadave luftuese brenda 16 muajve të parë të presidencës, megjithatë gjatë këtyre dy muajve që kanë mbetur nga vota përfundimtare, pozicioni i tyre pritet të ketë ndryshime të tjera. Gjeneralët amerikanë ngulin këmbë që tërheqja e menjëhershme duhet të shmanget, pozicioni i Obamës dhe Bidenit do të jetë i vështirë, por duket se ata të dy nuk kanë qenë kurrë më parë kaq pranë njëri-tjetrit me ide e plane, sa në këtë moment.

Pushimet "e gjelbra" të pasanikëve

Të famshmit kanë preferuar të pushojnë në zona të pastra, larg zhurmës, makinave dhe ndotjes. Më mirë shëtitje me kuaj, biçikleta apo makina me hidrogjen, që nuk ndotin ambientin

Thonë se është merita (ose fajti) i Al Gore, njeriut të vlerësuar me çmimin "Nobel" në përpjekjet e pafundme për të mbrojtur planetin, por, thonë gjithashtu se mund të jetë thjesht ankth, sepse ndoshta ka vërtetë të drejtë James Lovelock, shkencëtari ideator i hipotezës, se toka si një organizëm i gjallë që nuk mund të durojë dot më indiferencën dhe diskriminimin që njerëzit po i bëjnë. Brenda një dhjetëvjeçari ose maksimumi dy, Toka do të jetë më e nxehtë nga sa ka qenë në 5 milionë vitet e fundit, në epokën kur në Oqeanin Atlantik notonin krokodilët. Rreth 200 milionë persona do të migrojnë në Veri, afër Polin të Veriut, për të mbijetuar sepse nuk do të kenë rrugëzgjidhje tjetër. Edhe nëse mund të marrim menjëherë masa të jashtëzakonshme për ta frenuar këtë ndryshim, botës do t'i nevojiteshin mijëra vite për ta marrë sërish veten. Rreth vitit 2025, në Polin e Veriut do të jetë aq nxehtë sa që do të mund të dalësh shëtitje me varkë; pylli i Amazonës do të jetë kthyer në shkretëtirë dhe rreth 12 mijë specie të gjalla rrezikojnë të ngordhin", thotë profesori anglez, i famshëm për zbulimin e dëmeve në shtresat e ozonit dhe për shumë e shumë teori e shpikje të tjera dhe autor i librit "The revenge of Gaia: earth climate crisis and the fate of humanity".

Ndoshta, e kanë kuptuar fare mirë këtë edhe yjet e Hollivudit dhe njerëzit e pushtetshëm, që tashmë kanë vendosur t'i kërkojnë falje. Shpesh yjet e Hollivudit shihen si njerëzit e duhur për të nisur ndonjë betejë kundër duhanit apo Sidës. Është koha për t'i thënë lamtumirë pushimeve pak inteligjente. Leo DiCaprio ka zgjedhur t'i kalojë pushimet në Islanda, Rekjavik, si bazën e tij, si bazë për ekskursionet në Oqeanin Atlantik në bordin e Elding, anijes me hidrogjen që nuk ndot ambientin. Charlize Theron ka



preferuar ecjet në "Kruger National Park" dhe shëtitjet me kanoa në lumë, nën shoqërinë e të fejuarit, Stjuart. Keira Knightley, e kalon kohën e lirë nëpër pyjet dhe liqenet e Britanisë së Madhe.

Jake Gyllenhaal dhe Reese Witherspoon kanë zgjedhur Kanadanë duke ecur me biçikletë, shëtitje me kanoa, kuaj e duke lënë pas makinat e mëdha, apo jahtet që mund të ndotin ambientin.

Orlando Bloom preferoi Antarktidën e së

bashku me kushëririn fotograf u kthye i prekur nga ajo që kishte parë. "Nuk kishte më bukuri. Ishte bërë për të ardhur keq", tha ai sapo u kthye në Amerikë. Rezultati i gjithë kësaj? "Një libër, 'Antarktida, nevojë për shpëtim', një dokumentar dhe një ekspozitë për t'i ndërgjegjësuar sado pak të gjithë ata që e duan planetin", deklaroi aktori. Në dhjetëshen e "yjeve më ambientalistë" ka hyrë edhe Madonna njolloj si Johnny Depp dhe çifti Gwyneth Paltrow-Chris Martin. Nëna

e re Halle Berry tregon me kujdes për "People" ambicet e saj, të një nënë ekologjike. "Vetëm veshje bio për vajzën, Nahla Ariela Aubry", rrëfen ajo. Gisele Bunchen, modelja braziliane më e paguar në botë, mban veshur sandale "Ipanema" me gomë të ricikluar dhe veshjet që Stella McCartney i përgatit vetëm me materiale bio. Eva Herzigova është 35 vjeçe, shumë e dhënë pas luksit, por përcaktimi i saj për këtë fjalë ka ndryshuar krejtësisht. "Gjithçka nisi vitin e kaluar, kur ajo u rendit në krah të Al Gorit për filmin që i dha atij çmimin "Oscar", "An Inconvenient Truth".

Orlando Bloom preferoi Antarktidën e së bashku me kushëririn fotograf u kthye i prekur nga ajo që kishte parë. "Nuk kishte më bukuri. Ishte bërë për të ardhur keq", tha ai sapo u kthye në Amerikë. Rezultati i gjithë kësaj? "Një libër, 'Antarktida, nevojë për shpëtim', një dokumentar dhe një ekspozitë për t'i ndërgjegjësuar sado pak të gjithë ata që e duan planetin", deklaroi aktori. Në dhjetëshen e "yjeve më ambientalistë" ka hyrë edhe Madonna njolloj si Johnny Depp dhe çifti Gwyneth Paltrow-Chris Martin. Nëna e re Halle Berry tregon me kujdes për "People" ambicet e saj, të një nënë ekologjike. "Vetëm veshje bio për vajzën, Nahla Ariela Aubry", rrëfen ajo. Gisele Bunchen, modelja braziliane më e paguar në botë, mban veshur sandale "Ipanema" me gomë të ricikluar dhe veshjet që Stella McCartney i përgatit vetëm me materiale bio. Eva Herzigova është 35 vjeçe, shumë e dhënë pas luksit, por përcaktimi i saj për këtë fjalë ka ndryshuar krejtësisht. "Gjithçka nisi vitin e kaluar, kur ajo u rendit në krah të Al Gorit për filmin që i dha atij çmimin "Oscar", "An Inconvenient Truth".

kaluar, kur ajo u rendit në krah të Al Gorit për filmin që i dha atij çmimin "Oscar". "An Inconvenient Truth". E kishte parë filmin e shtrirë në krevat, në kohën kur ishte në muajt e fundit të shtatzënisë, ndërsa priste fëmijën e parë George Clooney, tani nuk e ka më furistradën e tij që harxhonte shumë dhe sigurisht ndoste shumë. Aktori më i preferuar i femrave shëtit në makinën e tij me bateri elektrike, pavarësisht se ka kushtuar plot 99 mijë

euro. Gjeniu i madh Philippe Starck ka vendosur t'i japë një tjetër formë pasurisë së tij. Nuk dëshiron të merret më me paratë por me ekologjinë si vlerë demokratike. Për këtë arsye vendosi të dizajnonte një mulli me erë personal që mund të blihet në supermarket dhe montohet mbi çati për të siguruar dritë dhe ujë të ngrohtë. Mendon se do të shesë me miliona të tillë. Në fakt, snobizmi i pak vetave po tenton të kthehet në një detyrim social, një fiksim i përbashkët: të ecësh në këmbë, të harxhosh më pak ujë, t'i përdorësh natën elektroshtëpiakët dhe të konsumosh ushqime biq, që shumë restorante në botë i kanë vendosur në menynë që e kanë pagëzuar me emrin "dieta e Kyotos". Gjithçka duhet të jetë organike, si xhinset e markës "H&M", bluzat prej sole, algash, ose më mirë akoma me bluza qumështi (T-shirt Milkywear), bio-shifon që mbanjnë emrin e Stella McCartney-t, termose për të mos hedhur në ambient shishe plastike, dhe çanta prej letre nëpër supermarket. Për më tepër tani është në modë edhe martesat bio, e parashikuar për të reduktuar CO2 që mund të prodhohet gjatë ceremonisë apo funeralit bio me arkivolet prej amidoni dhe kartoni dhe varrosjen në një park të egër si "Ramsey Creek", nël në Karolinën e Veriut. Lindsay Lohan apo Misha Barton kujdesen gjithmonë që të mos hedhin në plehra asgjë. Zinxhiri anglez i dyqaneve, i bërë i famshëm nga Kate Moss, ka prezantuar ekofushatën dhe premtos se do t'i dhurojë gjithë veshjet për bamirësi. Gjithçka po tentohet të bëhet bio, për arsyen e thjeshtë sepse kushtojnë më pak dhe janë shumë më të shëndetshme. Për këtë arsye, yjet e Hollivudit dhe pasanikët prezantojnë çdo ditë fushata dhe reklama që të gjithë të ndihmojnë në shpëtimin e planetit. Sepse nuk ka më kohë. Situata është sa urgjente aq edhe e frikshme. Nëse do të vazhdojmë të ecim me këto ritme, atëherë shpëtimi i vetëm i tokës do të ishte pa njerëzim. Kontrollonjme 40% të asaj që natyra prodhon dhe kemi ndër të demë kudo: kemi ndotur ajrin dhe oqeanet, duke shkatërruar pyje dhe specie të ndryshme kafshësh. Nuk mjafton vetëm të kërkojmë falje, duhet patjetër të bëjmë diçka.

Kadare një rrëfim për dashurinë dhe vdekjen

Unë kam kryer gjënë themelore në jetën time. Kam mbetur shkrimtar, kur atëherë ishte shumë vështirë të ishte shkrimtar, në periudhën më të zeze për letërsinë dhe kështu që te mua s'ka vend fjala pendim për asgjë. Unë kam kryer gjënë themelore që kam dashur në jetën time, e kam realizuar atë. Shprehet shkrimtari Ismail Kadare. Më poshtë, shkrimtari u përgjigjet pyetjeve se ç'është letërsia, a është shkrimtari tiran për familjen e tij, çfarë roli duhet të ketë populli dhe lexuesi në krijimtari, cila është lidhja mes dashurisë dhe letërsisë, a e ka neglizhuar Kadareja në romanet e tij femër, a ka frikë dhe çfarë kuptimi ka për Kadarenë vdekja.

Zoti Kadare, më ka bërë përshtypje krahasimi i bashkëshortes suaj, zonjës Elena, në një media shqiptare, se ju dukeshit shpesh nga puna që bëni, si tiranik. Pra, sipas saj, të jesh bashkëshorte e një shkrimtari nuk është e lehtë. Jeni vërtet i tillë, pra i vështirë si tip, si natyrë dhe nëse po, pse?

Nuk e di, nëse gruaja ime thotë ashtu, atëherë ashtu jam. Për shkrimtarët, për artistët, për shkençtarët, thuhet zakonisht ashtu sikurse thotë ime shoqe. Puna e vetmuar të jep përshtypjen, ndjesinë që i jep një kolorit të tillë jetës së shkrimtarit: Një njeri që nuk ka nevojë të konsultohet, të marrë këshilla. Krijimtaria është puna më e vetmuar në botë, krijimtaria letrare është e tillë. Shkrimtari nuk këshillohet me askënd dhe nuk ka nevojë. Më parë ishte të mësojmë nga populli. Të shkojë shkrimtari të pyesë në popull, të mbledhë ca punëtorë dhe të flasë me ata që të bënte subjektin e një romani. Kështu ka qenë dikur. Të marrë disa mendime nga punëtorët. Dhe unë e kam thënë edhe më parë, pika shkrimtarit që katandiset të mësojë nga populli. Te ne ka po ashtu edhe një abuzim me fjalën popull. Populli është ai që është, e dimë dhe e nderojmë të gjithë. Por harrojmë që nga populli dalin gjithë të mirat dhe nga populli dalin edhe të këqijat. Dhe ne kujtojmë se populli pëll vetëm të mirat, por të këqijat janë pjesë e tij po ashtu, nga dalin ato, nga qielli. Populli ka jetën e vet që lidhet me jetën tonë. Populli nuk ka punë me



letërsinë, të japë ndihma një tiran. Në fakt, tirani mund të japë mendime në se i pëlqen ose jo. Është lexues, nuk ka të drejtë të ndërhyjë në punët profesionale të shkrimtarit, të muzikantit, piktorit. Nuk ka të drejtë askush. Unë jam shkrimtar dhe nuk mund të ndërhyjë të muzikanti, sepse ai është sferë tjetër. Po ashtu, muzikanti nuk ka të drejtë të ndërhyjë të shkrimtari, apo ky i fundit të piktorit.

Por sa egoist është shkrimtari që, për hir të krijimtarisë, mbetet shumë larg familjes? Dhe harruar të na sqaroni nëse jeni tiranik apo jo?

Shkrimtari shpesh mund t'i tregojë bashkëshortes, ose të konsultohet për veprën e vet për kënaqësinë e tij, sikurse çdo njeri ka nevojë t'i tregojë për krijimtarinë e vet. Dhe ajo ka fatin ndonjëherë të dëgjojë e para çfarë thuhet në veprën. Por po ashtu, asaj dhe shumë të tjerëve, mund t'i krijojë ideja që vet vetmia e punës krijon idenë e tiranisë. Por çfarë janë tiranët? Tiranët janë karikaturë e një krijuesi artistik si të thuash, qoftë në muzikë, qoftë në letërsi apo në filozofi. Ai quhet tiran, ngjan me këta, por është karikaturë e tyre, në vetminë e tij që ai sundon si tiran, sundon i vetmuar. Ndërsa shkrimtari e ka të natyrshme të punojë i vetmuar. Kështu e do profesioni i tij. Puna letrare është krijuese dhe çdo krijimtari letrare është e vetmuar, është tërësisht individuale. Puna e një drejtuesi shteti është e kundërta. Është institucionale, nuk ka asnjë të drejtë, është e zgjedhur me votë. Prandaj ai kur fillon e shkel, do të bëjë si shkrimtari,

si muzikanti dhe ai bëhet një tiran. Në fakt, tirani i vërtetë është ky, krijuesi, pra një tiran si të thuash pozitiv. Kurse ai tjetri imiton, bëhet një karikaturë, shkel ligjet gjersa përfundon që t'ia zvarrisin statujën në rrugë. Dhe e kam thënë edhe diku që t'i zvarritat statuja ndonjë shkrimtari nuk është dëgjuar kurrë apo t'i përmbysat statuja një shkrimtari në botë? Unë s'kam dëgjuar kurrë. Kurse tiranët i heqin zvarrë sot.

Në librin dialog me ALEN BOSKEN, ju e quani dashurinë një shemër të rrezikshme të krijimit. Sigurisht, ju flisni në raportin mes krijimtarisë dhe dashurisë. Shpeshherë, shkrimtarit i duhet të prishtë shumë gjëra të shtrenjta për hir të artit, sipas jush. Pra të shkatërrojë edhe një histori dashurie. Ka ndodhur vërtet kjo zoti Kadare?

Kjo është keqkuptuar, mendoj unë. Unë kam thënë një gjë: Në mënyrë intime jam pyetur se cilat janë fazat që shkrimtari është më i suksesshëm në të shkruar dhe fazat kur ai është më i papërshtatshëm. Dhe kam thënë një gjë që mund të jetë personale. Shkrimtari nuk duhet të shkruajë, qoftë kur është fatqë, qoftë kur është tepër i lumtur. Pse të dyja të bëjnë mendjelehtë. Duhet të kalojë ajo fazë. Kam bërë humor dhe kam thënë që kur bie në dashuri, ti mund të shkruash dhe të kujtosh se po bën gjëra të thella, por ti bën gjëra mendjelehta. Shkrimtari duhet të ketë një klimë, ku pasioni të ketë kaluar, ta kujtojë atë dhe kjo është shumë e dobishme, por asesi kur është në atë fazë kur flasim për dashurinë, për vrullin e parë. Si të

thuash, njeriu bëhet mendjelehtë, ndoshta disave iu duket sikur bëhen shumë të mençur. Unë vetë kam bërë njëherë, një rrëfim tepër intim për këtë gjë dhe jam i bindur se kështu është. Por nuk jam për atë që të shkatërroj një dashuri, kurrsesi. Letërsia do të kishte lindur e gjitha mbi krimin. Nuk është e vërtetë fare, fare.

Megjithatë, në veprat tuaja sikur mungon dashuria e zjarrtë, ajo erotike. Pra, ka më pak intimitet, ka më pak ndjenjë dhe më tepër brishtësi: Thjesht mungojnë femrat. Ka të bëjë kjo me temat që zgjidhni, apo me tipin tuaj, pra i keni ndjenjat më të kursyera?

Jo, kjo s'ka lidhje fare me natyrën time, apo me tipin dhe ndjenjat e mia. Letërsia prandaj është paradoksale. Njerëz që kanë pasur arsye të trishtueshme, sepse iu ka munguar dashuria, shkruajnë shumë për dashurinë. Por qëllon edhe e kundërta. Nuk ka ligje për këtë gjë. Zakonisht kjo s'tregon asgjë. Që nuk e përmend shpesh dashurinë, kjo nuk do të thotë gjë. Përkundrazi, që mund ta përmendesh vetëm atë, kjo do të thotë se ka munguar. Edhe kjo s'mund të jetë qind për qind e vërtetë. Por qëllon që është kështu. Prandaj nuk matet kurrë. Diçka që mungon ose që është e tepër në veprë, nga ajo çka është në të vërtetë në jetë. Më kritikoni se mungon elementi femër në veprat e mia. Kjo nuk është e vërtetë. Kam personazhe femra shumë. Kam rreth 150 në letërsi. Kam shumë më duket. Mënyra e të shkruarit tim është e tillë, që unë jam i prirur nga tablo shpesh të ashpër, epike që vetvetiu gratë janë më të pakta. Unë nuk kam pa-

sur një mizogjeni, që të kem bezdi ndaj grave, kjo s'është e vërtetë.

Meqë jemi të femrat, zoti Kadare, a besoni ju në dashurinë e madhe, apo në një dashuri të përshme?

Unë mendoj që po. Gjithmonë ekziston, pavarësisht se njerëzit për t'u hequr modernë thonë që ne tani dashurojmë ndryshe. Ato janë për mua vetëm poza që marrin njerëzit. Të vuash nga dashuria, ta përjetosh në mënyrë dramatike tregon që je njëri superior. Por për fat të keq, sot, gjoja "njerëzit e fortë" janë ata që s'preken nga dashuria. Të mburresh që nuk më prek dashuria, do të thotë të mburresh që je njeri i varfër. Do të thotë që s'ke njohur njeri të përshtatshëm, ke njohur njerëz kot, ke njohur gra kot. Që të dyja palët janë të paafta që të provojnë këtë ndjenjë. Dashuria është e nevojshme, absolutisht në çdo kohë dhe është e pranishme në çdo kohë. Dashuria është kudo, nuk zhduket nga jeta njerëzore, pavarësisht nga modifikimet që mund të duket sikur ajo ka pësuar. Dashuria në fakt mbetet ashtu siç ka qenë.

Ju çfarë vlerësoni te një femër dhe çfarë ju duket interesante tek ajo, zoti Kadare?

Mua më pëlqen feminiteti, atë e vlerësoj shumë. Tani është ngatërruar shumë shija për femrën. Disa i duan femrat me personalitet të fortë ose femra aktiviste. Femra mund t'i ketë të gjitha këto, sikurse edhe burri, e zonja, e talentuar, aktiviste, etj., por në radhë të parë, natyra e ka bërë që femra të mbetet femër në të gjitha kushtet e tjera. Ajo mund të jetë femër, mund të drejtojë një shtet dhe të jetë përsëri femër, thjesht të jetë e dashuruar dhe përsëri të mbetet po femër. Nuk është ndonjë kusht meqë ajo loz një rol në jetë ose meqë ne e çmojmë shumë më tepër, prandaj duhet të fillojë të ndryshojë natyrën e saj dhe të bëhet pakëz mashkull. Ky është një budallallëk. Ajo mund të jetë pranë të gjitha niveleve të jetës në të gjitha vlerësimet e jetës, por ajo duhet të mbetet femër përsëri. Dhe po duket feminitetin, më shumë se nuk i vlejën shumë ato tjerat që ka fituar. Është mëkat i madh, që ajo ta këmbëjë atë me diçka tjetër.

Është gjynah, siç thotë populli.

A urreni zoti Kadare?

Nuk e di. Çfarë quhet urrejtje në këtë rast? Si çdo njeri, unë mund të zemërohem, mund të kem gjëra që nuk i fal. Ka gjëra që i fal, por ka disa gjëra që nuk falen në jetë. Kjo nuk është urrejtje. Kjo është tjetër gjë. Kur kapërcehen disa limite në jetën njerëzore, pra kur kapërcehen disa kufij, nuk jam një i krishterë i mirë.

Ju jeni penduar për diçka në jetë?

Jeta ka plot raste pendimi. Pra një gjë e tillë është e pranishme në jetën njerëzore, është normale. Nuk ka njeri në botë që nuk është penduar, që t'i rikthehet një gjëje që dikur s'e ka bërë mirë. Por unë mendoj se nuk ia vlen të merresh me një gjë të tillë. Kështu është jeta njerëzore. Të thuash që s'jam penduar për asgjë, do të thotë që ti s'ke jetuar. Të thuash që je penduar duhet vërtet të thuash që je penduar vërtet për diçka. Unë kam kryer gjënë themelore në jetën time. Kam mbetur shkrimtar, kur atëherë ishte shumë vështirë të ishte shkrimtar, në periudhën më të zeze për letërsinë dhe kështu që te mua s'ka vend fjala pendim për asgjë. Unë kam kryer gjënë themelore që kam dashur në jetën time, e kam realizuar atë.

Zoti Kadare, a keni menduar ndonjëherë për vdekjen, ai i trembeni asaj?

Jo dhe aq..., jo. Një krijues, zakonisht normal, është të mos i trembet vdekjes, sepse vepra e mëson të mësohet me vdekjen. Vetë krijimi e mëson që të mësohet me atë. Ai shkruan për kohën që është gjallë do ose s'do. Ai shkruan edhe për kohën që nuk do të jetë. Do ose s'do. Vetë mjeshtëria e letërsisë është e tillë. Letërsia e mirë jeton, jeton gjatë. Po të jetë shkrimtari i mirë, do të vazhdojë disa dhjetëra vjet më vonë. Po të jetë shkrimtar shumë i mirë, do të vazhdojë akoma më tepër. Dhe po të jetë i jashtëzakonshëm mund të vazhdojë edhe me shekuj. Në ndërgjegjen e çdo shkrimtari, kjo është e depozituar. Ekziston në mënyrë instiktive, siç janë të gjitha ndjesitë e tjera, prandaj ai mësohet me këtë gjë që ai do të jetë i pranishëm në disa kohë. Pra ç'janë këto kohë? Është vdekja. (Shqip)

Mbyllet kolonia artistike "Shkupi 2008" Panorama idilike e Çarshisë në telajon e Spahiut

Xhamitë, hamami, sekuenca nga Çarshia e Vjetër krahas peizazheve të ndryshme të fokusuara nga terraca e hotelit "Arka", për Spahiun kanë qenë më shumë se një panoramë idilike e Çarshisë

Shkup, 28 gusht - Dekani i Artit Figurativ në USHT, Safet Spahiut, është një prej artistëve të vetëm shqiptarë që mori pjesë në Koloninë Ndërkombëtare artistike "Shkupi 2008", që u mbyll të mërkurën në hotel "Arka". Një eksperiencë e veçantë, motive specifike dhe frymëzim nga ambientet e Çarshisë së Vjetër në Shkup, apo edhe shkëmbim i përvojave teknikave artistike mes artistëve që vinin nga shkolla të ndryshme të artit, i cilësor dhjetë ditët e kolonisë. Xhamitë, hamami, sekuenca nga Çarshia e



Vjetër krahas peizazheve të ndryshme të fokusuara nga terraca e hotelit "Arka", për Spahiun kanë qenë më shumë se një panoramë idilike e Çarshisë.

Dy punimet e tij, të ek-

spozuar edhe në natën finale janë një kompozim dhe "Dueti". Të punuara në tone të forta portokalli, tabloja të krijon imazhin e një këndimi në duet, apo edhe të një vaji. Edicioni i tretë i

Kolonisë Ndërkombëtare artistike "Shkupi 2008", ka startuar më 16 gusht. Artistët i kanë realizuar krijimet e tyre në hotelin "Arka", në hapësira të adoptuara apostafat për ta. Mes tyre numërohen Taki Pavallovski, Marieta Sidovskij, Nikolla Ivanov-Balton, Pavle Kuzmanovski, si edhe artistët nga bota Zhan Jirsten, Barbara Lidfords, Rumen Laptev, Lucia Stramec dhe Miroslav Jovanoviq.

Gjatë kolonisë artistike u organizua edhe një ekskursion njëditor nëpër Shkup dhe periferi me qëllim të njohjes artistëve me pasuritë kulturore-historike. Evenimenti që organizohet tradicionalisht në çdo dy vjet, mbahet nën mbështetjen e Qytetit të Shkupit, Muzeu i Qytetit si organizator teknik të Shkupit, ndërsa hotel "Arka", është sponsor gjeneral.

Koncert binjakëzimi i ansambleve të Dibrës dhe Mitrovicës



Haki Stërmilli dhe Rexhep Mitrovica unifikohen

Dibër, 28 gusht - Në sallën e madhe për koncerte pranë qendrës për Kulturë në Dibër është mbajtur të mërkurën në mbremje koncerti i binjakëzimit të shoqërive kulturo-artistike "Haki Stërmilli" nga Dibra dhe "Rexhep Mitrovica" nga Mitrovica. Dy shoqëritë prezantuan këngë dhe valle nga trojet shqiptare, si vallet e Rugovës e Shotës të interpretuara nga "Rexhep Mitrovica".

Në hapjen e koncertit kryetarët e dy komunave reciproke theksuan se binjakëzimi i dy

shoqërive artistike lindi gjatë pjesëmarrjes të dy shoqërive në Festivalin Ndërkombëtar në Imegyl në Turqi në fillim të këtij muaji, pa harruar të sjellin në vëmendje edhe kontributin dibran për strehimin e kosovarëve gjatë luftës në Kosovë. Binjakëzimi sipas tyre do të ndikojë edhe në thellimin e miqësinë dhe bashkëpunimit mes dy qyteteve. Në koncert merin pjesë krahas kreut të BDI-së Ali Ahmeti, edhe ministra dhe deputetë të tjerë të partisë. (V.S.)

"Shpresa" e Veleshtës në mbyllje të sezonit

Turet artistike vijnë në Prishtinë e Durrës

Strugë, 28 gusht - Shoqëria kulturo artistike "Shpresa" e Veleshtës këto ditë është kthyer nga Rumania ku ka marrë pjesë në Festivalin e Folkut të mbajtur në Turgu Jiu nga 17 deri më 22 gusht. Në këtë festival morën pjesë 20 anëtarë ku për çdo ditë ekzekutonin këngë dhe valle në ambiente të ndryshme, së bashku me ansamble nga vende si Hungaria, Bullgaria, Polonia dhe Serbia. Sezoni veror

cilësohet i suksesshëm për grupin, edhe pas pjesëmarrjes në Festivalin "Këngë Jeho", në sfilatën e veshjeve karakteristike popullore, ku "Shpresa" është ndëruar me çmimin e parë për veshje më të mirë, si edhe në Takimet e Pohumit. Ndërkohë që përgatitet të marrë pjesë në Festivalin e fëmijëve "Ylberi i Prishtinës" dhe në Festivalin e Durrësit, "Fest Loja". (Sh.V.)

"Good morning Balkan" nga Austria

Shkup, 28 gusht - "Të zgjon kujtimet dhe të bën të mendosh se pas errësirës të cilën lëmë pas në mëngjes lind shpresa për një fillim të mbarë." "Good morning, Balkan" në të njëjtën kohë mund të interpretohet si një urim miqësor edhe si një thirrje për t'u zgjuar".

Me këto fjalë presidenti i "European Forum Alpbach" Erhard Busek, ka mirëpritur ekspozitën shëtitëse "Good morning, Balkan", edicioni i shtatë i së cilës është prezantuar në Austri me ftesën e tij.

Claudia Schmidt, ministrja e Kulturës së Austrisë, ka çelur ekspozitën, në të cilën marrin pjesë artistë nga vendet e rajonit të Ballkanit, si dhe nga ato të Bashkimit Evropian.

"Good morning, Balkan" është një titull mjaft joshës, ka konstatuar Busek, për të cilin kjo ekspozitë e organizuar nga Fatmir Velaj është me vlerë në paraqitjen e artit të Evropës Juglindore.

Fate Velaj, kryetar i forumit Weltoffen International, në një retrospektivë të itinerarit dhe stacioneve të kësaj ekspozite e cila filloi më 2003 nga Athina, më 2004 në Bukuresht, 2005 në Tiranë, 2006 në Prishtinë e Trieste, dhe më 2007 në Ohër të Maqedonisë, këtë vit në European Forum Alpbach si dhe më 27 nëntor me ftesë të presidentit të Austrisë Heinz Fischer, do të paraqitet në Palatinin Presidencial Hofburg në Vjenë.

Një rrëfim për Kubrick



lan Harlan

Marrëdhënia e tij me kinemanë lindi në vitin 1941, kur në moshën 13-vjeçare, i ati i dhuron një aparat fotografik. Stanley, i stimuluar nga ajo dhuratë, nis të shkrepi pafundësisht foto, derisa pak nga pak lind edhe dëshira për t'u bërë kineast. Filmat e Kubrick kthehen në shprehje të mendimeve të tij. Lind në këtë mënyrë edhe një legjendë e vërtetë mbi manitë e tij. Kronikat flasin për një njeri maniak, të vetëpërgjatur nga shoqëria, i mbyllur në vilën fortesë me bashkëshorten, fëmijët dhe kafshët e tij. E vetmja lidhje me botën e jashtme, një kompjuter. Vit pas viti, edhe filmat e tij dalin rrallë e më rrallë. Kështu ka ndodhur edhe me "Eyes wide shut", film për të cilin regjisori Stanley Kubrick ka punuar për gati 30 vjet. Për të, ky film ishte më i rëndësishmi i karrierës së tij. Ian Harlan miku, kunati i tij, por dhe producenti i filmave të legjendës së kinematografisë, e kujton pikërisht në këtë mënyrë Kubrick. Harlan, i ftuar nderi në festivalin ndërkombëtar veror të filmit që po mbahet në Durrës, ka zbuluar sekretet e marrëdhënies së tij miqësore dhe profesionale me regjisorin Kubrick, për të cilin Harlan ka realizuar edhe dokumentarin "Life in picture". Harlan komentoi edhe "Eyes wide shut", filmin e fundit të Kubrick, si më të rëndësishmin e jetës së tij. "Eyes wide shut" është ferri modern. Ne sot shohim se si pornografia ka shpërthyer gjithandë. Ky është një film që në thelb ka shoqërinë, seksualitetin, fantazinë dhe xhelozinë. Megjithatë është bazuar në romanin "Traumnovelle" e Arthur Schnitzlerit, që ishte një alter ego e Sigmund Freudit, ajo që ndodh në film nuk ka të bëjë as me vitin 1928 as me Vjenën, por me atë që është e rëndësishme sot dhe në të ardhmen. Ai donte të bënte një film për Nju Jorkun e sotëm", ka thënë Ian Harlan, producenti i filmave të Kubrick. Harlan në bisedën me adhuruesit e kinemasë kubrickiane e ndali vështrimin edhe të mënyra si punonte mjeshtri, si ai përzgjodte muzikën para se të filloonte realizimin e filmit, duke e bërë këtë të fundit një personazh. Harlan, i cili ka dëgjuar për Shqipërinë nga Radio Tirana gjatë viteve të komunizmit, thekson se, nëse mjeshtri do të ishte gjallë, do të kishte bërë një film për Napoleonin dhe Vaterlonen. Ky gjeni i jashtëzakonshëm dhe i papërsëritshëm i kinemasë ndërroi jetë më 7 mars të 1999-ës, pas fundit të filmit "Eyes wide shut".

Pas pushimit të gjatë strugani kthehet në ring

Limani kundër grekut Zambiti

Mirdi Limani ka pohuar se për këtë duel tani më ka filluar të ushtrojë, mirëpo vetëm në aspektin fizik, pasi që për ushtrime më intensive pret lejen nga mjeku i tij personal

Koha Avdyli SALIHU

Shkup, 28 gusht - Kikbok- sieri nga Struga, Mirdi Limani pas lëndimit që pati në këmbë, tani më ka filluar të përgatitet për duelin e ardhshëm që do të zhvillohet më 29 nëntor në Nju Jork të Amerikës. Limani ka pohuar se për këtë duel tani më ka filluar të ushtrojë, mirëpo vetëm në aspektin fizik, pasi që për ushtrime më intensive pret lejen nga mjeku i tij personal. "Një kohë kam qenë jashtë aktiviteteve sportive, pasi kam qenë i dëmtuar në këmbë dhe më është dashur të pushoj. Më 29 nëntor të këtij viti është rezervuar ndeshja me grekun Majk Zambiti, por paraqitja ime në këtë dy- luftim do të varet nga mjeku im personal", po- hoi Limani për gazetën

Rezultatet:
1997 - WKA Kampion Gjermanie
1998 - WKA Kampion Evropian
2000 - WKA Kampion Evropian për herë të dytë
2001 - WKA Kampion Bote
2001 - WKA Kampion Bote
2002 - WKA Kampion Bote
2003 - WKA dhe WTKL Kampion Botëror në dy versionet
2006 - ISKA Kampion Botëror

Rekordit Profesional:
61 Luftëra
60 Fitore
1 Humbje
0 Barazime
33 KO

"Koha". Ai shton se përkundër lejes, ai ka filluar të ushtrojë. "Unë për çdo rast kam filluar të ushtroj me trajnerin tim në Frankfurt Valte Shtener, por ndërko- hë kam stërvitur edhe në Shkup me Mentaz Alajbegun. Besoj se së shpejti do të marr lejen e mjekut dhe do të filloj intensivisht të përgatitem edhe në aspektin teknik me sparingët e mi nga Gjermania dhe Holanda", thotë Limani. Ndryshe, Mirdi Limani nuk është paraqitur në ring që nga viti 2006, pasi që njëherësh kishte disa probleme me menaxherët për të drejtat personale dhe televizive, ndërkohë më vonë u lëndua.



Strugani me lëndim të lehtë



Pollozhani në pikëpyetje ndaj Renovës

Shkup, 28 gusht - Xhiro- ja e katërt e Kampionatit të Maqedonisë në futboll, padyshim se pritet të jetë mjaft interesante, pasi që në stadiumin e qytetit në Shkup do të takohen ekipi i Vardarit dhe Renovës. Për këtë ndeshje të skuadra e Vardarit në dyshim do jetë mes- fushori Artim Pollozhani, i cili ka një dëmtim të lehtë. "Për momentin kam një dëmtim të lehtë dhe jam në pikëpyetje për

këtë takim. Mirëpo nëse vendos trajneri që unë të jem në fushë, atëherë do të jap maksimumin", po- hoi Pollozhani. Ndryshe, mesfushori nga Struga, thotë se ballafaqimi me Renovën do të jetë një takim i rëndë. "Padyshim se do jetë një ndeshje mjaft interesante, por edhe e rëndë. Ne kemi synim fitoren dhe do japim maksimumin që të arrijmë deri te tri pikët", deklaroi Pollozhani. (A.S.)

Turneu ndërkombëtar në Çaçak të Serbisë

Deari plasohet në çerekfinale



Shkup, 28 gusht - Talenti shqiptar, Shendrit Deari në turnirin që po mbahet në Çaçak të Serbisë, ka arritur edhe fitoren e tretë. Kësaj radhe Diti ka mposhtur bindshëm italianin Daniello di Eno me rezultat 6:3 dhe 6:1. Me këtë triumf, tenisti shqiptar është plasuar në ¼ e finales. "Ishte një ndeshje e mirë ku falë formës sime pozitive, arrita edhe të fitoj. Tani do të ri i qetë dhe do të pres kundër- shtarin e radhës në ¼ e finales. Besoj se edhe këtë pengesë do ta kaloj", pohoi Shen- drit Deari për gazetën "Koha". Ndryshe tenisti nga Gostivari, në xhiron e parë mposhti reprezentuesin nga Franca, Robert Kuentin, kurse në xhiron e dytë ishte më i mirë se suedezi Sekulijq Milosh. (A.S.)

Publicitet

MOLIKA

Adresa : V.S.Bato p.ri
TETOVË - MAqedoni
Tel : +389 / 0 / 44 / 334 - 481 ; 330 807 ; 330 815
Fax : +389 / 0 / 44 / 334 482
www.molika-ke.com.mk
E-mail : molika_ke@yahoo.com

Prodhon mobilje me cilësi të lartë, sipas certifikatës për cilësi dhe dizenj ISO 9001 2000. Shitja bëhet edhe më këste për 48 muaj përmes bankave. Lindhvaroni në Tetovë rrugës industriale.

Karateistët e Kosovës në Strugë

"Në Strugë jemi mirëpritur, kemi kushte të mira dhe shpresojmë se pas këtyre përgatitjeve do të na prijë e mbara dhe do të arrijmë suksese në skenën ndërkombëtare", thotë Nezir Rama



Përgatitje për garat ndërkombëtare

Koha Shpend VINCA

Strugë, 28 gusht - Në Strugë këto ditë përgatitjet bazike është duke i zhvilluar përfaqë- suesja e Kosovës në Karate. Kryetari i Federatës së karatesë së Kosovës, Nezir Rama tregon se aktivitetet e pavarura ky asociacion i ka filluar në vitin 1991, ndërsa si Federatë funk- sionojnë nga viti 1992 dhe janë vazhdimësi e Lidhjes së karatesë të Kosovës. "Në mars të vi- tit 1991 i kemi filluar garat e pavarura në Kosovë. Ndërkohë nga ky vit mbahet në gjitha kampionatet shtetërore, me të gjitha grup- moshat, nga pionieret e deri tek seniorët. Repre- zentacioni ynë ka marrë pjesë nëpër turne të ndryshme ndërkombë-

tare, mirëpo nuk kemi marrë pjesë në kampio- nate evropiane dhe botërore sepse Federata e Kosovës akoma nuk është anëtarësuar ndër- kombëtarisht. Më 29 prill 2008 kemi aplikuar për anëtarësimin në Federatën Evropiane dhe në Kongresin që do të mbahet në nëntor në Tokio të Japonisë pres- im të anëtarësohemi", thotë Rama. Ndryshe, 26 seniorët e përfaqësueses së karatesë ushtrojnë në Strugë dy herë në ditë, ndërkohë atyre iu janë bashkangjitur edhe shumë klube nga Struga e rrethina. Pos trajn- erëve nga Kosova, Ismail Fazliu dhe Safet Rama- dani, karateistët ndihmohen edhe nga in- struktori i karatesë, Shefi Reçi. Rama tregon se në Strugë janë për-

faqësuesit e femrave dhe meshkujve dhe në mesin e tyre janë edhe kara- teistët Kaltrina Krasniqi, Luljeta Shala dhe Fiona Beqiri, ndërkaq nga meshkujt në Strugë ushtrojnë Agon Agani, Ylli Gashi, Jetmir Rex- hepi, Lindtrim Gashi dhe në Shkëlzen Shala. "Kushtet për stërvitje i kemi të mira, por edhe klima është e përshtat- shme. Ushtrimet tekni- ko-taktike do t'i vijnë më në Kosovë dhe do të përgatitemi për të marrë pjesë në Turneu ndërkombëtar 'Stamboll Open 2008'. Në Strugë jemi mirëpritur, kemi kushte të mira dhe shpresojmë se pas këtyre përgatitjeve do të na prijë e mbara dhe do të arrijmë suksese në skenën ndërkombëtare", thotë Rama.

Shpallet lista anti Suedi dhe Maltë

Bogdani, Berisha dhe Lika kthehen në kombëtare

Erjon Bogdani, Besart Berisha dhe Iljon Lika janë tre emrat e rinj të thirrur nga trajneri Arie Haan për ndeshjet e radhës të kombëtares shqiptare, kundër Suedisë dhe Maltës

Trajneri i kombëtares shqiptare Arie Haan, ka zbuluar listën e 21 futbollistëve që do të ketë shansin të luajnë kundër Suedisë dhe Maltës në datat 6 dhe 10 shtator. Pas paraqitjes jo shumë të mirë me Lihtenshtajnin, teknikun kuqezi ka thirrur sërish në kombëtare sulmuesit Erjon Bogdani dhe Besart Berisha, të dy të lënë jashtë për miqësoren e 20 gushtit.

Po ashtu, është thirrur edhe portieri Iljon Lika, duke plotësuar numrin 3 të lojtarëve për kuadratin. Sa u përket emrave të tjerë, ata janë të njëjtë që luajtën ndaj Litenshtejnit. Në krahun tjetër, edhe Suedia ka publikuar listën me futbollistë që do të ndeshen me

Nordikët, 20 vjet pa fituar në Tiranë

Suedia është padyshim një nga ekipet më të forta të planetit, megjithatë ka 20 vjet pa fituar në Tiranë. Ndeshja e fundit mes dy përfaqësuesve, ajo e luajtur më 18 shkurt 2004 në "Qemal Stafa", përfundoi me fitoren 2-1 të kuqezinjve që atëherë drejtoheshin nga gjermani Hans Peter Brigel. Më 5 nëntor 1988, suedezët patën fituar 2-1 në Shqipëri, ndërsa në takimin e kthimit më 8 tetor, 3-1. Në fakt, dy skuadrat nuk janë ndeshur më në ndeshje zyrtare që atëherë. Skandinavët megjithatë janë një ekip që gjithnjë bëjnë ligjin në grupet e tyre eliminatore, duke u kualifikuar gjithnjë në turnetë e mëdha.

Shqipërinë, ku bie në sy thirrja e sulmuesit të Interit, Zlatan Ibrahimović. Ky i fundit pritet të jetë edhe kapiteni i ri i ekipit, pas largimit të Freddie Ljungberg. Nuk mungon në këtë listë as sulmuesi i njohur Henrik Larsson apo mbrojtësi i Juventusit, Olof Mellberg. Takimi mes Shqipërisë dhe Suedisë

do të jetë i pari për përfaqësuesen kuqezi, i vlefshëm për kualifikimet për Kampionatin Botëror 2010. Ndeshja do të zhvillohet më 6 shtator, në orën 18.45 në stadiumin kombëtar "Qemal Stafa".

Më 10 shtator, Shqipëria sërish do të jetë nikoqire, kësaj here e Maltës.



Portierë:
Arjan Beqaj
Islid Hidi
Iljon Lika

Mbrojtës:
Armend Dallku
Kristi Vangjeli
Debatik Curri
Endri Vrapit
Andi Lila

Mesfushorë:
Lorik Cana
Altin Lala
Klodian Duro
Ervin Skela
Admir Teli
Ansi Agolli
Elis Bakaj
Jahmir Hyka
Ervin Bulku

Sulmues:
Edmond Kapllani
Hamdi Salih
Besart Berisha
Erjon Bogdani

Superkupa e Kosovës

Prishtina fiton trofeun e parë



Skuadra kampione në fuqi e Kosovës, Prishtina ka arritur ta fitojë edhe Superkupën, pasi ka mposhtur Vëllaznimin me rezultat minimal 1:0. Pjesa e parë ka kaluar në mbizotërim të Prishtinës, të cilët

krahas disa rasteve kanë arritur të gjejnë edhe golin, i cili doli të ishte vendimtar për këtë ndeshje. Ishte minuta e 26-të kur Enis Fetahu harkoi në thellësi të zonës, ku Berat Hyseni shfrytëzoi hutinë e mbrojtjes

gjakovare dhe me gjuajtje me kokë e mposhti portierin e deridjeshëm të Prishtinës, Kushtrim Mushica. Një minutë më herët prishtinasit goditën tërthorësen e portës gjakovare, pasi gjuajtja e Fetahut ishte devijuar nga mbrojtësit e Vëllaznimit. Në minutën e 37-të prishtinasit kërcënuan seriozisht portën e Vëllaznimit, por sërish tërthorësja shpëtoi Mushicën pas gjuajtjes nga distanca të Yli Hoxhës. Në fund të 45 minutave të parë gjakovarët ishin shumë afër golit, por Luigj Buqaj edhe pse dëpërtoi mirë në zonë, në fund gjuajtja e tij qëlloi shtyllën pingule. Në pjesën e dytë ishte Vëllaznimi që mbizotëroi plotësisht, por pa sukses për të gjetur golin e barazimit, ndonëse Buqaj, Emra dhe në fund Duraku patën raste të volitshme. Superkupën kapitenit të Prishtinës, Enis Fetahu ia dorëzoi zëvendëskryeministri i Kosovës, Ramë Manaj.

Reagim

FFM demanton të thënat e mediave skoceze

Shkup, 28 gusht - Federata e Futbollit të Maqedonisë (FFM), ka demantuar të thënat e mediave skoceze, se gjoja janë shitur 1000 bileta hyrëse të tribunës jugore për simpatizantët e Skocisë. FFM-ja edhe një herë kution se biletat për në tribunat jugore dhe atë perëndimore do të shiten vetëm me dokumente identifikuese (letër njof-

tim) edhe atë maksimum një biletë për një person. Në këto shkresa tendencioze të cilat kanë për qëllim të dëmtojnë jo vetëm FFM-në por edhe të gjithë republikën e Maqedonisë flasin edhe faktet se biletat hyrëse ende nuk janë lëshuar në shitje, e cila është planifikuar për të shtunën 30 gusht. FFM-ja vetëm ka demantuar këto shkrime, por do të

bënë edhe hetime për rastin me të cilën do të ngre edhe padi kundër gjoja stërnitësit, por edhe kundër disa medimeve të cilët kanë publikuar këtë lajm. Njëherësh do ta njoftojnë edhe ambasadën e Britanisë së Madhe në Shkup për këtë sulm të ashpër kundër FFM-së si institucion, por edhe të Republikës së Maqedonisë si shtet.



Publicitet

Nëse ndërtoni, rindërtoni ose rinovoni, në ekzistojmë për ju. Të gjitha izolimet ndërtimore dhe materialet për mbulimin e pullazeve me kredi në magazinën FROST - Vollkovë. Tel: 02/2719-465; 02/2055-455; 070/205-861

Shes urgjentisht banesë në Çair 90 m². Çmimi 42.000 euro, tel: 075 653 158

SHPALLJE

për shitje të patundshëmrisë përmes ankandit publik

Shitet Ndërtesë individuale banimi shtëpi e cila gjendet në Strumicë f. Novo Sello me të gjitha shtesat, rindërtimet dhe ndërtimet shtesë e ndërtuar në KP. nr. 7366 në FK Novo Sello e cila përbëhet nga PËRDH+kat me një sipërfaqe të përgjithshme prej 266 m² dhe në bazë prej 133 m², e përshkruar në Fletën e pronësisë nr. 226 për FK Novo Sello si parcelë 7366 plan 18 skica 14 vendi i quajtur Sello kultura nën objekt me sipërfaqe prej 133 m², parcelë 7366 plan 18 skica 14 vendi i quajtur Sello kultura oborr me sipërfaqe prej 500 m² dhe parcelë 7366 plan 18 skica 14 vendi i quajtur Sello kultura nën livadh me sipërfaqe prej 1210 m², apo me sipërfaqe të përgjithshme prej 1843 m², e regjistruar në Fletën e pronësisë nr. 226 për FK Novo Sello, pronë e borxhliut peng Gavrilova Rade Gjurgja nga Strumica Novo Sello me çmim fillestar prej 1.400.000,00 denarë (një milion e katër qind mijë) përmes ankandit publik gojor i cili do të mbahet në lokalitet Zyrës së noterit Milushev Janko në Strumicë në nr. RTC Leninova nr. 14-2/16 më datë 09.09.2008, me fillim në ora 12.00.

Personat e interesuar për blerjen e tundshëmrisë së lëvizshme do të mund të marrin pjesë në ankandin gojor publik, po që se më së voni deri në fillim të mbajtjes së ankandit gojor publik dorëzohen garanci në lartësi prej 10 % nga shumata e përcaktuar shtetërore tek noterit Milushev Janko.

Ftohet deponuesi i hipotekës Stopanska Banka SHA Shkup, borxhliu i hipotekës Gavrilova Rade Gjurgja dhe pronarët eventualë të përbashkët, huamarrësit dhe persona të tjerë me të drejtë ligjore për blerje primare të marrin pjesë në ankand publik dhe ftohen po që se kanë vërejtje në realizimin e hipotekës dhe kushtet për shitje, të dorëzojnë vendim nga gjykata deri te noterit Janko Milushev, më së voni një ditë para ditës së ankandit publik, përndryshe përgjigjen për dëmin e blerësit dhe noterit Janko Milushev.

Patundshëmria peng mund të shikohet nga ana e personave të interesuar çdo ditë pune nga ora 10 e deri në ora 12, me leje të noterit Janko Milushev.

Ankandi përfundon pas skadimit të tre minutave nga ofrimi i ofertës më të volitshme.

Blerësi është i obligueshëm ta dorëzojë çmimin e përgjithshëm te noterit Janko Milushev më së voni të një afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e shitjes, në të kundërtën e humbë të drejtën e kthimit të garancisë.

Tatimin e qarkullimit të patundshëmrisë objekt e paguan blerësi si dhe të gjitha shpenzimet për transmetim të të drejtës së pronësisë.

NOTERI
Milushev Janko



Jansen kaloi te Hamburgu

Futbollisti i krahut të majtë i Bajernit të Munit, Marsel Jansen ka arritur marrëveshje me Hamburgun dhe në pesë vitet e ardhshme do të luajë në këtë skuadër. Të dy klubet kanë finalizuar të gjitha detajet e këtij transferimi, kurse Jansen pasi të kalojë sot testin mjekësor do të vë nënshkrimin mbi kontratën pesëvjeçare me Hamburgun. "Hamburgu është një skuadër e re, e uritur për sukses dhe me potencial të madh. Transferimi në Hamburgu është një rast i madh për mua", ka pohuar Jansen. Vlera e këtij transferimi nuk është bërë e ditur, por mediat gjermane pohojnë se ky transferim është bërë mbi vlerën e 8 milionë eurove.

Pujol favorizon kundërshtarin



Reali është favorit

Kapiteni i Barcelonës, Kariol Pujol, beson se pavarësisht përforsimeve që ka bërë skuadra e tij dhe pavarësisht paraqitjes së shkëlqyer gjatë fushatës parasezonale, rivalët e hidhur të Real Madrid janë përsëri favoritë për ta fituar titullin edhe në sezonin e ri. "Ndheshjet tona parasezonale kanë qenë shumë të mira, edhe pse kemi humbur në ndeshjen e fundit (kundër Visla Krakov). Është e zakonshme të luash një ndeshje të keqe, mirëpo kjo të sjell në kujtesë se cilido nga rivalët tonë mund të na mposhtë në çdo kohë". "Real Madridi ka një skuadër të madhe. Ata janë kampionë dhe meritojnë të gjithë respektin tonë. Pavarësisht nëse transferojnë ose jo lojtarë të rinj ata janë ende favoritë për titullin", ka thënë mbrojtësi spanjoll.

Depresion dhe aspak dëshirë për t'iu rikthyer punës

Pas lojërave godet "sindroma e Pekinit"

Ja simptomat që kanë goditur popullatën kineze këto ditë

Edicioni i 29-të i Olimpiadës së Pekinit sapo ka përfunduar dhe janë të shumtë, ata që kanë nisur të "qajnë kohët e bukura". Depresion, ndjesi përhumbjeje, apati dhe aspak dëshirë për t'iu kthyer punës dhe të përditshmes. Janë këto disa nga simptomat kryesore të pas olimpiadës që po godasin në masë popullatën kineze gjatë këtyre ditëve. Lojërat e Pekinit, të cilat u deklaruan të mbyllura të dielën e shkuar, kanë mbajtur të ngjitur përpara ekranit të vogël me miliona njerëz. Në Kinë, ashtu si edhe në çdo cep tjetër të botës, Olimpiada ishte një rast i mirë shoqërorizimi dhe festimesh kolektive. Një ngjarje, e cila u përjetua nga të gjithë. Pikërisht për këtë arsye tashmë, janë të shumtë ata që janë



bërë më të ndjeshëm, kjo mund të përcaktojë dhe të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së jetës familjare. Sipas psikologëve kinezë, mes spektatorëve të pasionuar të sportit është përhapur një formë e çuditshme patologjie, e cila pas fundit të Lojërave të Pekinit 2008 e ka bërë akoma më të vështirë rikthimin në jetën normale të tyre. Lin Ye, konsulent psikolog i Shanghait, sh-

pjegon se "eksperiencat klinike kanë treguar se, për të pasionuarit e sporteve është e zakonshme që pasi ndjekin për një kohë një ngjarje të madhe sportive, siç është një Botëror futbollit apo Olimpiada, të kenë një periudhë depresioni. Gjatë një manifestimi kaq të rëndësishëm, spektatorët e heqin vëmendjen nga shqetësimet e përditshme apo nga problemet e punës. Por më vonë,

kur Olimpiada përfundon, e kanë shumë të vështirë të gjejnë edhe një herë përqendrimin e nevojshëm për të vazhduar me ritmet e mëparshme. Sindroma e Olimpiadës - konfirmon Lin Je, - është hasur më shpesh te studentët ose te të ashtuquajturit 'jakat e bardha', shumë prej të cilëve kanë hequr dorë nga funksione të rëndësishme vitale siç është e ngrëna, apo e fjetura vetëm e vetëm për të ndjekur olimpiadën. Jang Xiaoei, një studiues i "East China Normal University", sugjeron kurën e shpëtimit: të gjithë të prekurit nga sindroma duhet të kalojnë sa më shumë kohë në ajër të hapur, të programojnë ditën dhe të përqendrohen për të fjetur disa orë gjumë, apo të kërkojnë të gjejnë shpëtim në miqësitë e reja. Por mbi të gjitha është e rëndësishme që të qëndrojnë sa më larg televizorit për pak kohë.

Shkurt

Kthehet Vitali Klitçko



Rikthimi i Vitali Klitçkos në ring do të jetë kundër kampionit të botës në kategorinë e rëndë WBC, Samuel Peter më 11 tetor. Përballja në Berlin do të jetë e para për boksierin ukrainas pas njoftimit për rikthim më herët gjatë vitit. Problemet shëndetësore i kanë pamundësuar atij të luftojë nga ajo kohë. Edhe pse në muajin maj kampet e të dy boksierëve kishin arritur marrëveshje për zhvillimin e meçit, data dhe arena nuk janë konfirmuar deri javën e kaluar.

Paloski tek Parma, Broki tek Lacio



Sulmuesi 18-vjeçar i Milanit, Alberto Paloski, sezonin që vjen do të mbajë mbi supet fanellën e Parmës. Sulmuesi i talentuar italian, duke parë rikthimin e Shevçenkos dhe të Borelos, ka preferuar që sezonin e ardhshëm të kontribuojë për skuadrën e Parmës. Në fakt, Paloski nuk është shitur tek klubi emilian, por thjesht është lënë të bëjë një vit stazh në Serinë B, për t'u kthyer sërish te kuqezinjtë. Mësohet se drejtuesit emilianë i kanë paguar Milanit vetëm gjysmën e kartonit të lojtarit, pjesën tjetër e disponon akoma klubi milanesh. Ndërkohë mësohet gjithashtu se transferimi i Kristiano Brokit te skuadra e Lacios është thjesht gëshejt orësh.

Çelzi fillon shitjen e fanellave të Robinjos



Klubi londinez, Çelzi, duket se është afër transferimit të brazilianit Robinjo nga Real Madridi, pasi tashmë në dyqanin zyrtar të klubit "Chelseamegastore" ka filluar shitja e fanellës me emrin e Robinjos.

Kësisoj, krahas Dekos, Territ, Lampardit, Çehut dhe të tjerëve, tifozët fanatik të Çelzit mund të blejnë edhe fanellën me emrin e Robinjos, por pa numër. Seria e fanellave të Robinjos tashmë ka filluar dhe kjo dëshmon se drejtuesit e klubit londinez janë të bindur se do të finalizohet transferimi i tij.

Mihajloviç ka akuzuar trajnerin për stërvitje të gabuar

Murinjo fajtori i dëmtimeve "zikaltër"

Ish-ndihmëstrajner i Roberto Mançinit në kohën kur drejtonte klubin e Interit, Sinisha Mihajloviç, ka komentuar situatën aktuale të klubit zikaltër, i cili po vuan me të vërtetë prej dëmtimeve të shumta, ku repartit të mbrojtjes i kanë mbetur fare pak elementë në dispozicion. Si shkaktarin e kësaj situatë, Mihajloviç akuzon trajnerin aktual të ekipit, portugezin Zhoze Murinjo. Sipas tij, ky i fundit po ndjek taktikat e gabuara të



mënyrës së stërvitjes. "Të them të drejtën, mënyra se si Murinjo kërkoi të përgatitë skuadrën është shumë e çuditshme. Nuk

është mënyra e zakonshme për të stërvitur një ekip dhe nuk mund të punosh me lojën e skuadrës që në ditët e para të stërvitjes. Ne jemi mësuar të bëjmë shumë punë në aspektin fizik, vrapime në pyll dhe ushtrime në palestër. Vetëm një herë në karrierën time kam bërë stërvitje të një lloji tjetër dhe kjo ka ndodhur nën drejtimin e Luis Çezar Menotit te Sampdoria. Që në ditët e para të stërvitjes, ai na kërkonte që për

një orë rresht të vraponim në maksimumin tonë. Në përfundim të saj, ne nuk na mbanim më këmbët dhe s'mund të bënim gjë tjetër. Mendoj se janë pikërisht ushtrimet dhe idetë e Murinjos, ato që po ndikojnë te dëmtimet e shpeshta të lojtarëve. Nuk jemi në mesin e sezonit që të ketë probleme të tilla. Madje, kampionati nuk ka nisur ende", ka thënë Mihajloviç, duke kritikuar kështu, punën e trajnerit portugez të Interit.

Ganezi afër rikthimit te bardhezinjtë

Juve përgatit marrëveshjen për Apiën

Agjenti i Stefan Apia ka njoftuar se Juventus është duke përgatitur marrëveshjen për ta risjellë në Torino ganezin. Aktualisht Apia është transfero i lirë, pasi javën e kaluar ka biseduar për largimin e tij me drejtuesit e skuadrës ku ka qëndruar tre vitet e fundit, Fenerbahçe. Mesfushori ka thënë publikisht se është ëndërr e tij që t'i ribashkohet Zonjës së Vjetër, ndërkohë që edhe Juventus është në kërkim të një mesfushori



defansiv para se të përfundojë afati kalimtar me 1 shtator. "Dëshirojmë që

gjërat të zgjidhen sa më shpejtë që është e mundur dhe të nën-

shkruhet marrëveshja para të hënës. Ne kemi marrë oferta serioze nga Rasing Santander dhe Portsmouth, ndërkohë që kemi telefonatë të vazhdueshme nga Vest Hem, Seltik dhe Everton". "Ne nuk ngutemi, por Juve duhet të vendosë më shpejt. Si do që të jetë ata po punojnë për një zgjidhje, ndërsa ne do të presim pasi që djaloshi ka dëshirë të madhe të luajë për Zonjën e Vjetër", ka thënë agjenti i ganezit, Frank Trimboli.

U.S. Open



Rodik kalon me lehtësi raundin e parë

Ish-numri një i botës, Andi Rodik, ka tejkaluar me lehtësi pengesën e parë, veteranin e tuncve të mëdha, francezin Fabrice Santoro duke e mposhtur me rezultat 6-2, 6-2, 6-2, për vazhduar kështu në rundin e dytë të US Open.

Rodik, kampion i vitit 2003 në këtë turne, siguroi fitoren në tre seta, dhe që të tria me rezultat të njëjtë, 6-2, duke siguruar përballje në rundin e dytë me tinezherin nga Letonia, Ernests Gulbis. 25-vjeçari Santoro, i cili ka vazhduar rekordin e tij të meshkujve, duke luajtur në turneun e 65-të Grand Slam, kishte mposhtur amerikanin Rodik në takimin e tyre të fundit, në Lion në vitin 2007. "U ndjeva mirë. Është forma më e mirë që kam ndërjerë në katër-pesë muaj. Diçka nga ky vend gjithmonë më jep energji", ka thanë 25-vjeçari Rodik.

Liga e Kampionëve

Kualifikohen Liverpool dhe Marsej

Kualifikim për në fazën e grupeve ka siguruar edhe Marseji i Lorik Canës, që mposhti në fushë të vet ekipin Brann me rezultat 2-1

Liverpul ka arritur të kualifikohet për në fazën e grupeve të Ligës së Kampionëve, falë fitores minimale të siguruar në minutat e fundit të kohës shtesë të ndeshjes së luajtur si vendas përbalë ekipit belg, Standard Liege.

Pas një loje jo aq impulsive nga të zgjedhurit e trajnerit Rafael Benitez, koha e rregullt përfundoi pa gola, si edhe ndeshja e kaluar, duke çuar në 30 minuta lojë shtesë. Dirk Kjuit, i cili bëri paraqitjen e 100-të me fanellën e Liverpoolit, ishte sërish



heroi i të kuqve në Ligën e Kampionëve. Sezonin e kaluar, holandezi shënoi shtatë gola në këtë garë, ndërsa këtë herë shënoi kur kishin mbetur edhe dy minuta para fundit të kohës shtesë të ndeshjes (118'), për të dërguar të kuqtë në fazën e grupeve.

Kjuit tash grumbullon nëntë gola nga 15 paraqitjet e fundit në këtë garë evropiane. Kualifikim për në fazën e grupeve ka siguruar edhe Marseji i Lorik Canës, që mposhti në fushë të vet ekipin Brann me rezultat 2-1, falë dy golave të

Rezultatet:

- Atletiko M 4 - 0 Shalke
- Dinamo Z1 - 3 Shakhtar
- Marsej 2 - 1 Brann
- Olympiakos 1 - 0 Anorthosis
- Slavia P 0 - 0 Fiorentina
- Arsenal 4 - 0 FC Tvente
- Liverpul 1 - 0 Standard L (lojë shtesë)
- BATE Borisov 1 - 1 Levski S
- Kaunas 0 - 2 Aalborg
- Dynamo K 4 - 1 Spartak M
- Steaua 1 - 0 Galatasaraj
- Fenerbahçe 2 - 1 Partizan
- Bazel 2 - 1 Vitoria G

shënuar nga Mahmadou Niang, njërin prej të cilëve në minutat shtesë të ndeshjes (66' dhe 90').

Për norvegjezët shënoi Sigurdsson (74'). Marseille kualifikohet me rezultat të përgjithshëm 3-1 (ndeshja e parë kishte përfunduar 1-0 për francezët).

Shkurt

Edvin nuk ngutet për pensionim



Portieri Edvin van der Sar, ka thënë se nuk do të ngutet për të marrë vendimin që të tërhiqet nga loja aktive e fundbollit pas fundit të këtij sezoni. Më herët portieri veteran i dajve të kuq, kishte paralajmëruar se do ta rishikonte situatën e tij dhe do të vendosë për t'u larguar nga futbolli. "Ndonjëherë ka momente kur mendoj se gjithçka ka përfunduar. U tërhoqa nga ekipi kombëtar, pasi që tashmë kam dhënë çfarë kam mundur për Holandë, dhe tash jam i fokusuar vetëm tek Junajdet. Shpresoj se kjo do të thotë vazhdim të karrierës time me klubin", ka thanë portieri holandez.

Dëmtohet Rivas, rikuperohet Kordoba



Lojtarët e dëmtuar në mbrojtjen zikallër nuk numërohen me gishta. Pas dëmtimit të Burdisos pak ditë më parë, i cili do të kthehet në fushë vetëm pas dy javësh, ditën e djeshme është dëmtuar edhe Nelson Rivas. Mbrojtësi kolumbian ka një tërheqje muskulore në kofshën e majtë dhe nuk do jetë në dispozicion të trajnerit Hoze Mourinjo për takimin e parë në kampionat kundër Sampdorias. I vetmi lajm i mirë për Mourinjon vjen nga Kordoba, i cili të shtunën do jetë në pankinë, i gatshëm për ta nisur ndeshjen nga stoli në rast se Kambiaso apo Materaci do të kenë ndonjë problem.

Not

Australia diagnostifikohet me pneumoni



Mediat australiane kanë njoftuar se kampionja e trefishtë olimpikë dhe mbajtëseja e rekordit për notim, Stefane Rise, pas kthimit nga Lojërat Olimpikë është diagnostikuar me inflamacion të mushkërive. "Mjekët më kanë thënë se i kam simptomat e para të pneumonisë", ka thënë Rise, duke shtuar se edhe gjatë qëndrimit në Kinë nuk ishte ndier

mirë. "Gjendja është përqendruar pas kthimit tim në shtëpi, ndërkohe që mjekët më kanë caktuar terapi dhe duhet të kalojë një kohë për shërimin tim", ka përfunduar notuesja. Gjatë Lojërave Olimpikë në Pekin, Stefane Rise ka fituar tri medalje të arta për notim në stilin e përzier, në 200 metra, 400 metra dhe në 4x200 metra.

Villa në Mestala deri më 2014

Jam krenar që Valencia nuk pranoi ofertat



Pas arritjes së kontratës së re me Valencian, e cila do ta mbajë atë në Mestalla deri në vitin 2014, sulmuesi spanjoll David Villa ka shpjeguar vendimin për të mbetur tek ky klub.

"Dua të falënderoj klubin për këtë gjest dhe për gjithçka që kanë dhënë që kur unë kam arritur këtu, tre vite më herët. Jam i nderuar që klubet tjera tentuan të nënshkruajnë me mua, por

unë kurrë nuk kam pasur synim të largohem", ka thënë Villa. "Tash ekziston një klauzulë blerjeje prej 150 milionë eurosh dhe nëse dikush dëshiron të më blejë, do të duhet të negociojë me Valencian, pasi që unë jam i lumtur të qëndroj këtu. Ka pasur shumë oferta që kanë përfshirë shumë para, por Valencia nuk e ka pranuar asnjë prej tyre. Dhe mua, kjo më bën shumë krenar", ka shtuar më tej Villa. Valencia së fundi refuzoi ofertën e Realit prej 40 milionë funtesh, plus sulmuesin argjentinas Javier Saviola, për David Villan.

Francezi i pafat

Pires mungon kundër Osasunas



Robert Pires ka përsëritur dëmtimin e muskulit dhe si pasojë e këtij lëndimi do të mungojë në takimin e parë në La Liga. Mesfushori i krahut ishte lënduar para nëntë ditësh në një ndeshje miqësore kundër Val-

ladolidit, mirëpo dukej se rikuperimi i tij po shkonte shumë shpejtë dhe mjekët parashikonin praninë e tij në ndeshjen kundër Osasunas. Mirëpo 34-vjeçari kishte pësuar një dëmtim të sërishëm gjatë gjuajtjes së një penalltie në stërvitjet e djeshme të Villarealit. Mungesa e francezit do të jetë goditje e madhe për trajnerin e Nëndetësës së Verdhe, Manuel Pellegrini, pasi që tani më dihet mungesa e të lënduarve Giuseppe Rossi dhe Nihat Kahveci, ndërkohë që Ariel Ibagaza është në dyshim për lojë.

Pauell konfirmon prezencën në Rieti



Atletit Asafa Pauell do të jetë një nga protagonistët e takimit të Rietit, që bën pjesë në Grand Prix të IAAF-t. Takimi në fjalë është programuar të nisë në shtatë shtator në stadiumin "Raoul Guidobaldi". Sprinteri xhamajkan ka konfirmuar prezencën e tij në garat, ku vitin që kaloi arriti të fitonte edhe rekordin botëror, duke regjistruar kohën 9"74.

DASHI (20/III-20/IV)



Mos u manipuloni nga persona që ju bëjnë lajka, duke përdorur fjalë të bukura. Ndiqni instinktin tuaj për të zgjedhur bashkëpunëtorë, ortakë në punë ose miq të rinj. Përbaltoni çdo situatë dhe veproni me dinamizëm dhe shpirt krijues, siç ju sugjeron Dielli dhe Afërdita.

DEMI (21/IV-20/V)



Yjet sot ju dhurojnë një karakter të ngrohtë, një fazë ku do të jeni mjaft komunikues dhe krijues. Në qoftë se jeni singël, Hëna dhe Afërdita do ju ndihmojnë të gjeni personin e duhur që do ju rërbejë zemrën dhe mendimet. Mbrëmje romantike për ata që janë çift.

BINJAKËT (21/V-20/VI)



Një miqësi mund të transformohet në një histori dashurie. Të lindurit në shenjin e Binjakëve kanë tendencën të heqin dorë nga marrëdhëniet e konsoliduara për diçka të re mjaft ngacmuese. Dhe do të jetë pikërisht që gjatë këtyre ditëve mund të kënaqni dëshirën tuaj për aventura.

GAFORRJA (21/VI-22/VII)



Falë intuitës dhe shpirtit tuaj krijues dy dhunti të shenjës tuaj do të arriji synimet tuaja edhe në situata që fillimisht duken të vështira. Gjithashtu nuk përjashtohet mundësia e një bashkëpunimi të karakterit ekonomik i vlefshëm në sektorin praktik.

LUANI (23/VII-22/VIII)



Më në fund të gjitha çështjeve aspak të qarta po i vijen fundi. Sot dikush mund të ketë përballë jush një sjellje aspak korrekte, ose mund të zhgënjeheni nga partneri për një gënjeshtrë ose sekret që ju nuk jeni në dijeni. Tregoni kujdes në qoftë se merreni me një aktivitet sportiv.

VIRGJËRËSHA (23/VIII-22/IX)



Më në fund do të njihni persona të rinj dhe do të keni mundësi të ndërtoni një marrëdhënie solide miqësore me dikë, i aftë të dëgjojë konfi dencat tuaja. Shumë prej jush do të arrijnë suksese në sektorin profesional. Paraqitet shumë mirë marrëdhënia me partnerin.

PESHORJA (23/IX-22/X)



Hëna ju kthen krahët dhe një e papritur mund t'ju vërë në vështirësi. Duhet të bëni disa zgjedhje dhe të vendosni se kush është më e rëndësishme për momentin. Marsi ju mbron dhe ju dhuron energji, mundohuni ta shfrytëzoni sa më mirë në gjërat praktike dhe do të arriji rezultate të mira.

AKREPI (22/X-21/XII)



Do të vini re që marrëdhënia në çift do të jetë më e fortë se kurrë, thellësia e ndjenjave që ju bashkon me njeriun e zemrës do të rritet nga Hëna dhe Afërdita. Edhe sfera profesionale do të jetë nën mbrojtjen e transiteve yjore.

SHIGJETARI (22/XI-21/XII)



Dita e sotme është e përshtatshme për të verifikuar të ardhurat tuaja financiare kështu mund të përbaltoni më mirë shpenzimet e shumta gjatë kësaj periudhe. Në sferën private ka ardhur momenti të zgjidhni një problem që ju shqetëson prej kohësh, mos e shtyni për më vonë.

BRICJAPI (22/XII-20/I)



Keni pasur periudha më të mira se kjo, por duhet të kënaqeni me çfarë ju ofrohet. Ndoshta ndjeheni të stresuar ose mund të keni tension të ulët, i ndodh shumë personave gjatë verës. Dashuria nuk paraqitet dhe aq mirë, gjithsesi që nesër gjërat do të qetësohen.

UJORI (20/I-19/II)



Hëna mund të sjellë ndonjë hije në sferën sentimentale për shumë nga ju gjithsesi bëhet fjalë për probleme të tipit imagjinar të lindura nga frika dhe nga një pasiguri e brendshme. Mos u tregoni sipërfaqësor, sistemoni gjërat e lëna pezull. Kujdesuni për trupin dhe pamjen e jashtme.

PESHQIT (20/II-19/III)



Ndjeheni në formë të shkëlqyer dhe jeni shumë optimist sepse Hëna është në pozicion të favorshëm me shenjin tuaj. Do t'i kushtoni më shumë kohë partnerit dhe do të keni më shumë okazione për të qëndruar në shoqëri e miqve dhe të organizoni një darkë argëtuese.

	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
1										11
12			13							
14		15					16			
17						18				
19					20					
21				22						
23			24					25		
26							27			
28										

HORIZONTALISHT : 1. Mysliman; 12. American Oceanic Aerotransport; 13. Portieri spanjoll, lker; 14. Simboli kimik i Niton-it; 15. Ndeza (krah.); 16. Përemër veitor; 17. Kafshë ose bimë që mund të jetojë në tokë dhe në ujë; 18. Njeriu i parë sipas biblës (pashq.); 19. Lloj veprë letrare (shq.); 20. Emër i huaj femre; 21. Dëshira për të pirë ujë; 22. Lloj eksploziv; 23. Satelit (shkurt); 24. Basketboll Amerikan, Shekili; 25. Autotarga e Tetovës; 26. Ushqimore; 27. Breg a kodër e vullgë rëre; 28. Këngëtare e njohur Skoceze.

VERTIKALISHT: 1. Këmbë metrike me tre rrokje; 2. Që ka mbushur motin, njëvjeçar; 3. Uran, angstrom; 4. Hidrologjin; 5. Gji në Jordan; 6. Sani i prodhuar për tu shitur; 7. Hyjneshja e fallit në mit. greke; 8. Kam njohuri; 9. Fytyrë në "1001 nete"; 10. Çdo natë, për natë; 11. Banor vendës i Somalisë; 13. Lloj gjelle; 15. Artikull satirik, që botohet në gazete; 16. Udhësë koralesh; 18. Qytet në Francë; 20. Tenistja gjermane, Huber; 22. Vaj (angl.); 24. Shkronja greke; 25. Simboli kimik i berkelium-it; 27. Zëro.

KËLUËN 8 VITE PË TË DËSHURIN TONË



MUZEFER KËRPUZI
(1.02.1954 - 28.08.2000)

U mbushën 8 vjet që nuk gjendesh në gjirin tonë fëmijlër, nuk kënë qenë 8 ditë e 8 muajt por 8 vite të vështirë, që e kemi ndje thellë mungesën tënde si bërë.

Bujërië, fisnikërië e dëshurië, fjlët e bukurë, këshillët dhe veprët e tuë nuk zëvendësohen me ësgjë në botë. je i pëhërrueshëm në mesin tonë. Jemi shumë krenër që të pëtm.

Të përkujtojmë me mëll e dhembshuri fëmijlë jote (bëshkëshortjë dhe fëmijë)

EMERTIMI PËR SULMIN (sport)	FUTBOLLIST TURK	AKTORI AMERIKAN, SMIT	PËRKUL	VETEVRASJE E SAMURAJEVE JAPONEZ AZOT	SATELIT (shkurt.)	LOPE PARAHISTORIKE EVROPIANE	QYTET NË JAPONI	KAPELË TURKE	VEPRITARI KRIJUES ARTISTIKE
KËNGËTARJA JONË NGA FOTO									
GRUP LOJTARËSH				KUSAR, HAJDUT (gjeom.) COPE PRUSHI (shq.)					
LUMË NË RUSI				AI QË PUNON ME GATËR NJERA NGA PERMET					
LUMË NË AUSTRI		BANOR I DAKISE		LOKAL KU PHET KAFE					
NORVEGJIA	KOMPOZITORI YNË, AKIL BAKËR								
GUR PESHE									
ORGANIZATA E FUTBOLLIT EVROPIAN				ITALIA PAMUNDËSI PËR GËLLITJE MOSGELTJIA (mieq)					
Koha Koha Koha	PILITRKANI SHQIPTAR, ILIR BERA ME KATRAN				JO I MIRË				
KARAT		ANJATA (arkit.)							
PJUE E NGROHTË		LLAFAZAN							
				KYÇ	AKTORI AMERIKAN, GARSIA				
TEMP. JOD KËNGËTARI, RAMADAN				DET, PËSË E MËSDHEUT LLOJ BUKE E BARDHË		INTERNAT. BANK foy RECONSTR. and DEVELOPMENT	Autot: SHKELZEN MUSTAFA	QË KA NUHATJE TË FORTE	POÇE E MADHË PREJ BALTE (shum.)
							SHKRIMTARI PORTUGEZ, HOSE MARIA KRYEHOXA		
AKTORJA E VIETËR ITALIANE, VALI					TË BËRË VRIMË	QILIM QË SHTRONJËT ANËS OXHAKËT			
EMRI QË I DEL DRIKUT PËR TË MIRË A PËR TË KEQ									
NËSIA E REZISTENCËS ELEKTR.					SHTEGTAR				
					AUNSHTANJNUM				
LLOJ PËLHURE (shq.)							SHKURRE E VISEVE BREGDETARE TON		
BARNAT QË SHKAKTOINË ANESTEZI									





Këshilla praktike për kuzhinën tuaj

- Për ta ruajtur bukën të freskët, mbajeni në ngrirje të frigoriferit. Kur ta nxirrni, do të shikoni se ka mbetur e freskët, sikur ta keni blerë atë ditë.
- Që të mos ju forcohen bërçollat gjatë skuqjes, veproni në këtë mënyrë: grini në rende një qepë të madhe dhe para se ti skuqni bërçollat, mbulojeni sipërfaqen e tyre me këtë shtresë qepe të grirë. Lërimi për 2-3 orë. Në vazhdim, skuqini. Rezultati do t'ju lërë gojëhapur!
- Që të shmangni lotët gjatë pastrimit të qepëve, mund t'i lini ato të ndara në ngrirje të frigoriferit ose në ujë të ftohtë. Më pas pastrojini.
- Që ta ruani gjalpin sa më të freskët, hidhni brenda tij një copë karotë të pastruar.
- Nëse doni ta mbani kafenë të freskët dhe me aromë, atëherë mund ta ruani në frigorifer.
- Nëse dëshironi të shmangni erën e rëndë të lulelaktës gjatë zierjes, vendosni mbi kapakun e tenxheres një copë pambuk të zhytur më parë në uthull.
- Që t'i largoni më lehtë insektet nga perimet, hidhni pak sodë ose uthull në ujën që i lani.
- Perimet e vyshkura gjallërohen, nëse i vendosni për disa orë në frigorifer të mbuluara me pecetë të lagur.
- Mund t'i ruani limonët të freskët, nëse i vendosni në frigorifer në një vazo me ujë të mbyllur me kapak.
- Që të kuptoni nëse fasulet janë bajate, bëni këtë provë: kafshojini dhe shikoni nëse mbetet në to shenja e dhëmbëve. Nëse nuk mbetet shenjë, atëherë fasulet janë bajate.
- Që orizi të mos ngjitet gjatë zierjes, hidhni në tenxhere pak lëng limoni.
- Tigani nuk ngjit nëse e nxehni pak, para se të hidhni vajin.
- Nëse dëshironi lakra jo shumë të hidhura, ndërroni 2 herë ujin gjatë zierjes, ose, së bashku me to, zieni 2-3 kokrra patate.
- Që të ruani ngjyrën e gjelbër të lakrave gjatë zierjes, kripeni ujin që në

fillim dhe mos e mbuloni tenxheren me kapak.

• Që peshqit të mos ju thërrmohen gjatë skuqjes, kripini, lyçini me lëng limoni dhe lërimi në kullësë rreth gjysmë ore. Më pas, skuqini në vaj jo shumë të nxehtë.

• Në mënyrë që të heqësh erën e peshkut nga duart, pastrojti ato duke i fërkuar mirë me limon.

• Mund të zhdukësh erën e qepës apo të hudhrave duke i fërkuar duart me uthull të bardhë menjëherë pas mbarimit të përgatitjes së ushqimit.

• Në mënyrë që të zhdukësh erën e mykut apo çdo lloj ere tjetër jo të këndshme në dollap apo në sirtar, mjafton të vendosni në kënd të tyre një copë qymyr.

• Për zierjen e vezëve të plasuritura mjafton t'i mblihdni ato me një copë letër alumini dhe të hidhen në ujë.

• Perimet ruhen mirë për disa ditë nëse mbështillen me një pecete të lagur.

• Perimet qërohen jo shumë kohë para gatimit dhe zihen në tenxhere me kapak të mbyllur dhe me pak ujë.

• Vitaminat që ndodhen në perimet e freskëta janë shumë të ndjeshme gjatë përpunimit të nxehtë, prandaj është më mirë që ato të zihen shpejt e në zjarr të fortë.

• Patatet e ziera qërohen më lehtë nëse pas zierjes hidhen në ujë të ftohtë.

• Që panxhari i kuq të ruajë ngjyrën gjatë zierjes, në vend të kripës në ujë hidhet pak uthull.

• Mbas qërimin të patateve, karotave, e perimeve të tjera duarve, ju hiqni njiollat nëse lahen me lëng limoni.

• Kur gjiza është e thartë përzihet me qumësht në raportin 1:1, pasi lihet një orë kullohet, kështu që gjiza bëhet e ëmbël dhe e freskët.

• Djathi shumë i kripur njomet me ujë të zier, por të ftohur.

• Djathi i tharë që të bëhet i butë vihet për pak kohë në qumësht.

• Kur rrihen të bardhat e vezëve që t'u shtohen më shumë vëllimi për çdo kokërr vezë i shtohet një gjysmë luge gjelle ujë.

Pitt: Duam edhe dy fëmijë të tjerë



Aktori Brad Pitt, i është rikthyer punës, disa javë pas lindjes së binjakëve, Knox dhe Vivienne, dhe ka deklaruar se ai dëshiron edhe më shumë fëmijë.

Pitt, i cili priti lindjen e binckëve në Nice të Francës gjatë muajit të kaluar, ka thënë para reporterëve të Festivalit të Filmit në Venecia se "bineqtë janë mirë", duke pohuar se ai dhe partnerja e tij, Angelina Jolie, janë duke menduar ta zgjerojnë edhe më shumë strofullin e tyre.

"Do të kem edhe dy fëmijë më shumë në vitin tjetër", ka thënë Pitt. Binjakët e Pitt dhe Jolie, ishin i pesti dhe i gjashtë fëmijë që i bashkohen familjes së tyre, që përfshin edhe tre fëmijë të adoptuar, Maddox (7-vjeçar), Pax (4-vjeçar) dhe Zahara (3-vjeçare), si dhe një vajzë biologjike, Shiloh (2-vjeçare).

Përtypja e çamçakëzëve e dobishme edhe për zorrët



Personat të cilat pëlqejnë të përtypin çamçakëzë, shumë më shpejtë shërohen pas ndërhyrjeve kirurgjike në zorrë, kanë zbuluar hulumtuesit anglez.

Rezultatet e botuara në Archives of Surgery, janë bazuar në të dhënat e nxjerra nga 158 pacientë, të mbledhura për nevojat e pesë studimeve të mëherëshme.

Është dëshmuar se çamçakëzët mund ta përshtypin funksionimin normal të zorrëve pas ndërhyrjeve kirurgjike, pasi që çojnë në stimulim të nervave në traktin tretës.

Hulumtuesit shtojnë se pacientët të cilët kanë përtypur çamçakëzë, e kanë zvogëluar qëndrimin në spital për mesatarisht një ditë.

Nëse këto të dhëna vërtetohen në shumicën e personave të hulumtuar, do të jepet mundësia e kursimeve më të mëdha nga sigurimi shëndetësor, shtojnë hulumtuesit.

Virusi infekton kompjuterët në hapësirë

Kur virusi e infekton kompjuterin e dikujt, nuk është edhe ndonjë lajm. Mirëpo kur kjo ndodhë në Stacionin Ndërkombëtar Hapësinor i cili sillet rreth botës, atëherë kjo është dukshëm më e pakëndshme.

Krimbi i cili ka hyrë në laptopët e astronautëve të shkretë quhet W32. Gammima.AG dhe për qëllim ka të vjedh fjalëkalimin e kompjuterit të infektuar. Siç pohojnë në NASA, janë infektuar disa laptopë, mirëpo asnjëri prej tyre nuk përdoret për operacione kritike në hapësirë, por bëhet fjalë për pajisjet në të cilat kryesisht lexohen e-mailat.

Megjithatë, vet mendimi se astronautët në hapësirë do të mund të kishin probleme për shkak të virusëve të kompjuterit është shumë i

pakëndshëm dhe bie nën domenin e fantastikës shkencore nga të nëntëdhjetat e hershme, për të cilën kemi menduar që kurrë nuk do të bëhet e vërtetë.

NASA, dorën në zemër, po bëhet e mençur, duke mos pranuar në asnjë mënyrë se laptopët të cilët përdoren

për gjëra të rëndësishme nuk mund të infektohen me virus. E pyetur nëse ata laptopë si dhe laptopët e infektuar në të njëjtin rrjet, zëdhënësja e NASA-s Kelly Humphries është përgjigjur me mençuri: Edhe po ta dëja, nuk do të mund të ju tregojta për shkak të shkaqeve të sigurisë.



Aston Martin dizajnon automjetin më të shtrenjtë në botë

Kompania britanike "Aston Martin" ka publikuar disa detaje të mangëta dhe vizatime të automjetit të ri me emrin "one-77", i cili do të shitet me çmim minimal prej 1.3 milionë euro, patim, dhe do të jetë automjeti më i shtrenjtë në treg. Secili nga 77 njësitë

e Aston Martin, nga seria e kufizuar, do të përshatet për blerësin e veçantë, derisa inxhinierët dhe dizajnerët do të merrin vesh për specifikat e sakta me secilin blerës të ardhshëm veç e veç. KarrocERIA e aluminit e automjetit do të përpunohet me dorë,

derisa pronari do të jetë në gjendje të zgjedh zërin e tubit të shkarkimit. Motori me 12 cilindra dhe rreth 700 kuaj fuçi do të mund të zhvillojë shpejtësinë maksimale prej 354 kilometrash në orë dhe se shpejtësinë deri në 100 kilometra do ta arrijë për 3.5 sekonda.

Kompania Aston Martin ka identifikuar rreth 500 blerës potencialë, të cilëve do t'u ofrojë paraqitjen e modelit demonstrues kudo që të donë ta shohin.

Pritet që automjetet e tilla të para do të juri dorëzohen blerësve deri në fund të vitit 2009.

